

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE
NUMËR 374 • VITI 35 • JANAR 2022 • XHUMADEL ULA - XHUMADEL UHRA 1443 • ÇMIMI 1 €

**GARANTIMI I MBROJTJES NGA ALLAHU XH.SH.
PËR MUHAMEDIN A.S.**

NA FAL JA RESULULLAH!

**FISNIKËRIA E MISIONIT TË MIRËMBAJTJES DHE
RUAJTJES SË INSTITUCIONIT TË VAKËFIT**

PAGËZIM A VDEKJE

KONVERTIMI ME DHUNË I SHQIPTARËVE NË ORTODOKS DHE
QËNDRESA E POPULLSISË SHQIPTARE NË DEÇAN DHE RRETHINË

Myftiu Tërnavë uroi zgjedhjen e kryetarit të Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër

Selam Alejkum!

I nderuari Kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar në Zvicër, z. Mehas ef. Alija, shfrytëzoj nga rasti dhe kam nder të veçantë që, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës të Kosovës dhe në emrin tim personal t'ju uroj për zgjedhjen tuaj Kryetar të KMSHZ-së si dhe anëtarët që u zgjodhën në kryesinë e kësaj Bashkësie, duke e lutur Allahun e Madhërishëm që t'ju ndihmojë në punën dhe angazhimet Tuaja të mëdha që keni para vetes.


Bashkësia Islame e Kosovës e në veçanti Drejtoria për Diasporë është e interesuar që të bashkëpunojë ngushtë me KMSHZ-në. Mbesim me shpresë se bashkëpunimi ynë do të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

Duke ju uruar edhe një herë, pranoni selamet dhe përsëndetjet tona.

*Kryetari
Myftiu, Naim ef. Tërnavë*

Në këtë numër:

Editorial	4
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (8)	5
Dr. Ajni Sinani Garantimi i mbrojtjes nga Allahu xh.sh. për Muhamedin a.s.	8
Husamedin Abazi Na fal ja Resulullah!	10
Philip Dorroll Universi në fluks – bashkimi i metafizikës dhe epistemologjisë të Mansur el-Maturidiu (1)	12
Mr. Driton Arifi Fisnikëria e misionit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së institucionit të vakëfit	17
Dr. Ali es-Sallabij Strategjia e hazreti Omerit r.a. në përzgjedhjen e pasardhësit të tij	20
Dr. Jusuf el-Kardavi A ndikon nataliteti në varfëri	23
Prof. ass. dr. Rexhep Suma Format më të njohura të ligjëërimit në dave	26
Mr. Nashit Ferati Islami, myslimanët dhe sfidat e kohës në mijëvjeçarin e fundit	30
Harun Shabanaj Pagëzim a vdekje (1)	32
Bajram Zeqiri Trëndafili qiellor - hoxhë Hasan Tahsini	35
Mr. Arber Berisha Sa libra i keni lexuar?	38
Blerim Musliu A të kujtohet ty...?!	40
Mimoza Sinani Libri i madh i natyrës është shkruar në gjuhën e matematikës	42
Samire Bilalli Ti, natë që nuk agon	46
Bilall Maliqi Monografi e veçantë me fotografi dhe fjalë	47
Haxhi Raif Sopaj Rrëfim nga vitet e luftës së fundit	49
Dr. Sci Agron M. Rexhepi Nevojat energjetike të organizmit (1)	50
Medreseja është pjesë e historisë sonë	53
Aktivitetet	56

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Dashuria e besimtarëve ndaj Allahut xh.sh.



“O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes), s’ka dyshim, se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin) ...”
(El Maide, 54)

Njeriu duhet ta dojë Allahun me singeritetin më të madh dhe të adhurojë vetëm Atë, pa i bërë asnjë ortak. Allahu xh.sh. ka dërguar librat dhe të dërguarit e Tij nga dashuria dhe kujdesi për ne. Na ka mundësuar ta njohim dhe adhurojmë. Si mundet të mos e duam Allahun xh.sh., i Cili me çdo frymëmarrje vazhdimisht, pavarësisht mosmirënjohjes, na jep kaq shumë mirësi?! Si mund të mos e duam Atë që i përgjigjet lutjeve, na mbulon dhe na fal mëkatet, na largon brengat dhe na ndihmon në situata të ndryshme?!

Ka ajete dhe hadithe që tregojnë se Zoti na do. Prandaj ne duhet ta dimë se Zoti na do. Sa më shumë e njohim, aq më e fortë është dashuria jonë për Allahun xh.sh. Pastajduke e ditur sa shumë na do Zoti, ne përjetojmë të njëjtën ndjesi dashurie karshi Zotit. Në ajetin e lartpërmendur, Zoti flet për dashurinë e Tij për ne dhe dashurinë tonë për Zotin, duke thënë: “...se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin) ...”.

Në këtë ajet Zoti i parapriu besimtarëve me dashurinë e Tij kundrejt dashurisë së tyre ndaj Tij dhe kjo është mirësi dhe bujari e madhe nga Zoti. Dashuria jonë për Allahun xh.sh. është dhuratë dhe ajo arrihet falë mirësisë dhe dashurisë së Tij. Folja në ajet (e do) erdhi në kohën e tashme: që tregon vazhdimësi. Për sa kohë që besimtari e do Allahun e Madhëruar, Ai e do atë besimtar dhe kjo dashuri vazhdon me vazhdimin e veprave të mira.

Ndërkaq, midis njerëzve ka të tillë që besojnë se ka të barabartë me Allahun dhe i duan ata ashtu siç duhet ta duan Allahun: “E nga njerëzit ka të tillë, që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan ata, siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre)...” (El Bekareh, 165)

Megjithatë, dashuria e besimtarëve ndaj Allahut xh.sh. është shumë më e fortë se e idhujtarëve ndaj idhujve. Dashuria ndaj Zotit nuk është vetëm me fjalë. Prandaj, Zoti kërkon që ne t’ia kthejmë dashurinë me dashuri, me bindje dhe përlulje, me respektimin e urdhrave të Tij dhe me shmangien e ndalesave. Dëshmia se njeriu e do Allahun është pasimi i vazhdueshëm i Pejgamberit, a.s., në çdo gjë që urdhëron dhe ndalon. Allahu e urdhëron Pejgamberin a.s. t’u thotë shokëve të tij: “Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tua, se Allahu është Falës i Madh, Mëshirëplotë.” (Ali Imran, 31).

Dashuria ndaj Allahut xh.sh. dhe Pejgamberit a.s. është bindje dhe besim i fortë, ibadet madhështor. Ajo është obligim për çdo mysliman e myslimane dhe ka përparësi ndaj çdo dashurie tjetër: “Thuaj (o i Dërguar): “Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, faresti juaj, pasuria që fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju, se Allahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë dënimin e Tij, Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.” (Et-Tevbeh, 24).

Në ajet ka kërcënim dhe paralajmërim të ashpër, nëse ndonjë nga këto që u përmendën është më e dashur se Allahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta në rrugën e Tij, për dënimin që do të godasë. Pejgamberi a.s. ka treguar se dashuria ndaj Zotit të Madhërishtë është një nga gjërat në të cilat rob i gjen ëmbëlsinë e besimit, duke thënë: “Te kush janë tri (gjëra) do të gjej ëmbëlsinë e besimit: Ai te i cili Zoti dhe i Dërguari i Tij është më i dashur se çdo gjë tjetër...”

Disa mendojnë se duhet t’i bindemi Zotit dhe ta adhurojmë Atë, nga frika prej Tij, nga frika e vdekjes, nga frika e dënimit të varrit, nga frika e zjarrit etj. Ata sikur harrojnë se marrëdhëniet tona me Zotin janë të ngritura mbi dashurinë. Imam Gazaliu thotë: “Besimtarët mund ta duan Zotin për shkak të mirësisë (ihsan) së Tij ndaj tyre dhe mund ta duan për shkak të madhësisë (xhela) dhe bukurisë së Tij (xhemal)”.

Sa i përket mirësisë (ihsan), zemrat e njerëzve nga natyra i duan ata që u bëjnë mirë atyre. Të mirat e Allahut për robërit e Tij janë të pafundme.

Sa i përket bukurisë, një person instinktivisht do gjithçka që ai e konsideron të bukur. Bukuria e të Plotfuqishmit me emrat e bukur dhe atributet e Tij, që shkëlqejnë me dritën e shkëlqimit, bën që zemra e besimtarit të gëlojë nga dashuria, emocioni i bukur dhe ndjesia se Ai është pranë nesh gjithmonë.

E si të mos e duam ndërkohë që Ai, falë mëshirës së Tij, na dhuron xhenetin e amshuar? Pejgamberi a.s. thotë “Robit nuk do i jepet kënaqësi më e madhe në xhenet, sesa shikimi i Allahut.”

Zemra përjeton momente qetësie falë lidhjeve me Zotin. Sa herë që bëjmë ndonjë gabim, ne i kthehem Zotit me pendim, pasi e dimë se Ai na do, se Ai është Krijuesi ynë dhe nuk do na braktisë.

Dr. Ajni Sinani

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (8)

Besimi i xhindeve në Kuranin fisnik

وَإِذْ صَرَفْنَا إِلَيْكَ نَفَرًا مِّنَ الْجِنِّ يَسْتَمِعُونَ الْقُرْآنَ فَلَمَّا حَضَرُوهُ قَالُوا أَنصَتُوا فَلَمَّا قُضِيَ وَلَّوْا إِلَىٰ قَوْمِهِمْ مُّنْذِرِينَ ﴿٩٢﴾ قَالُوا يَا قَوْمَنَا إِنَّا سَمِعْنَا كِتَابًا أُنزِلَ مِن بَعْدِ مُوسَىٰ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِي إِلَى الْحَقِّ وَإِلَىٰ طَرِيقٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿٩٣﴾ يَا قَوْمَنَا أَجِيبُوا دَاعِيَ اللَّهِ وَآمِنُوا بِهِ يَغْفِرَ لَكُم مِّن ذُنُوبِكُمْ وَيُجِرْكُم مِّنْ عَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٩٤﴾ وَمَنْ لَا يُجِبْ دَاعِيَ اللَّهِ فَلَيْسَ بِمُعْجِزٍ فِي الْأَرْضِ وَلَيْسَ لَهُ مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءُ أُولَٰئِكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٩٥﴾

“(Kujto) Kur i drejtuam disa xhinde te ti, për të dëgjuar Kuranin dhe kur u afruan (të dëgjonin), thanë: “Heshtni!”. Kur përfundoi (leximi), ata u kthyen te populli i vet si këshillues. Ata thanë: “O populli ynë! Ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë (Shpalljen) para tij, që udhëzon tek e Vërteta dhe tregon rrugën e drejtë!” O populli ynë! Përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojini Atij! Ai ju falë gjynahet dhe ju shpëton prej ndëshkimit të dhembshëm. E ata që nuk i përgjigjen thirrësit të Allahut, nuk mund t'i ikin Atij në Tokë dhe, për ata s'ka mbrojtës tjetër, përveç Tij. Të tillët janë në humbje të sigurt!” - (El-Ahkaf, 29-32)

Shkaku i zbritjes së ajeteve 29-32

Transmeton Ibn Ebi Shejbete nga Ibn Mesudi të ketë thënë: “Xhindet zbritën (u afruan) pranë të Dërguarit të Allahut, kur ai ishte duke lexuar Kuran në vendin e quajtur Batnu Nahle. Pasi u afruan për të dëgjuar, i thanë njëri-tjetrit: “Heshtni (dëgjoni me vëmendje)!”. Ata ishin nëntë, e njëri prej tyre quhej Zevbeah, prandaj Allahu zbriti ajetet 29-32.”¹

Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Këto ajete, ndonëse flasin për një botë krijesash, tërësisht të panjohura për ne, xhindet, dhe ne dimë për ta vetëm aq sa na kanë njoftuar Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij, megjithatë ndërlidhen fuqishëm edhe me ajetet paraprake, të shkatërrimit të popullit të Hudit a.s., e përputhen gjithashtu edhe me tematikën e sures në përgjithësi. Allahu xh.sh. dëshiron të na vërë në dijeni se ashtu siç ka prej njerëzve, të atillë që besuan dhe të atillë që mohuan, po ashtu edhe prej

xhindeve ka njësoj. Në rastin konkret, xhindet që u afruan pranë të Dërguarit a.s., e pranuan menjëherë fenë e Allahut, dhe u kthyen te populli i tyre si këshillues dhe predikues të fesë së Tij. Në fakt, këto ajete erdhën më shumë si një tërheqje e vërejtjes për kurejshët, të cilët e shihnin dhe e dëgjonin çdo ditë Muhamedin a.s., por prapëseprapë zemrat e tyre nuk po hapeshin për ta pranuar dritën e udhëzimit, ndërkohë që xhindet, sapo dëgjuan Kuranin, menjëherë iu nënshtruan Allahut dhe u udhëzuan, duke u bërë këshillues të popullit të tyre.

Koment:

29. (Kujto) Kur i drejtuam disa xhinde te ti, për të dëgjuar Kuranin dhe kur u afruan (të dëgjonin), thanë: “Heshtni!”. Kur përfundoi (leximi), ata u kthyen te populli i vet si këshillues.

Ashtu siç mësojmë nga librat e sires së bekuar, në të kthyer nga Taifi, i zhgënjyer dhe i thyer shpirtërisht, nga shpërfillja dhe mosbesimi i banorëve të tij ndaj thirrjes islame, i Dërguari a.s. ishte ndalur në vendin e quajtur Batnu Nahle, vend që gjendet një natë udhëtimi larg Mekës. Aty e kishte zënë nata, dhe në

kohën e namazit të sabahut, po falej dhe po këndonte Kuran.

I trishtuar në shpirt, pse njerëzit nuk po e pranonin Shpalljen e Allahut dhe dritën e shpëtimit, ai pas namazit të sabahut, me përlësi i qe drejtuar me lutje përgjëruese Allahut të Madhë-rishëm duke thënë: “O Allahu im, Ty po të qahem për dobësinë time dhe gjendjen e rëndë në të cilën gjendem. Sa i shpërfillur qenkam te njerëzit! Ti je më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve! Ti je Zoti që kujdeset për të dobëtit. Ti je Zoti që kujdeset për mua! O Zoti im! Te kush po më lë të mbështetem?! Tek armiku i largët që më trajton me vrazhdësi e ashpërsi!? Apo tek i afërmi të cilit ia ke lënë në dorë çështjen time?! Nëse Ti nuk je i hidhëruar ndaj meje, atëherë nuk mërzhitem për asgjë tjetër! Mëshira Jote është më e shtrenjta për mua. Kërkoj mbrojtje dhe strehim me Nurin e Fytyrës Sate, që ndriçoi errësirat dhe rregulloi çështjen e kësaj bote e të Ahiretit, që mos të më përfshijë zemërimi Yt, e mos të bjerë mbi mua hidhërimi Yt. Ty të takon të më qortosh derisa mos të jesh i kënaqur ndaj meje. Nuk ka sundim e as fuqi askush tjetër përveç Teje.”²

Kur Allahu dëshiron ta përrudhë një zemër, mbjell në të ndjenja të larta për ta parë dhe pranuar të vërtetën. Kështu ndodhi edhe më këtë grup të vogël prej xhindeve, të cilët në fakt nuk ishin një grup i rëndomtë, por ishin zotërinj dhe fisnik të popullit të tyre.

I Madhërishtmi, për t'i dhënë kurajë, dhe për ta qetësuar zemrën e trishtuar të Resulullahit s.a.v.s., i drejtoi tek ai një grup³ xhindesh që po endeshin në errësirën e natës pikërisht te vendi ku ishte ndalur i Dërguari i Allahut. Kur Allahu dëshiron ta përrudhë një zemër, mbjell në të ndjenja të larta për ta parë dhe pranuar të vërtetën. Kështu ndodhi edhe më këtë grup të vogël prej xhindeve, të cilët në fakt nuk ishin një grup i rëndomtë, por ishin zotërinj dhe fisnik të popullit të tyre. Xhindet kishin qëndruar fare pranë Pejgamberit a.s., i cili po falte namazin e sabahut dhe po lexonte Kuran. Ai nuk e kishte ndjerë praninë e tyre, por Kurani famëllartë e ka sqaruar këtë çështje duke treguar në detaje për ndikimin pozitiv që kishin pasur ajetet e Librit të Allahut tek ata. Xhindet sapo u afruan pranë të Dërguarit a.s., dhe dëgjuan Kuranin duke u lexuar prej tij, i thanë njëri-tjetrit: "Heshtni!", që të mund të dëgjojmë më mirë se çfarë janë këto vargje që po lexohen.

Ky ajet, shpreh mrekullinë gjuhësore të fjalëve kuranore, sepse Allahu xh.sh. këtu e ka përmendur fjalën "jestemiune-për të dëgjuar" që nënkupton se ata u drejtuan enkas deri tek i Dërguari a.s., për t'i dëgjuar Fjalët e Allahut. Xhindet u mahnitën nga këto fjalë të mrekullueshme, dhe deshi i Madhërishtmi që aty për aty t'ua hapte zemrat për Islam, gjë për të cilën dëshmon edhe pjesa e

fundit e ajetit 29 të kësaj sureje: "Kur përfundoi (leximi), ata u kthyen te populli i vet si këshillues.", d.t.th. ata u kthyen me të shpejtë te populli i tyre si këshillues dhe tërheqës të vërejtjes, nga dënimi i Allahut që mund t'i godiste, nëse nuk e pasojnë këtë rrugë të drejtë.

Ky grup ajetesh i sures El-Ahkaf, si dhe disa ajete të tjera në Kuranin fisnik, e pastaj edhe shumë hadithe, dëshmojnë se Muhamedi a.s. u dërgua si pejgamber dhe tërheqës i vërejtjes si për njerëzit ashtu edhe për xhindet. Madje në Kuran, ka zbritur edhe një sure e plotë me emrin "El-Xhin".

Ashtu siç na mësojnë Kurani dhe Suneti, Allahu krahas engjëjve që janë të pagabueshëm, dhe zbatojnë vetëm atë çka Ai i urdhëron, krijoi edhe dy lloje të tjera krijesash me intelekt, duke ua mundësuar lirinë e zgjedhjes: xhindet dhe njerëzit. Xhindet janë krijuar nga zjarri: "E xhindet i krijuam më parë nga flaka e një zjarri shumë të fortë." – (El-Hixhr, 27).

Edhe xhindet, ashtu sikurse njerëzit, Allahu i krijoi me një qëllim të caktuar, ta njohin dhe ta adhurojnë Atë: "Unë nuk i krijova xhindet dhe njerëzit për gjë tjetër përveçse të Më adhurojnë." – (Edh-Dharijat, 56), prandaj, që të dyja këto lloj krijesash, janë të ngarkuara me obligime, dhe varësisht nga rruga që do ta ndjekin në këtë botë, do të shpërblehen ose do të ndëshkohen në botën tjetër.

Për nga konstrukti, xhindet janë krijesa të padukshme për ne dhe kanë fuqi të jashtëzakonshme në raport me njeriun. Ata kanë mundësi të lëvizin me shpejtësi ta paimagjinueshme prej një vendi në një vend tjetër. Për ta, thjesht, nuk ka pengesa materiale. Ata kanë jetën e tyre, martohen, shtohen, dhe vdesin. Jetëgjatësia e tyre është shumëfish më e madhe se ajo e njerëzve, dhe mund të shkojë madje edhe deri në pesë mijë vjet. Ndonëse ne nuk i shohim, ata na shohin neve, por nuk mund të ndikojnë në jetën tonë, sepse ata jetojnë në një dimension tjetër paralel në këtë Univers...⁴

30. Ata thanë: "O populli ynë! Ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë (Shpalljen) para tij, që udhëzon tek e Vërteta dhe tregon rrugën e drejtë!

Kur arritën te populli i tyre, ata ua sqaruan se tashmë kishte ardhur Pejgamberi i fundit me Librin e shenjtë-Kuranin, i cili thërret në të njëjtat parime të besimit, ashtu siç kishte thirrur më parë një i tillë, Tivrati i Musait a.s. Ua sqaruan se ky Kuran udhëzon në rrugën e vërtetë dhe të drejtë.

Komentatorët e Kuranit, kur e kanë zbërthyer urtësinë e përmendjes së Tivratis që i zbriti Musait a.s. në këtë rast, e jo edhe të Inxhilit i zbritur tek Isai a.s., kanë thënë se Tivrati, është libri bazë që u zbrit për Beni Israilët, me ligje e dispozita të qarta për të rregulluar jetën e tyre shpirtërore. Por, pasi që çifutët futën duart e tyre në Tivratin, duke e devijuar dhe shtrembëruar, erdhi Isai a.s. me Inxhilin, i cili ishte më tepër si sqarues dhe plotësues i Tivratis, dhe përmban këshilla shpirtërore.⁵

Pikërisht, për këtë arsye, xhindet që u udhëzuan në Islam, u mahnitën nga ëmbëlsia e Fjalës së Allahut, dhe ua sqaruan të vetëve se Kurani që ka zbritur te Muhamedi a.s., është vërtetues i atyre librave që zbritën pas Musait - Tivratis, Zeburit dhe Inxhilit, dhe përgjithësisht, udhëzon për në të vërtetën e amshueshme, besimin e pastër në Krijuesin fuqiplotë. Xhindet e kuptuan se pas udhëzimit në të vërtetën, nuk mund të ketë diç më madhështore, sesa ndjekja e rrugës së drejtë, që për synim të vetëm ka arritjen kënaqësinë e Allahut.⁶

Dihet se xhindet jetojnë shumë më gjatë se njerëzit, madje shumë prej tyre jetojnë edhe pesë mijë vjet e më tepër, dhe nuk është çudi, që ndonjëri prej atij grupi që dëgjuan Kuranin nga goja e Muhamedit a.s., të ketë qenë dëgjues ndoshta edhe i Tivratis apo Inxhilit, ashtu siç kishin zbritur në origjinal, prandaj ishin këmbëngulës në përrudhje të popullit të tyre në Islam. Ky Kuran, të cilin ata e dëgjuan, është pikërisht i tillë siç e ka përshkruar Allahu xh.sh.: "Edhe ty (Muhamed), Ne ta zbritëm Librin me të vërtetën, si vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues (mbrojtës) i tyre..." – (El-Maide, 48).

31. O populli ynë! Përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojini Atij! Ai ju falë grynahet dhe ju shpëton prej ndëshkimit të dhembshëm.



Xhindet, me besimin e pastër me të cilin i nderoi Allahu xh.sh., u bënë thirrës në të vërtetën, dhe i këshilluan popullin e tyre që t'i përgjigjeshin pozitivisht thirrjes së Muhamedit a.s. për besim të pastër në Zotin Një. I këshilluan se pavarësisht se jeta e tyre mund të zgjaste me shekuj, ata prapë se prapë një ditë do ta shijonin vdekjen dhe do të përballeshin me llogarinë para Allahut xh.sh. e ata që besojnë, do të jenë në kopshtet e Xhenetit, ashtu siç ka premtuar Allahu xh.sh. kur thotë: “Për atë që i është druajtur daljes para Zotit të vet, janë (përgatitur) dy Xhenete. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?!” – (Er-Rrahman, 46-47)

Nga këto ajete të sures Err-Rrahman, kemi argument të qartë se Allahu xh.sh. e dërgoi Muhamedin a.s. pejgamber edhe te xhindet, sepse i Dërguari a.s. ua pati lexuar këtë sure në tërësi edhe xhindeve, duke i njoftuar me dispozitat e fesë, me premtimet dhe ndëshkimet e Allahut, sepse në më shumë se 30 ajete të kësaj sureje, i Madhërishmi u drejtohet dy “thekalejnëve” – xhindeve dhe njerëzve, që të mos mohonin të mirat e Tij. Madje, sipas shumë transmetimeve, i Dërguari a.s., pas ngjarjes me xhindet në të kthyer nga Taifi, edhe disa herë ua ka shpjeguar xhindeve obligimet e tyre ndaj Allahut fuqplotë, dhe raportet shoqërore në mes komunitetit të tyre.⁷

32. E ata që nuk i përgjigjen thirrësit të Allahut, nuk mund t'i ikin Atij në Tokë dhe, për ata s'ka mbrojtës tjetër, përveç Tij. Të tillët janë humbje të sigurt!”

Xhindet që u bënë thirrës në rrugën e Allahut, ishin aq këmbëngulës në përpjekje që asnjë prej popullit të tyre të mos mbetej në errësirën e kufrit, andaj filluan me këshilla që herë pas here, kishin edhe ton qortues, që të mos mbeteshin në injorancë dhe mosbesim. Ata thanë qartë se ai që nuk i përgjigjet kësaj thirrjeje të pastër në Njëshmërinë e Allahut, vetëm vetes do t'i bëjë dëm, sepse nuk mund të shpëtojnë dot nga caktimi dhe kaderi i Allahut as në Tokë e as në qiej.⁸ Pavarësisht fuqisë së tyre në krahasim me njerëzit, ata sërish do të vdesin, dhe askush pos Allahut nuk mund t'i marrë në mbrojtje. Të mjerët ata që kërkojnë strehim te dikush tjetër përveç Allahut, sepse nesër në Ahiret, do të jenë humbje të qartë e të sigurt.

Porosia e këtyre ajeteve – (29-32)

- Qëllimi i këtyre ajeteve është i qartë, ai është qortimi i idhujtarëve kurejshë, për vrazhdësinë e zemrave të tyre dhe talljen që po e bënin ndaj Fjalës së Allahut. Xhindet, shumë herë më të fuqishëm se ata, sapo dëgjuan këtë Kuran, menjëherë u udhëzuan dhe u bënë thirrës në të vërtetën, ndërsa

kurejshët, të verbuar nga pasuria dhe autoriteti i tyre, po përpiqeshin me të gjitha mundësitë ta ndalnin dritën e Fjalës së Allahut të depërtonte në zemrat e njerëzve.

- Këto ajete që flasin për praninë e xhindeve që po dëgjonin Kuranin, kanë ardhur edhe si qetësim për zemrën e thyer të Pejgamberit a.s., i cili po kthehej nga Taifi, i zhgënjyer për arrogancën dhe mosbesimin e banorëve të tij. Atij iu bë me dije që të mos mërzieje, sepse herët a vonë, njerëzit do t'i besonin thirrjes së tij, prandaj, le të mos shqetësohej e as të zhgënjehet, sepse Fjala e Allahut, do të depërtojë gjithandej, pavarësisht rezistencës dhe arrogancës së jobsimtarëve.

- Ajetet po ashtu argumentojnë faktin se i Dërguari ynë s.a.v.s. ishte i dërguar i Allahut edhe për xhindet. Këtë gjë përpos shumë ajeteve kuranore, e vërtetojnë edhe shumë hadithe autentike nga i Dërguari i Allahut, kur thotë: “... Jam dërguar për të gjitha krijesat, dhe me mua është vulosur dërgimi i pejgamberëve.”⁹

- Kur të dëgjojmë duke u lexuar Kurani, qoftë gjatë namazit me zë, ose leximit të rëndomtë, jemi të obliguar ta dëgjojmë me vëmendje dhe mundësisht me meditim të thellë, në mënyrë që të na përfshijë mëshira e Allahut.

- Ai që mohon Allahun dhe shpërfill urdhrat e Tij, ai veçse e ka dëmtuar dhe marrë në qafë vetveten, sepse nuk do t'i shpëtojë dot dënimit të Allahut. Ai që sillet me arrogancë duke u tallur me dispozitat hyjnore, fundin do ta ketë të dhimbshëm. - *vijon* -

1. Imam Sujutiu, *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzul*, f. 233. 2. Et-Taberani, “*Kitabu-d-du'a*”, vëllimi V, kapitulli: “*Ed-du'au indel-kerbi ve-sh-shedaid*”, Bejrut 1407 h. / 1987 e.r., hadithi nr. 1036, f. 1280. (Kjo lutje është përcjellë në shumë prej librave të sires, me disa ndryshime të vogla në radhitje, (shënim yni, S.B.) 3. Fjala “*nefer*” në terminologjinë arabe, nënkupton një grup të përbërë prej 3 deri në 9 veta. Pra, jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 9. 4. Për më shumë rreth botës së xhindeve shih: Grup autorësh, *Mevsuatu-t-Tefsir el mevdii li-l Kuranil Kerim, Rijad*, 2019, vëll. XI, ff. 110-138. 5. *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 26, f. 383. 6. *Ale Hamim, El-Xhathijetu-El Ahkaf*, dirasetun fi esrari-l bejan, f. 565. 7. Dr. Umer Sulejman El-Eshkar, *Aleumu-l xhinni ve-sh-shejatin*, Kuvajt, 1984, ff. 44-45. 8. *Fi Rihabi-t-tefsir*, vëll. 26, f. 5572. 9. *Transmeton Muslimi (1/370-371) nga Xhabir bin Abdullahu, nr. i hadithit (3/521); Transmeton Ibn Hibbani në Sahihun e tij nga Ebu Hurejra, nr. (2313).*

Dr. Ajni Sinani

Garantimi i mbrojtjes nga Allahu xh.sh. për Muhamedin a.s.

Është gabim i madh që ta llogarisim Muhamedin a.s. prej atyre njerëzve që shtiren për diçka që nuk janë në të vërtetë.¹

Sikur Kurani të ishte shkruar nga Muhamedi a.s. dhe sikur vërtet Muhamedi a.s. të mos ishte i dërguar prej Zotit të botëve, a do të mund që ai të mashtronte vetveten? Po të mos ishte i Dërguari a.s. i bindur thellësisht në peygamberinë e tij, a do të mund ta rrezikonte jetën e tij?!

Ajeti vijues është nga Kurani fisnik, i cili është fjalë dhe libër i Allahut. Në të, Zoti i thotë të dërguarit të Tij: “O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer mesazhin (risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon.” (El Maideh: 67)

Aisheja, nëna e besimtarëve - Allahu qoftë i kënaqur me të - për shpalljen e këtij ajeti tregon: I Dërguari i Allahut e kaloi një natë dhe unë isha pranë tij. Unë i thashë: “O i Dërguari i Zotit, çfarë ke?” Ai tha: “Sikur një njeri i mirë nga sahabët e mi të më ruante natën.” Ajo tregon: “Derisa ne ishim aty, dëgjova zërin e një arme. I Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, pyeti: ‘Kush është?’ Ata thanë: ‘Sadi dhe Hudhajfa, erdhëm për të të ruajtur.’ Peygamberi i Allahut fjeti. Kur i zbriti ajeti: “Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon” (El Maideh, 67), hazreti Aishja tregon se i Dërguari i Allahut

Nëse Muhamedi a.s. nuk do të kishte bindje të thellë se është Peygamber i Zotit dhe nëse nuk do të ishte i sigurt se Zoti do ta ruante, ai nuk do të vepronte ashtu dhe nuk do të kërkonte nga rojet që të largoheshin.

e nxori kokën dhe tha: “Shkoni o ju njerëz, tani po më ruan Allahu.”

Nëse Muhamedi a.s. nuk do të kishte bindje të thellë se është Peygamber i Zotit dhe nëse nuk do të ishte i sigurt se Zoti do ta ruante, ai nuk do të vepronte ashtu dhe nuk do të kërkonte nga rojet që të largoheshin.

Suleimët dhe gatafanët u përgatitën për ta sulmuar Medinën. Shërbimi informativ e informoi Muhamedin a.s. dhe ai me 450 burra doli në një ekspeditë parandaluese në drejtim të Dhul Kusessë dhe Dhu Amrit.



Armiku u bë pikë e pesë për të shpëtuar kokën. Gjatë udhës u zu një ushtar i armikut të cilit Muhamedi a.s. i predikoi Islamin e ky jo vetëm se e përqafoi këtë fe por u tregoi dhe vendin e përqendrimit të armikut. Ditën e sulmit nisi të binte shi. Pas shpërndarjes së armikut, Pejgamberi a.s. i vari rrobat për t'i terur në një dru dhe vetë u shtri nën të. Duthur el Muharibiu, kryekomandanti i ushtrisë armike, po e përgjonte prej një kodrine dhe, në një çast të përshtatshëm, zbriti me shpatë në dorë dhe klithi: - Kush do të shpëtoj tani prej meje? Muhamedi a.s. iu kthye dhe iu përgjigj qetë: - Allahu!

Kjo përgjigje e shqetësoi aq shumë atë sa që i ra shpata prej dore dhe nisi të dridhej. I Dërguari a.s. e mori shpatën dhe e pyeti: - Tani kush të shpëton ty prej meje? - Për Zotin askush? Më pas ai tha: - Dëshmoj se nuk ka zot tjetër Përveç Allahut, dhe dëshmoj se ti je i Dërguari i Zotit. Muhamedi a.s. ia ktheu shpatën dhe ai që atëherë u bë misionar i Islamit.²

Suhejl bin Amri r.a., ka thënë: “Sikur Muhamedi a.s. të mos ishte i dërguar prej Zotit, ai do të arrihej nga dora e çdo të riu kurejsh”.

Kur beduini u kthye te njerëzit e tij, ai u tha: “Kam takuar Muhamedin, njeriun që është më i sjellshmi dhe më shpirtfalës se cilido njeri tjetër”. (Buhariu dhe Muslimi).³

Nëse Muhamedi a.s. do të ishte një gënjeshtar, pse Zoti do ta mbështeste dhe do ta mbronte nga armiqtë e shumtë të fuqishëm?!

Pejgamberi a.s. kaloi 13 vjet në Mekë i vetëm, i dobët dhe i varfër. S'kishte askënd që ta mbronte përveç mbrojtjes morale të xhaxhait të tij

Ebu Talibit, që ishte i moshuar, dhe nuk do të mund t'i parandalonte arabët të mos e vrisnin.

Pejgamberi a.s. i kundërshtoi dhe i sulmoi idhujt dhe i përshkroi politeistët si njerëz të humbur, të shurdhër dhe të verbër që nuk kuptojnë. Ajo çka solli ai nxiti urrejtjen dhe zemërimin e idhujtarëve arabë. Prandaj ishin të shumtë ata që donin ta vrisnin, por nuk mundën ta vrisnin, edhe pse jetonte e ecte mes njerëzve pa ushtri e pa roje.

Edhe në Medine, Pejgamberi a.s. ecte në mes njerëzve pa roje dhe flinte vetëm me familjen e tij, por ata nuk mund ta arrinin atë. A nuk është kjo një nga mrekullitë dhe dëshmitë më të mëdha të profecisë që tregon mbrojtjen e Zotit të Madhëruar ndaj këtij Pejgamberi fisnik a.s. nga armiqtë?

Ai deklaronte gjatë gjithë kohës se muslimanët do të triumfonin mbi romakët, persët, dhe politeistët arabë. Thirrja e Pejgamberit a.s. përfaqëson një kërcënim ekzistencial për të gjitha tiranitë dhe perandoritë që ekzistonin. Historia tregon për vrasje të sundimtarëve dhe të mbretërve që jetonin në pallate shumë të fortifikuara. Armiqtë e tij nuk qenë në gjendje ta vrisnin me gjithë numrin, forcën, sundimin dhe pushtetin e tyre të madh. Pejgamberi a.s. i tejkaloi të gjitha vështirësitë dhe i mposhti kundërshtarët në një mënyrë që historia nuk e ka dëshmuar deri më sot.

Suhejl bin Amri r.a., ka thënë: “Sikur Muhamedi a.s. të mos ishte i dërguar prej Zotit, ai do të arrihej nga dora e çdo të riu kurejsh”.

1. Tomas Karlajl, shih: Dituria Islame, revishi më i fundit, fq. 358, viti 34, shtator 2020 safer 1442, f. 43- 44. 2. Muhammed Hamidullah, Muhamedi alejhisselam, Vepra I, Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011, f. 389. 3. Ajni Sinani, Muhamedi a.s. i Dërguari i Allahut, Dituria Islame, Prishtinë, numër 350, viti 33, Janar 2020, Xhumadel-Ula/ Xhumadel-Uhra 1441, f.16..



Husamedin Abazi

Na fal ja Resulullah!

Ishe ti që na mësove të kërkojmë falje, prandaj ne në këto çaste po e zbatojmë një këshillë tënden. Çfarë janë vallë këto fjalë e fjali që unë po i radhis, e sikur po harroj se ti ke qarë dhe je përmalluar për mua, për ne, për ymetin, për vëllezërit dhe motrat tua që jetojmë edhe në këtë shekull, me çka i habite e sahabët tu.

Na fal ja Resulullah për ngutjen në hytben e kaluar kur folëm për salavatet ndaj teje. Na fal që e trajtuam salavatit me nguti, vetëm se kishte shi atë ditë. Më fal mua dhe vëllezërit e mi që u falën jashtë xhamisë dhe të cilët nuk ishin të koncentruar për ta dëgjuar vlerën e salavateve ndaj teje.


Më fal ja Resulullah që të kërkojë falje dhe që me këtë mendoj se po e kryej obligimin ndaj teje, e po të dal haku për të gjithë atë që ke bërë për mua, për vëllezërit dhe motrat e mia, për ymetin islam dhe për mbarë njerëzimin. Ndonëse po harrojmë, por edhe sikur 24 orë të mos i ndalnim salavatet ndaj teje nuk do të dilnim hakut. Gjithë jetën tonë me zbatimin e sunetit tënd, prapë nuk do të dilnim hakut. Edhe sikur të flisnim dhe të dëgjonim 24 orë për selamin dhe salavatet, edhe sikur çdo frymë e jona të shoqërohej me salate, prapë assesi nuk do të dilnim hakut.

Ishe ti që na mësove të kërkojmë falje, prandaj ne në këto çaste po e zbatojmë një këshillë tënden. Çfarë janë vallë këto fjalë e fjali që unë po i radhis, e sikur po harroj se ti ke qarë dhe je përmalluar për mua, për ne, për ymetin, për vëllezërit dhe motrat tua që jetojmë edhe në këtë shekull, me çka i habite e sahabët tu. Një ditë atyre u the: “Sa më ka marrë malli për vëllezërit e mi!” E sahabët e habitur të thanë: “A nuk jemi ne vëllezërit tu?!” Ti ju the atyre: “Jo, ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit e mi janë ata që do të vijnë në të ardhmen dhe do të më besojnë pa më parë.” Ti u përmallove për ne o

Ti qave për ne dhe pate të drejtë o Nebij i Allahut. Ti edhe lutjen më të veçantë që i është premtuar përgjigjja për të çdo pejgamberi, nuk e përdore për veten tënde, ti edhe atë e rezervove për ne.

Habibi i Allahut. Ti qave për ne dhe pate të drejtë o Nebij i Allahut. Ti edhe lutjen më të veçantë që i është premtuar përgjigjja për të çdo pejgamberi, nuk e përdore për veten tënde, ti edhe atë e rezervove për ne. E unë sot pyet veten time, a e meritojmë ne gjithë këtë nder? A e meritojmë ne gjithë këtë dashuri e kujdes?!

Ebu Hurejra r.a. ka thënë: “Një ditë i ofruam të Dërguarit të Allahut mish për të ngrënë, iu ofrua një copë shpatull të cilën e pëlqente shumë. Ai kapi prej saj një copë me majat e dhëmbëve dhe tha: “Unë do të jem zotëria i njerëzve në Ditën e Kiametit, dhe a e dini pse? Allahu do t'i grumbullojë njerëzit në Ditën e



Kiametit, të parët dhe të fundit në një rrafsh të vetëm, ku i arrin zëri i thirrësit dhe i përfshinë shikimi, e dielli do të afrohet aq sa njerëzit ndiejnë vështirësi dhe pikëllim, aq sa nuk i rezistojnë dot. Disa njerëz do t'u thonë disa të tjerëve: A nuk e shihni se në çfarë gjendje jemi? A nuk e shihni se çfarë ju ka rënë? A nuk e shikoni se kush mund të ndërmjetësojë për ju te Zoti juaj? Disa të tjerë do të thonë: Shkoni tek Ademi. Ata do të shkojnë dhe i thonë: "O Adem! Ti je babai i njerëzimit, Allahu të ka krijuar me Duart e Tij, ka fryrë te ti nga shpirti i krijuar prej Tij, si dhe ka urdhëruar engjëjt e aty të ranë ty në sexhde, ndërmjetëso për ne te Zoti yt, a nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!" Ai iu thotë: "Zoti im është zemëruar sot si kurrë më parë, e kurrë nuk do të zemërohet më pas si tani. Ai më ndaloi nga "pema" që të mos haja prej saj, e unë e kundërshtova. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër, shkoni te Nuhu."

Ata do të shkojnë te Nuhu dhe do i thonë: "O Nuh! Ti je i pari i të dërguarve, Allahu të ka quajtur "Rob falënderues", ndërmjetëso për ne te Zoti yt. A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!" Ai u thotë: "Zoti im është zemëruar sot si kurrë më parë, e kurrë nuk do të zemërohet më pas si tani. Një lutje (të pranuar) që e kam pasur, e bëra kundër popullit tim. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Ibrahim."

Ata do të shkojnë tek ai dhe do i thonë: "Ti je i Dërguari i Allahut dhe mik i Tij nga banorët e Tokës, ndërmjetëso për ne te Zoti yt. A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!" Ai u thotë: "Zoti im është zemëruar sot si kurrë më parë, e kurrë nuk do të zemërohet më pas si tani dhe u kujton atyre "gënjeshttrat" e tij. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Musa."

Ata do të shkojnë te Musa dhe do i thonë: "O Musa! Ti je i Dërguar, Allahu të ka përzgjedhur duke të

Ti ja Resulullah na dhe myzhde me thënien: "Më i lumturi i njerëzve me shefatin – ndërmjetësimin tim në Ditën e Gjykimit do të jetë ai që ka thënë singërisht, me gjithë zemër e shpirt, La ilahe il-la Allah."

dhënë shpallje (Risaleh) e duke të folur drejtpërdrejt, ndërmjetëso për ne te Zoti yt. A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!" Ai u thotë: "Zoti im është zemëruar sot si kurrë më parë, e kurrë nuk do të zemërohet më pas si tani. Unë kam vënë një njeri, për të cilin nuk isha i urdhëruar ta vrisja. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Isai."

Ata do të shkojnë tek Isa dhe do i thonë: "O Isa! Ti je i Dërguari i Allahut, u ke folur njerëzve kur ishte në djep, ti je Fjalë prej Tij (Allahut), të cilën Ai e vendosi te Merjemja si shpirt i krijuar prej Tij. Ndërmjetëso për ne te Zoti yt. A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!" Isai u thotë: "Zoti im është zemëruar sot si kurrë më parë, e kurrë nuk do të zemërohet më pas si tani dhe nuk i përmend ndonjë gabim. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te dikush tjetër, shkoni te peygamberi Muhamed."

Ata shkojnë te peygamberi Muhamed dhe i thonë: "O Muhamed! Ti je i Dërguari i Allahut dhe vula e lajmëtarëve (nebijjun), Allahu t'i ka falur gabimet e kaluara dhe të

mëvonshme, ndërmjetëso për ne te Zoti ty. A nuk e sheh se në çfarë gjendje jemi?! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?!"

E unë nisem dhe shkoj nën Arshin e Allahut dhe bie në sexhde për Zotin tim, pastaj Allahu më frymëzon për disa lavde dhe falënderime për Të, e të cilat nuk ia kishte frymëzuar askujt para meje. E pastaj thuhet: "O Muhamed! Ngrije kokën, kërko e do të të jepet, ndërmjetëso dhe do të të lejohet." E ngre kokën dhe them: "O Zot! Ymeti im, ymeti im!"

Pastaj thuhet: "O Muhamed! Fut në Xhenet nga porta e djathtë e portave të Xhenetit prej ymetit tënd atë që nuk ka llogari, e ata do të hyjnë me njerëzit edhe nga portat e tjera veç kësaj."

Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, distanca ndërmjet dy anëve të një dere prej dyerve të Xhenetit është sa distanca ndërmjet Mekës dhe Hexherit (qytet në lindje të Medinës), ose sa distanca ndërmjet Mekës dhe Busras (qytet në jug të Sirisë).¹

Po ashtu, ti ja Resulullah na dhe myzhde me thënien: "Më i lumturi i njerëzve me shefatin – ndërmjetësimin tim në Ditën e Gjykimit do të jetë ai që ka thënë singërisht, me gjithë zemër e shpirt, La ilahe il-la Allah."

Ai që e thotë me gjithë zemër e me shpirt, La ilahe il-la Allah, assesi nuk i harron farzet me të cilat Zoti na ka nderuar, duke mos rënë në harame, me të cilat Zoti na ka mbrojtur së pari këtu e mandej edhe në botën tjetër.

Ai që e thotë me gjithë zemër e me shpirt, La ilahe il-la Allah, nuk e harron të Dërguarin e Tij, a.s., dashurinë ndaj tij, salavatet e shumta për të a.s., kurrsesi nuk e harron sunetin e tij. Ai do t'i qëndrojë besnik rrugë së tij, a.s., dhe zemra e tij do të parfumohet e do të lulëzoj me salavate. Sal-l Allahu alejke ja Resulullah.

1. Buhariu 5/225, kreu i tefsirit, surja El-Isra, Muslimi 1/184, kreu i besimit.

Philip Dorroll¹
(Wofford College)

Universi në fluks – bashkimi i metafizikës dhe epistemologjisë të Mansur el-Maturidiu (1)

Ebu Mansur el-Maturidi (vd. 333/944) është pa diskutim një nga figurat intelektuale më të rëndësishme në historinë e Islamit sunit. Pavarësisht rëndësisë së tij, megjithatë, natyra e saktë e doktrinave dhe trashëgimisë së Maturidiut mbetet e diskutueshme. Kjo i detyrohet jo pak vështirësisë së shkrimeve të Maturidiut.

Maturidiu është i mirënjohur për stilin e tij konfuz dhe nganjëherë shumë të paqartë në shkrimet teologjike. Ky studim do të përpiket të demonstrojë se shumë nga pasazhet e vështira dhe konceptet e paqarta të gjetura në teologjinë e Maturidiut në fakt tregojnë për një vizion unik dhe bindës metafizik të bazuar në nocionin e fluksit, ose *tekal-lub*, i cili karakterizon universin e krijuar. Ky punim analizon termet kyçe metafizike dhe epistemologjike në veprën kryesore teologjike të Maturidiut, *Kitabu 't-Tevhid*, duke përfshirë përdorimin e tij të termave, natyra (*tabā'ir*), gjendja (*hal*), pamje (*xhiha* ose *vexhb*) dhe argumenton se Maturidiu elaboron një metafizikë të fluksit (*tekal-lub*) në universin e krijuar. Kjo analizë ndihmon për të kuptuar një sërë parimesh mjaft enigmatike të përshkruara në tekstin e tij, siç është diskutimi i tij për natyrat dhe aspektet, të cilat nëse kuptohen jashtë kornizës së fluksit metafizik mbeten të paqarta.

Ky studim po ashtu argumenton se kjo skemë metafizike është e bazuar në analiza epistemologjike të Maturidiut për aspektet dhe mënyrat në të cilat një realitet i vetëm mund



të shfaqet si i shumanshëm për të kuptuarit njerëzor. Me fjalë të tjera, ky studim përpiket të tregojë rëndësinë e perspektivës në epistemologjinë teologjike të Maturidiut. Për Maturidiun, arsyeja njerëzore dhe perceptimi janë mjete të besueshme për të hyrë në të vërtetën e gjërave në botë, por janë domosdoshmërisht të kufizuara. Kështu, Maturidiu argumenton se bota na shfaqet si epistemologjikisht

'shumë aspektesh', në atë që ne mund të jemi në gjendje të kuptojmë vetëm një aspekt të një realiteti kompleks menjëherë. Duke qenë se bota është gjithashtu vazhdimisht në fluks nën drejtimin e Krijuesit, ne duhet të ushtrojmë aftësitë tona të arsyes dhe të perceptimit për të kapur sa më shumë aspekte të jetë e mundur të realiteteve gjithnjë në ndryshim të universit.

Së dyti, do të argumentohet se këto veçori të teologjisë së Maturidiut nuk u përfshinë nga Ebu 'l-Mu'in En-Nesefi (vd. 508/1115) në tekstin e tij me shumë ndikim, *Tebisiretu 'l-edil-leh*, që ishte sistematizim i doktrinës maturidiane dhe që mbeti definitiv për traditën e mëvonshme shkollore. Kjo sugjeron se disa nga elementet më intriguese dhe më karakteristike të teologjisë së Maturidiut u përfshituan nga zhvillimi i mëvonshëm i shkollës maturidite. Përveç kësaj, ky artikull përfshin gjithashtu një diskutim të hulumtimeve të fundit të rëndësishme të botuara në turqisht që zbulon dëshmi të panjohura deri më tani në dorëshkrim që shtjellojnë ndjeshëm karrierën intelektuale të Maturidiut dhe mjedisin intelektual islam të Samerkandit gjatë jetës së tij. Ky informacion ndihmon për të shpjeguar, të paktën pjesërisht, shqetësimin e Maturidiut për të përpunuar një epistemologji teologjike të bazuar në një kuptim të perceptimit universal njerëzor, në vend të një thirrjeje ndaj figurave të autoritetit individual.

Rishikimi i jetës dhe veprës së Maturidiut

Ashtu siç edhe dihet mirë, Maturidiu, konsiderohet gjerësisht si themeluesi i një prej dy shkollave të teologjisë dogmatike ortodokse sunite (*kelam*) (i dyti pra është Ebu 'l-Hasan el-Eshariu).² Në përgjithësi mendohet se ka vdekur në Samerkand më 334/944.³ Ashtu si figurat e tjera të kohës së tij, detajet rreth jetës së tij të hershme mbeten të pakta deri në inekzistente, megjithëse bazuar në emrin e tij është mjaft e qartë se ai ka lindur në Maturid, një fshat afër (ose një lagje brenda) qytetit të Samerkandit.⁴ Punime të ndryshme në *kelam*, *fikh*, *tefsir* lidhen me emrin e tij, përfshirë veprën e tij të famshme *Kitabu 't-Tevhid* (Libri mbi Unitetin e Zotit), i cili nga pasuesit e tij konsiderohet tekst themelor në teologjinë sunite.⁵ Megjithatë, falë

zbulimit të kohëve të fundit të burimeve të rëndësishme të dorëshkrimeve nga Anke von Kuegelgen dhe Ashirbek Muminov dhe një sasi të konsiderueshme kërkimesh të fundit të bëra në Turqi, informacione të reja të rëndësishme kanë dalë në dritë në lidhje me karrierën intelektuale të Maturidiut. Tashmë është e qartë se Maturidiu mori mësim në një qendër prestigjioze të mësimi fetar suni të njohur si Xhuzxhanije.⁶ Bazuar në informacionet e sjella nga djali i Ibën Zekerija, Jahja ibën Is'haku në komentin e tij bërë veprës *Xhumal Usul ed-din* të Ebu Sulejman ss-Samerkandit,⁷ kjo shkollë është themeluar nga Ebu Sulejman Musa ibën Sulejman El-Xhuzxhani (vd. 200/816), student i Ebu Jusufit (vd. 182/798) dhe Muhamed Esh-Shejbaniut (vd. 189/804), të dy nxënës të njohur të Ebu Hanifes (vd. 150/767).⁸

Ibën Jahja rendit zinxhirin e drejtuesve të kësaj shkolle, duke përfshirë mësuesin e Maturidiut, Ebu Nasr Ahmed ibën El-'Abbas El-'Ijadit (vd. ~ 275/888) dhe vetë Maturidiun.⁹ Është interesante se pranimi i Maturidiut në krye si mësues çoi në një krizë të madhe të udhëheqjes brenda shkollës. Me vdekjen e Ebu Nasr Ahmed ibën el-'Abbas el-'Ijadit, në testamentin e tij u zbulua se kryesia e shkollës duhet t'i kalonte djalit të tij, Ebu Ahmedit. Ebu Ahmed i mbahej në robëri larg qytetit si pasojë e pjesëmarrjes së tij në fushatat ushtarake përgjatë kufirit (siç kishte bërë babai i tij). Maturidiu hyri në rolin e mësuesit në mungesë të tij dhe filloi të jepte mësim në shkollë. Kur Ebu Ahmed i lirua nga skllavëria dhe u kthye në Samerkand, ai pretendoi pozicionin e tij të udhëheqjes, dhe Maturidiu dhe dijetarët e tjerë në shkollë respektuan me përkushtim dëshirat e babait të tij dhe e ngritën në pozitë. Mirëpo, në fund duket se, pasi u bë *fakih*, Ebu Ahmed i dorëzoi pozitën e lidershit të shkollës në Maturid, pasi Maturidiu në fund të fundit konsiderohej më i dituri dhe më i devotshmi nga

të gjithë ulematë e qytetit.¹⁰ Kjo kthesë e ngjarjeve me sa duket zemëroi disa nxënës të Ebu Ahmedit, të cilët nga ana e tyre u shkëputën nga shkolla.¹¹

Ndarjet brenda ulemasë së Samerkandit dolën të kenë qenë shumë më të thella sesa thjesht një mosmarrëveshje mbi udhëheqjen në këtë shkollë të veçantë. Një nga studentet e Ebu Nasrit (dhe ky ishte një tjetër dijetar në shkollë sikurse Maturidiu) Ebu 'l-Kasim Is'hak ibën Muhamed el-Hakim es-Samerkandi u kritikua ashpër për shkrimin e një kredo shtetërore (e famshmeja *Es-Sevad 'l-A'dham*) me urdhër të sundimtarit samanid, Ismail es-Samani (279-295/892-907). Një dijetar i ishte drejtuar drejt e në fytyrë: 'A je në kërkim të dijes apo të famës?'¹² Arsyeja kryesore e ndarjes në mes të dijetarëve suni hanefi në Samerkand duket se është bazuar në qëndrimet ndaj pushtetit të kësaj bote, dhe Maturidiu e bëri të qartë edhe pozicionin e tij në lidhje me këtë çështje (në kontrast të plotë me El-Hakim es-Samerkandin): Maturidiu dha një *fetva* të hapur duke thënë se çdo dijetar që do të ishte në mbështetje të një sunduesi të padrejtë duhet të thirret *kafir*.¹³ Sipas mbi-shkrimeve të gjetura në varrezat e lashta të Xhakardizas (Chakar-diza) në Samerkand, dijetarët me këto pikëpamje anti-establishment u varrosën së bashku në Xhakardizë, e cila në vetvete ndodhet shumë larg nga ish vendi i pallatit dinastik Samanid, në një vend ku thuhet se kanë jetuar njerëzit e thjeshtë të Samerkandit.¹⁴

Ebu Ahmed duket qartë se ka rënë në kampin e mbështetjes për regjimin dhe u kritikua ashpër nga ulematë e tjerë për pranimin e famës dhe pushtetit të kësaj bote gjatë jetës së tij.¹⁵ Në dy studime shumë të rëndësishme, Ak, von Kuegelgen dhe Muminov parashetrojnë dallimet themelore teologjike dhe filozofike midis këtyre dy shkollave të mendimit. Ata që njihen si xhuzxhani përfaqësonin traditën e fortë të hanefizmit të lashtë në

Transoksiani, dhe u shquan për pranimin e metodave racionaliste në *kelam* dhe në interpretimin e Kuranit. Si të tillë, ata me të drejtë mund të shihen si trashëgimtarë dhe kultivues të vetëdijshëm të metodave intelektuale të *ehlu 'r-rë'jit* dhe shkollës së hershme të vetë Ebu Hanifes. Ata ishin gjithashtu të shquar për respektimin e lartë nga populli i Samerkandit dhe kundër-shtonin zëshëm bashkëpunimin e ngushtë me strukturat e pushtetit laik.¹⁶

Një tendencë tjetër mund të zbulohet tek ata që ishin më të gatshëm të pranojnë patronazhin e shtetit, të tillët si El-Hakim es-Samerkandi, Ebu Ahmed dhe Ebu Bekr El-'Ijadi. Ak, von Kuegelgen dhe Muminov i quajnë këta 'Ijadijje', dhe Ak në veçanti parashtron një rast bindës, përmes analizës së tij të dorëshkrimeve ekzistuese teksteve *kelamiste* transoksianiane të shekullit të dhjetë të e.s., se kjo tendencë paraqiste një program teologjik të ngjashëm me *ehlu 'l-hadithin* në atë që refuzonte interpretimin e disa ajeteve në Kuran dhe duket se kanë qenë kundër metodave teologjike më racionaliste të xhuzxhanive.¹⁷

Ky informacion është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të kuptuar punën e Maturidiut për një sërë arsyes. Së pari, e vendos atë në një traditë të fortë të mendimit të institucionalizuar hanefi dhe e vendos atë brenda konflikteve të gjalla ideologjike të kohës së tij. Po ashtu ky informacion pasqyron të kuptuarit tonë për kompleksitetin e traditës hanefite në rajon; për shembull, ai tërheq vëmendjen të rrënjët e hershme të kritikës ndaj *ehlu 'l-hadith* nga pasuesit e Maturidiut. Bezdeviu, për shembull, kritikon rreptë *ehlu 'l-hadithin* dhe hanbelitë, madje me emër disa herë në veprën e tij *Usulu 'd-din*, duke i akuzuar për antropomorfizëm të plotë.¹⁸ Megjithatë, në të njëjtën kohë ky informacion i shton një dimension të ri të kuptuarit tonë për teologjinë e vetë Maturidiut duke theksuar marrëdhënien e tij me strukturat e pushtetit

Diskutimet e gjera të Maturidiut për pozicionet e ndryshme teologjike dhe filozofike të grupeve të ndryshme fetare dëshmojnë për praninë e mundshme të këtij diversiteti gjatë jetës së tij

shoqëror. Ky artikull nuk synon të gërmojë thellë në ndikimet intelektuale të Maturidiut (edhe pse një studim me atë synim që sintetizon këtë material të ri me studimet e mëparshme sigurisht që do të prodhonte rezultate të rëndësishme). Megjithatë, aspektet e personalitetit intelektual të Maturidiut që nxjerr në pah kjo dëshmi e re janë të rëndësishme për analizën tonë.

Qëndrimi sfidues i Maturidiut ndaj asaj që ai e gjykoj si autoritet të padrejtë, qoftë politik apo intelektual, dallohet që në fillim të librit të tij *Kitabu 't-Tevhid*, ku ai kritikon në mënyrë të zëshme *taklidin*, ose pranimin e padiskutueshëm të një argumenti pa prova racionale, në termat më të fortë të mundshëm.¹⁹ Në fakt, ky problem hap faqen e parë të librit të tij dhe Maturidiu e vendos këtë çështje si pikënisje për të gjitha reflektimet e tij teologjike. Siç thekson ai, ekzistenca e një pluraliteti besimesh fetare paraqet një problem të dukshëm për këdo që dëshiron të zgjidhë se cilat opinione rreth botës dhe hyjnore janë të vërteta dhe cilat janë të rreme. As ky nuk ishte thjesht një problem abstrakt për Maturidiu: në Samerkandin e shekullit të dhjetë, ekzistonin një shumëllojshmëri e gjerë grupesh fetare dhe me sa duket kishin kontakte me njëri-tjetrin.

Duket se një grup i vogël zoroastrianësh (dikur shumicë fetare në qytet përpara ardhjes së arabeve të rajonit në shekullin e tetë të e.s.) ekzistonte brenda Samerkandit dhe ishte përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e kanaleve të ujitjes që furnizonin qytetin; për kryerjen e kësaj detyre ata ishin të përgjashtuar nga taksa e zakonshme (*xbizja*) që u vihej jomuslimanëve.²⁰ Një manastir manikean raportohet gjithashtu të ketë ekzistuar në Samerkand në atë kohë.²¹

Burimet myslimane raportojnë gjithashtu se në këtë periudhë një numër i konsiderueshëm i të krishterëve sirianë lindorë (zakonisht të quajtur "nestorianë") jetonin gjithashtu në qytet dhe ishin në gjendje të praktikonin publikisht obligimet e tyre fetare.²² Burimet e shekullit të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë përmendin gjithashtu një komunitet të konsiderueshëm hebre në qytet, ndoshta edhe më shumë se popullsia e krishterë atje.²³ Diskutimet e gjera të Maturidiut për pozicionet e ndryshme teologjike dhe filozofike të grupeve të ndryshme fetare dëshmojnë për praninë e mundshme të këtij diversiteti gjatë jetës së tij, duke aluduar në mundësinë që vetë Maturidiu të përfshihej në debate me anëtarë të grupeve të tjera fetare, ashtu siç kishte bërë mësuesi i tij Ebu Nasr el-'Ijadi me mjaft sukses para tij.²⁴

Ky informacion për pozicionimin e Maturidiut në debatet teologjike të kohës së tij është i rëndësishëm për qëllimet e studimit tonë, sepse ai nxjerr në pah linjat dalluese të periudhës gjatë së cilës Maturidiu jetoi dhe punoi si mendimtar. Është ky sfond që ndihmon në kuadrin e disa argumenteve teologjike që janë objekt i këtij studimi. Ky mjedis teologjik pluralist ndihmon në shpjegimin e interesit intensiv të Maturidiut për përpunimin e një epistemologjie të bazuar në arsye dhe përvojë, burime njohurish që nuk kanë nevojë të tërheqin ndonjë figurë të veçantë autoriteti për vlefshmërinë



e tyre. Duke pasur parasysh diversitetin e dukshëm të opsioneve filozofike dhe teologjike rreth tij, Maturidiu ndjeu nevojën për t'i bazuar argumentet e tij për teologjinë islame në burimet e autoritetit që ai mendonte se ishin të arritshme për të gjithë individët e arsyeshëm. Kështu, (për dallim nga Eshariu veprën e tij *Ibane*) Maturidiu i bën pak thirrje autoriteteve individuale për të mbështetur argumentet e tij. Ceric vë në dukje edhe këtë aspekt të metodologjisë teologjike të Maturidiut, duke përmendur se, me gjithë hanefizmin e fortë institucional brenda të cilit ai vepronte, Maturidiu vetëm katër herë e citoi Ebu Hanifen në veprën e tij *Kitabu 't-Tevhid*.²⁵ Gjithashtu duket qartë se Maturidiu operoi në një mjedis intelektual më të përshtatshëm për vetë racionalizmin teologjik sesa ai në të cilin jetoi për shembull Eshariu.²⁶ Nuk është rastësi, pra që Nesefiu në veçanti lavdëron Maturidiun për përpjekjet e tij të jashtëzakonshme [në harmonizimin - përkth] e 'arsyes dhe fesë' (*el-aklu ue d-din*).²⁷ Ky studim do të diskutojë natyrën e saktë të këtyre përpjekjeve të jashtëzakonshme në [çështjet si - përkth] 'arsye dhe fe', duke elaboruar se si

Maturidiu integroi kuptimin e tij për arsyen dhe epistemologjinë njerëzore në një vizion *kelami* metafizik unik. Në veçanti, ky studim jo vetëm që do të qartësojë kuptimin e një sërë pasazhesh të vështira në tekstin e tij, por do të zbulojë edhe përdorimin e sofistikuar të Maturidiut të perspektivës dhe aspektit si çelësi i vizionit të tij epistemologjik dhe metafizik.

Maturidiu dhe metafizika e fluksit

Siç kanë vënë në dukje shumë komentues, teksti i Maturidiut ndonjëherë është jashtëzakonisht i paqartë. Proza e tij teologjike është shumë e dendur, por në të njëjtën kohë i mungon shpjegimi kur duket më i nevojshëm: si pasojë, disa pasazhe të *Kitabu 't-Tevhid* duket hapur se lënë të kuptohen qartë pozicione të thella filozofike që Maturidiu nuk i bën kurrë të qarta. Bezdeviu në mënyrë të shkëlqyer vëren se *Kitabu 't-Tevhid* ka pjesë të gjata dhe të pakapshme, dhe mjaftë zhgënjyes në organizimin e tij.²⁸ Askund kjo nuk është më e qarta se sa në diskutimet e Maturidiut për 'natyrat' (*taba'i*) e ndryshme që përbëjnë gjërat në univers.²⁹ Sipas tij, të gjitha gjërat në botë përbëhen nga "natyra të ndryshme dhe të kundërta" (*Taba'i' muhtelifeh ve mute dadde*). Këto natyra përfshijnë cilësi të tilla si nxehtësia dhe ftohtësia, lagështia dhe thatësia e tjera, që pavarësisht se janë drejtpërdrejt kontradiktore me njëra-tjetrën, mund të shihen si të ekzistuar në një qenie ose trup të vetëm. Kështu, argumenton Maturidiu, duhet të ekzistojë ndonjë qenie më e lartë që është në gjendje t'i kombinojë këto cilësi të përkundra të një gjë të vetme. Me fjalë të tjera, diskutimi i parë i Maturidiut për teorinë e tij të natyrave të kundërta vjen në rrjedhën e provave të tij për ekzistencën e Zotit.³⁰ Maturidiu vazhdon ta përmendë këtë teori të natyrave gjatë

gjithë veprës së tij dhe është vendi i saktë i kësaj teorie në sistemin e tij më të gjerë metafizik që ka tërhequr kaq shumë interes te studiuesit e tekstit të tij.³¹ Po aq të fshehta janë referencat e tij për nocionin se cilësi të tilla të kundërta, si e mira dhe e keqja, duhen kuptuar në lidhje me wrrethanat specifike në të cilat ato shfaqen:

Nuk ka asnjë grimcë të vetme të qenies (*xhevher*) që i referohet në thelb një karakteristike të vetme, si dëmi dhe përfitimi, ose e keqja dhe mirësia, ose bekimi dhe mundimi. Përkundrazi, çdo gjë e karakterizuar nga e keqja mund të jetë gjithashtu e mirë në një aspekt (*vexhh*) që është i ndryshëm nga kuptimi i tij origjinal si i keq, dhe po ashtu për të gjitha atributet. Gjendjet (*ahval*) të gjërave janë të tilla që nuk janë dobi në çdo gjendje (*hal*) apo dëm në çdo gjendje.³²

Një gjuhë e tillë është shumë e zakonshme në *Kitabu 't-Tevhid*, i cili vazhdimisht i referohet shumëfishimit dhe ndryshueshmërisë së gjërave si një mënyrë për të vërtetuar ekzistencën e një qenieje të vetme hyjnore që duhet të kontrollojë të gjitha, përndryshe do të rezultonte kaos dhe harresë. Kjo është në fakt përmbytja e argumentit të parë të Maturidiut për ekzistencën e një krijuesi në *Kitabu 't-Tevhid*, në rrjedhën e të njëjtit diskutim ku ai prezanton teorinë e tij të natyrave.³³ Pra, është e qartë se nocioni i natyrave dhe ndryshueshmëria e përbërësve themelorë të realitetit në vetvete janë qendrore për vizionin e tij të përgjithshëm teologjik.

Në një tjetër vend Maturidiu thotë: E vërteta e çështjes [për sa i përket diskutimeve për drejtësinë ose padrejtësinë e veprimeve të Zotit] është se padrejtësia dhe marrëzia janë të dënueshme dhe se drejtësia dhe urtësia janë të mira në tërësi. Sidoqoftë, një gjë mund të jetë mençuria në një gjendje (*hal*) dhe marrëzia në një tjetër, padrejtësia në një gjendje dhe drejtësia në një tjetër.³⁴

Termi *hal* është përkthyer këtu në kuptimin më teknik të “gjendjes” megjithëse fjala natyrisht mund t’i referohet po aq lehtësisht rrethanës ose situatës. Megjithatë, përmbajtja metafizike e këtyre diskutimeve, si përdorimi i termave të tillë si ‘thelb’, tregon se Maturidiu nuk po flet në mënyrë eufemiste. Përkundrazi, ai po përdor termin *hal* me konotacionet e plota metafizike që zakonisht mbart në *kelam*, duke iu referuar kushteve specifike në të cilat një gjë e veçantë përmbushet në botën reale. Megjithatë, pasazhi i parë në veçanti duket se kundërshton drejtpërdrejt nocionin e Maturidiut për natyrat konfliktuale që brendashkruajnë gjithçka në univers, sepse si mund të ndodhë që këto natyra ekzistojnë në çdo send, por në të njëjtën kohë çdo gjë nuk mund të thuhet se zotëron ndonjë cilësi që e përkufizon atë në ndonjë kuptim të veçantë? Si mundet që një gjë të jetë edhe e përcaktuar në themel dhe në të njëjtën kohë e papërcaktuar?

Një paradoks i ngjashëm duket se ekziston në diskutimin e epistemologjisë së Maturidiut.³⁵ Shqetësimi i Maturidiut me teorinë e dijes ka qenë prej kohësh me interes të madh për studiuesit. *Kitabu ‘t-Tevhid* është me të drejtë i famshëm për diskutimin fillestar të detajuar të epistemologjisë, megjithëse siç thekson Franz Rosenthal, Maturidiu sigurisht nuk ishte mendimtari i parë mysliman që diskutoi probleme filozofike të këtij lloji.³⁶ Maturidiu parashtroi një teori të njohurive në detaje të tilla si pasojë e drejtpërdrejtë e shqetësimit të tij për të dalluar të vërtetën midis një deti opsionesh të mundshme fetare dhe filozofike. Përpjekja e tij për të formuluar një teori të plotë të dijes është një përpjekje për të dalluar kriteret universale me të cilat e vërteta mund të matet në mënyrë racionale. Në të vërtetë, ky theksim racional në mendimin e Maturidiut është, siç e pamë më lart, diçka e përbashkët e komunitetit të tij intelektual.³⁷

Përshtati: Haki Sabitaj

1. Shënim i autorit: Unë do të doja të falënderoja Richard Martin dhe Vincent Cornell për inkurajimin dhe komentet e tyre në drafet e mëparshme të këtij artikulli. 2. Për një trajtim më të gjerë të jetës dhe veprës së Maturidiut shih: A. Ak, *Büyük Türk alimi Maturî ve Maturîdilik* (İstanbul: Bayrak Matbaası, 2008); M. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam: A Study of the Theology of Abu Mansur al-Maturidi* (Kuala Lumpur: ISTAC, 1995) (Kjo vepër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga N. Ibrahim & M. Sinani & F. Ibrahim, Logos A, Shkup, 2015 – H. S); S. Kutlu, ‘Ebu Mansûr el- Maturî’nin Mezhebi Arka Planı’ në Sönmez Kudlu (ed.), *İmam Maturîdî ve Maturîdilik: tarihi arka planı, hayatı, eserleri, fikirleri, ve Maturîdilik mezhebi: seçki* (Ankara: Otto, revised edn., 2011), 139-60; S. Kutlu, *Türklerin İslamlaşma Sürecinde Mürcie ve Tesirleri* (Ankara: Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, 3rd edn., 2010), 271-84; U. Rudolph, *al-Maturidi and the Development of Sunni Theology in Samarkand* (përkth. Rodrigo Aden; Leiden: Brill, 1997) (Kjo vepër është përkthyer nga Arjol Guni, Logos A, Shkup, 2020 – H. S); B. Topaloğlu, ‘Ebü Mansûr El-Maturîdî Kelamî Görüşleri’ në Sönmez Kutlu (ed.), *İmam Maturîdî ve Maturîdilik*, 193-220. 3. Për prova të reja të cilat argumentojnë për vitin e tij të lindjes, shiko shënim e 6 më poshtë. Për shënime biografike rreth Maturidiut shih: ‘Abd al-Qadir ibn Abi al-Wafa’ al-Qurashi, *al-Gawahir al-muđdiyya fi tabaqatı l-hanafıyya* (ed. ‘Abd al-Fattah Muḥammad al-Hilw; Cairo: Dar Iḥya ‘Kutub al-‘Arabiyya, 1980-82, iii, no 1030; ‘Abd al-Hayy al-Laknawi, *al-Fawa’id al-bahıyya fi tarajim al-hanafıyya* (ed. Aḥmad el-Zu’bi; Beirut: Dar al-Arqam, 1998), no. 412; Zayn al-Din Ibn Qutlubugha, *Taj al-tarajim fi tabaqat al hanafıyya* (Baghdad: Maktabat al-Muthanna, 1962), no. 173. Informacione të dobishme për veprat e tij dhe aktivitetin intelektual po ashtu gjenden edhe në vëllimin e dytë të Abu al-Mu ‘in al-Nasafi, *Tebisiratü’l edille fi usulid-din* (ed. Hüseyin Atay; Ankara: Diyanet İşleri Başkanlığı, 2004), 471-4. 4. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*, 18. 5. Shih për shembull Abu al-Yusr al-Bazdawi, *Kitab Usul al-din* (ed. H. P. Linss; Cairo: Dar Iḥya ‘Kutub al-‘Arabiyya, 1963), 2. Teksti i Maturidut shpesh citohet edhe nga Nasafi në *Tebisiratü’l edille*. Aktualisht, ka vetëm dy përkthime të plota të dorëshkrimit të vetëm të mbijetuar të *Kitab et-Tevhid*-it, dhe të dyja këto në gjuhën turke: *Kitabü’l Tevhid* (përkth. H. S. Erdoğan; İstanbul: Hicret, 1981) dhe *Kitabü’l-tevhid Tercümesi* (përkth. B. Topaloğlu; Ankara: İSAM, 2002) (Në gjuhën shqipe ky version i *Kitab et-Tevhid*-it është përkthyer nga Metin Izeti, Logos A, Shkup, 2018 – H.S). Pjesët më kryesore të këtij teksti gjenden edhe në gjuhën angleze të J. M. Pessagno, ‘İrada, İkhtiyar, Qudra, Kasb: The View of Abu Mansur al-Maturidi’, *Journal of the American Oriental Society*, 104/1 (1984): 177-91, dhe J. M. Pessagno, ‘The Uses of Evil in Maturidian Thought’, *Studia Islamica*, 60 (1984): 59-82. 6. A. Ak, ‘Maturîdiliğin Ortaya Çıkışı’ në *Uluslararası Büyük Türk Bilgini İmam Maturîdî ve Maturîdilik Milleterarası Tartışmalı İlmi Toplantı*, 22-24 Mayıs 2009 - İstanbul (İstanbul: Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, :2012) 7. 451-435. Identifikuar nga von Kuegelgen and Muminov, e vendosur në librarinë Süleymaniye në Stamboll (Koleksioni Şehid Ali Paşa, nr. 1648/II, 18a-168b). Shih Anke von Kuegelgen dhe Ashirbek Muminov, ‘Maturîdî Döneminde Semerkand İlahiyatçıları (4./10. Asır)’ në Kutlu (ed.), ‘İmam Maturîdî ve Maturîdilik’, 279-91. Një detaj i rëndësishëm që ofrohet nga Ibn Jahja është se Maturidiu ka vdekur në moshën njëqind vjeç, duke e vendosur kështu lindjen e tij rreth viteve 232-3/846-8; shih A. Ak, ‘Maturîdiliğin Ortaya Çıkışı’, 440. 8. Po aty, 438. 9. Po aty, 437. 10. Po aty, 440. 11. Von Kuegelgen and Muminov, ‘Semerkand İlahiyatçıları’, 283. 12. Po aty, 284. 13. Po aty. 14. Po aty. 15. Po aty, 285. 16. Po aty, 287; Ak, ‘Maturîdiliğin Ortaya Çıkışı’, 443. 17. Po aty. 18. Bezdevi, *Usul ed-din*, 21. 19. Al-Maturidi, K. al-Tawḥid (ed. B. Topaloğlu and M. Aruçi; İstanbul: İrsad Kitap Yayın Dağıtım; Beirut: Dar Şadîr, 2007),

65-66. 20. O. Aydın, *Fethinden Samaniler’in yıkışına kadar: Semerkant tarihi* (93-389/711-999) (İstanbul: İSAM Yayınları, 2011), 505. 21. Po aty, 507. 22. Po aty, 511. 23. Po aty, 513. 24. Nesefi, *Tebisiratü’l edille*, 469. Sydney Griffith jep një përshkrim të gjallë të një prej këtyre seancave debati të mbajtura midis anëtarëve të sekteve të ndryshme fetare në Bagdad gjatë së njëjtës periudhë kohore (fundi i shekullit të dhjetë të e.s.) në Kisha në hijen e xhamisë: të krishterët dhe myslimanët në botën e Islamit (Princeton, NJ: Princeton University Press, 2008), 64. Ky rreth diskutimi përfshinte anëtarë të ndryshëm si të krishterët, myslimanët, hebrejtë, zoroastrianët dhe materialistët dhe ateistët filozofikë. Sipas raportit, debati u krye mbi bazën e provave të arsyetuara në mënyrë që të lejonte grupin të bisedonte me njëri-tjetrin në një kuadër të përbashkët që nuk apelonte për pretendimet e autoritetit që një anëtar ose tjetri mund të mos i pranonte. Kjo metodë e debatit duket se është shumë e ngjashme me llojin e argumentimit teologjik që mbron Maturidiu në *Kitabu ‘t-Tevhid*. 25. M. Ceric, *Synthetic Theology*, 34. 26. Po aty, 66. 27. Nesefi, *Tebisiratü’l edille*, 476. 28. Bezdevi, *Usul ed-din*, 3. Topaloğlu dhe M. Aruçi në hyrjen e botimit të veprës së tyre propozojnë që stili jashtëzakonisht i çuditshëm i Maturidiut në arabisht nganjëherë tregon se ai nuk mund të kishte qenë me origjinë etnike arabe. Ata vazhdojnë të sugjerojnë se për shkak se shumë nga fjalitë në vepër duket se imitojnë sintaksën turke, nuk është e pamundur që ai mund të ketë qenë me origjinë etnike turke. Shih Topaloğlu dhe M. Aruçi, 11. Ceric (*Synthetic Theology*, 53) gjithashtu thekson, për shembull, se ndër të tjera, përdorimi i parafjalëve nga Maturidiu është jashtëzakonisht i pazakontë. 29. Për këtë temë shih R. Frank, ‘Notes and Remarks on the *ṭaba’i* in the Teaching of al-Maturidî’ në Pierre Salmon (ed.), *Mélanges d’islamologie* (Leiden: Brill, 1974): 137-49; dhe U. Rudolph, *al-Maturidî*, 253-60. 30. Maturidi, *Kitab et-Tevhid*, 78, 211, 208. 31. Rudolph, *al-Maturidî*, 259) arrin në përfundimin se Maturidiu i interpreton këto natyra si një lloj tjetër aksidenti (‘a’rad), që do të thotë se Maturidiu kombinon elementet e metafizikës kelam islame me konceptet antike filozofike. Frank (‘Notes and Remarks’, 147) gjithashtu thekson me të drejtë se në të njëjtën kohë Maturidiu zvogëloi ndjeshëm rolin determinist që luajnë këto natyra në disa sisteme filozofike mu’tezili dhe antike. 32. Maturidi, *Kitab et-Tevhid*, 88. Pessagno gjithashtu diskuton këtë pasazh në rolin e tij si një provë për ekzistencën e një Zoti të vetëm: shih Pessagno, ‘The Uses of Evil’, 74-5. 33. Maturidi, *Kitab et-Tevhid*, 78; Pessagno, ‘The Uses of Evil’, 75. 34. Po aty, 297. 35. Trajtimi më i detajshëm dhe i gjerë rreth epistemologjisë së Maturidiut është studimi i shkëlqyer nga H. Özcan, *Maturîdî’de Bilgi Problemi* (İstanbul: Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, 2nd edn., 1998). Po ashtu shih J. M. Pessagno, ‘Intellect and Religious Assent: The View of Abu Mansur al-Maturidî’, *Muslim World*, 69/1 (1979): 18-27; U. Rudolph, ‘Ratio und Überlieferung in der Erkenntnislehre al-Aṣ’aris und Maturidîs’ *Zeitschrift der Deutschen Morgenländischen Gesellschaft*, 142/1 (1992): 72-89; M. Ceric, *Synthetic Theology*, 83-92; U. Rudolph, *al-Maturidî*, 255-7. 36. Franz Rosenthal, *Knowledge Triumphant: the Concept of Knowledge in Medieval Islam* (Leiden: Brill, 2007), 210-11; shih po ashtu H. Özcan, *Maturîdî’de Bilgi Problemi*, 29. 37. Rreth racionalizmit dhe përdorimit të arsyes në epistemologjinë e Maturidiut shih Pessagno, ‘Intellect and Religious Assent’, 21; U. Rudolph, *al-Maturidî*, 231; Özcan, *Maturîdî’de Bilgi Problemi*, 208-9. Ndërsa për konceptimin e arsyes te Maturidiu shih studimin e shkëlqyer të H. Alper, *İmam Maturîdî’de Akıl-Vahiy İlişkisi* (İstanbul: İz Yayıncılık, 2010).

Mr. Driton Arifi

Fisnikëria e misionit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së institucionit të vakëfit

Pasuritë e vakëfeve janë një amanet i njerëzve bujarë e shpirtçiltër myslimanë, që i kanë lënë në duart e rojtarëve besnikë.

Vakëfet janë një fenomen human e shoqëror, që burojnë në krejt natyrshëm nga shpirti dhe morali hyjnor islam. Ai është njëri prej institucioneve sociale që kishte dhe do të ketë një ndikim të pashembullt në ndërtimin e zhvillimin e vendeve myslimane.

Duke qenë të tilla, këto institucione me peshë, shpeshherë u rrezikuan e u atakuan gjatë gjithë historisë. Mirëpo, ato iu mbijetuan të gjitha sfidave e furtunave me tendencë shfarosëse, falë Zotit së pari, por pastaj edhe falë një kujdestarie fisnike që ia kushtuan atyre pasurive, myslimanët gjithandej në viset islame.

Pasuritë e vakëfeve janë një amanet i njerëzve bujarë e shpirtçiltër myslimanë, që i kanë lënë në duart e rojtarëve besnikë. Dhe vakëfet ekzistente edhe sot në të gjitha vendet islame janë një dëshmi e gjallë e ruajtjes së këtij amaneti. Pa një përkujdesje e vetmohim të tillë, ato do të zhdukeshin e do të harroheshin që moti. Për këtë tipar të besnikërisë ndaj amaneteve, e të ruajtjes së pasurive publike, Zoti i Madh na foli e na solli shembuj ilustrues, të cilët edhe sot motivojnë secilin njeri zemërdëlirë që të stoliset me këtë tipar.

Në një rrëfim të mahnitshëm të kësaj besnikërie, Kurani rrëfen edhe një insert domethënës nga jeta e të

“(Jusufi) tha: “Më cakto të udhëheq për thesarin e vendit. Unë, me të vërtetë, jam ruajtës (besnik) dhe i dijshtëm. Dhe kështu, ia dhamë Jusufit pozitën në vend (Misir), dhe ai në të vendosej ku të donte.” (Jusuf, 53-55)

dërguarit të Allahut, Jusufit a.s.. Ai pasi që u ofrua nga prijësi i Egjiptit, brenda oborrit “mbretëror” si njeri i dijshtëm dhe me virtyte të larta morale, iu besua edhe një detyrë tejet e ndjeshme, e që ishte ruajtja, zhvillimi dhe menaxhimi i financave të shtetit. Kurani e dëfton këtë insert të bisedës së Jusufit a.s., me rastin e ngarkimit të tij me këtë detyrë. Ai na tha: “Dhe tha sundimtari (mbreti): “Ma sillni atë (Jusufin), do ta marrë në suitën time (si këshilltar special)”. E, pasi bisedoi me të, i tha: “Prej sot, ti te ne, ke pozitë të lartë dhe je i besuar”. (Jusufi) tha: “Më cakto të udhëheq për thesarin e vendit. Unë, me të vërtetë, jam ruajtës (besnik)



dhe i dijshtëm. Dhe kështu, ia dhamë Jusufit pozitën në vend (Misir), dhe ai në të vendosej ku të donte. Na e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam. Bamirësve, Ne nuk ua humbim shpërblimet.” (Jusuf, 53-55).

Që nga ky çast, personaliteti i Jusufit a.s. tashmë ballafaqohet me sfida e sprova të reja, që për nga natyra dallojnë nga sprovat e mëhershme. Ai la pas sprovat e zilisë së vëllezërve dhe ato të tundosjes nga gjinia e kundërt, duke shpëtuar me ndihmën e Zotit, faqebardhë e pa njolllosje në karakterin e tij. Ndërsa tani, ai ka para vetës sprovën e besueshmërisë, autoritetit, namit e të pozitës. Në duart e tij tashmë janë “çelësat” e thesareve të Egjiptit. Ai ishte që përcaktonte se kush dhe sa duhet të merrte nga ato thesare mbretërore.

Përshkrimi kuranor për tiparet e Jusufit a.s. siç do të thoshte tefsirologu me nam, Muhamed T. bin Ashuri, është përvijimi më i kompletuar i tipareve e virtyteve që i nevojiten një njeriu që i besohet një detyrë publike. Kështu, nëpërmes diturisë e njohurisë së tij, ai do t'i veprojë ato gjëra që janë të dobishme e në interes publik. Ndërsa me besueshmërinë e tij, ai do t'ua realizojë të drejtat njerëzve që janë të denjë për to (e nuk do të jetë përvetësues). Kështu Jusufi a.s. e kërkoj përgjegjësinë e ruajtjes së thesarit e të financave të shtetit, si dhe të shpërndarjes së drejtë e korrekte të atyre pasurive, tek ata që janë meritore për të.¹

Edhe i Dërguari ynë, Muhamedi s.a.v.s. duke dëshiruar që të përshkruaj vlerën e këtij amaneti, dhe se sa do të shpërblehet ai që e kryen atë në formë besnike, na tha: “Rojtari i pasurisë (publike) që është besnik, dhe që e shpenzon me çiltërsi atë që i është besuar, dhe këtë e bënë në formë të denjë e të plotë të meritoret për të cilët është urdhëruar, konsiderohet sikur njëri prej kontributdhënësve - dhuruesve të asaj pasurie.”²

Pra, meqë misioni i ruajtjes së pasurisë publike, veçanërisht asaj të vakëfeve është tejet i shenjtë aq sa edhe i vështirë, andaj edhe shpërblimi për këtë vepër fisnike nëse kryhet me besnikëri është po ashtu madhështor. Hadithi, e bëri bashkëpjesëmarrës në shpërblim, edhe rojtarin besnik të asaj pasurie, sikurse vetë kontribuesin e saj.

Ç'është kujdestaria ndaj vakëfeve dhe cila është pesha e saj në të drejtën islame?

Meqenëse vakëfet janë një nga institucionet më të fuqishme ekonomike, sociale, kulturore e humane islame, natyrshëm që myslimanët, gjatë gjithë historisë, i kushtuan një kujdes të veçantë ruajtjes, mirëmbajtjes e zhvillimit të tyre.

Pra, kujdestaria ndaj vakëfeve nënkupton atë kompetencë ligjore që e autorizon personin (fizik apo juridik) të ruajë, menaxhojë e shpërndajë përfitimet e tij të fondacionet ose personat meritore.³

Për këtë detyrë u përcaktuan-emëruan njerëz që kanë atributet e virtyteve të larta, të cilët do të kujdeseshin për ruajtjen e vakëfeve, si dhe do të bënë përpjekje maksimale për menaxhim të mirëfilltë të tyre. Personat që morën mbi supet e veta këtë detyrë, në literaturën islame i gjejmë të emërtuar ose me termin نَاطِرُ الْوَقْفِ - Nadhir el Vakf (kujdestar-ruajtës i vakëfit) ose الْمُؤَيِّ - Mutevel-liij (Menaxhues i vakëfeve dhe i autorizuar për përkujdesje ndaj tyre).

Mbi supet e kujdestarit është vendosur një amanet jo edhe aq i lehtë, që nëse do të kryhej me besnikëri, vakëfet dhe fondacionet e tyre do të sjellin përfitime të mëdha për besimtarët, por edhe për vetë kujdestarin, ngase ai do të shpërblehet nga Allahu i Madhërishtëm për punën fisnike që e ka kryer. Edhe në të kundërtën,

nëse ka shpërfillje të përgjegjësisë, apo neglizhim të saj, pasojat do të vërehen te kujdestari, sepse i tilli do t'i shkoj Allahut me një barrë të rëndë të mëkatit, ndërsa edhe myslimanët do të pësojnë, ngase ata në këtë rast nuk po përfitojnë nga një fondacion i tillë, i cili është i bërë e ligjësuar për ta përmirësuar jetën e tyre në atë vend.

Të drejtën ekskluzive të përcaktimit të kujdestarit të vakëfit, apriori, sipas mendimit të të gjithë dijetarëve islame e ka vakëflënësi, nëse ai veç dëshiron që ta bëjë këtë përcaktim. E nëse ai nuk dëshiron që ta përcaktojë kujdestarin, ose ka heshtur dhe nuk ka përcaktuar fare askënd, atëherë kujdestarinë e vakëfit e merr gjykatësi islam. E nëse ai nuk ekziston, atëherë këtë kujdestari e merr përsipër vetë personi fizik ose juridik të cilit i është lënë ajo pasuri vakëf.⁴

Sot, në shumë prej shteteve islame këtë mision e kryejnë ministratë gjegjëse, të ashtuquajturat Ministratë e Vakëfeve, e diku ndoshta Drejtoritë e Përgjithshme të Vakëfeve. Ndërsa në vendet ku myslimanët kanë krijuar komunitete të konsoliduara fetare, por që shteti nuk interferon në çështjet e fesë (sikur te ne myslimanët e Ballkanit, apo edhe gjetiu), ky obligim, krejt natyrshëm ka mbetur nën përkujdesjen e Institucioneve Fetare Islame, siç janë bashkësitë islame. Kjo, për dallim nga shumë shtete të ndryshme të Evropës, ku myslimanët janë pakicë, e që aty gjejmë që me kujdestarinë e ndonjë vakëfi eventual, merret ndonjë këshill fetar islam, ndoshta edhe i karakterit lokal, ndonjë organizatë apo shoqatë islame që merret me mbarëvajtjen e jetës fetare islame atje.

E, para se të themeloheshin Ministratë e Vakëfeve apo Drejtoritë e Përgjithshme, në ato shtete islame, deri në një periudhë jo shumë të largët, ekzistonte një rend ligjor i bazuar në mendimin i lartcekur juridik, që kompetencën e përcaktimit të kujdestarit të vakëfeve e kishte vetë vakëflënësi e jo dikush tjetër. Por, më vonë ky rend është



ndryshuar, dhe kompetenca e përcaktimit të kujdestarit të vakëfit ka kaluar te gjykatat gjegjëse e jo më te vakëflënësi. Ky ndryshim është bërë për shkak të problemeve që kanë lindur nga mos menaxhimi i denjë i vakëfeve prej atyre njerëzve që ndoshta në syrin e vakëflënësit ishin meritore, por që të njëjtit nuk arritën të realizojnë synimet sublime të vakëflënies.⁵

Andaj, edhe është relevante të theksohet ky fakt se, institucionalizimi i përkujdesjes ndaj pasurisë së vakëfeve është një hap para në rrugën e zhvillimit e konsolidimit të mirëfilltë të këtij sektori kaq të rëndësishëm për jetën e myslimanëve. Natyrisht që kujdestaria ndaj vakëfeve po që se është individuale, gjithmonë është më e mundshme që të tillat pasuri t'i ekspozohen rrezikut të asgjësimit apo të përvetësimit të saj nga ana e njerëzve të papërgjegjshëm. Ndërsa në rast të institucionalizimit të saj, zvogëlohen mundësitë për një gjë të tillë, ani pse sërish duhet syçelësi e inspektim vigjilent nga institucionet gjegjëse.

Kushtet që duhen plotësuar nga ata që merren me kujdestarinë e vakëfeve

Personat që autorizohen nga cilido institucion qoftë për pakujdesje ndaj vakëfeve, apo edhe ndoshta dikur që janë autorizuar nga vetë vakëflënësit, duhet doemos të posedojnë tipare e virtyte të larta fetare, e morale. Një shfletim i literaturës juridike islame, na zbulon se juristët islamë, nga të gjitha shkollat juridike islame, i kanë specifikuar kriteret e kushtet, që i kanë kushtëzuar t'i kenë kujdestarët e vakëfeve, në mënyrë që të sigurohet se ato do të menaxhohen në formë të denjë, e rrjedhimisht do të jenë edhe dobiprurëse për shoqërinë islame në çdo kohë.

Përpos tri kushteve të njohura, që kushtëzohen pothuajse në të gjitha përgjegjësitë njerëzore, dhe pa të cilat njeriu nuk ngarkohet me asnjë përgjegjësi as para Allahut (pra të jetë mysliman, moshërritur e mentalisht i shëndoshë), për personat e tillë (mutevl-litë) kushtëzohen edhe këto dy kushte:

-Besueshmëria e korrektësia fetare – El-Adaleh. Por, cila është domethënia eksplicite e besueshmërisë e korrektësisë, si tipare të kujdestarit të vakëfeve?

Imam Zejleu, nga dijetarët e mëdhenj të hanefitëve thoshte se me “el-adaleh” për qëllim është përmbajtja ndaj normave të Islamit dhe kthjelltësia e mendjes.

Ndërsa Ibën Haxhibi, nga dijetarët malikit, thoshte se me të është për qëllim, praktikimi i Islamit, shmangia nga mëkatet e mëdha dhe mos këmbëngulja ose mos vazhdimësia në ato të voglat.

Ndërsa, Xhelaluddin es-Sujutij, nga kolosët e shkencave të ndryshme islame, kishte dhënë një përkufizim që me të janë pajtuar një pjesë e madhe e dijetarëve edhe të

mëvonshëm. Ai tha se me për qëllim me “el-adaleh” është ai virtyt ose tipar i ngulitur në personalitetin e njeriut që e pengon atë nga kryerja e ndonjë mëkati të madh, apo ndonjë mëkati të vogël, por i cili tregon për karakter të ulët, apo që vepron ndonjë vepër që është e lejuar, por që bie ndesh me tiparet e burrërisë islame (El-Muruetu).⁶

Këto kriteret, siç edhe vërehen, janë vendosur kryekëput për të ruajtur së pari pasurinë e vakëfeve nga shpërdorimi, por pastaj edhe për të ruajtur kujdestarin e vakëfeve nga mëkatimi.

-Kompetenca dhe aftësia – El-Kefaetu. Me këtë tipar është për qëllim aftësia e personit që të përkujdeset për vakëfet në mënyrë që ai të menaxhojë në mënyrë të mirëfilltë me vakëfet, si pasuri me vlerë që është lënë amanet në duart e tij.⁷

Këto dy tiparet e fundit, pos atyre të njohurave që kuptohen apriori (mysliman, moshërritur, mentalisht i shëndoshë), janë thelbësore për një mbarëvajtje e zhvillim të pasurive vakëfnore, që në literaturën islame i gjejmë se janë trajtuar si amanete që u janë besuar njerëzve përgjegjës për to.

Të tillat kriteret nuk vjetërsohen e as nuk de-legjitimohen me kalimin e kohës, ngase si të tilla burojnë nga argumentet dhe fryma e përgjithshme e dispozitave hyjnore islame.

1. Muhamed Tahir bin Ashur, *Et-Tahrir Ve et-Tenvir* (6/8). Bot. i parë, Daru Sahnun, Tunis, 1997. 2. *Hadithin e evidenton Buhariu në "Sabih" të tij* (nr: 2319), *Muslimi në "Sabih"* (nr: 1023), pra hadithi është *Mutefak alejhi*, por është koleksionuar edhe nga të tjerët. 3. Muhamed Mustafa esh-Shelebij, *Ehkam El-Vesaja ve El-Evakaf*, (fq.398). Bot. i katërt, Daru El-Xhamijeh, 1982. 4. *Shih: Muhamed Ebu Zehre, Muhaderat Fi El Vakf*, (fq.307). Bot. i dytë, Daru el Fikr El Arabij, Kajro, 1972. Pastaj shih edhe: *El-Mevsuat El-Fikhijje El-Kuvejrijje*. (36/100). Bot. i dytë nga Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Islame të Kuvajtit, 1427 lunar. 5. Muhamed Mustafa esh-Shelebij, *Ehkam El -Vesaja ve El-Evakaf*, (fq.399). Bot. i katërt, Daru El-Xhamijeh, 1982. 6. Muhamed el-Kubejsi, *Abkam El-Vakf Fi Esh-Sheriah El-Islamijeh*. (2/165-166). Bot. i parë, Matbeatu El-Irshad. Bagadad, 1977. 7. Dr. Vehbetu ez-Zubejlij, *El-Fikh El-Islamij Ve Edil-letuhi* (10/7687). Bot. i katërt, Daru el Fikr, Damask, 2004.

Dr. Ali es-Sallabij

Strategjia e hazreti Omerit r.a. në përzgjedhjen e pasardhësit të tij

Omeri r.a. vazhdoi interesimin e tij për unitetin e ymetit dhe të ardhmen e tij deri në momentet e fundit të jetës së tij, pavarësisht nga ajo që në momentet e fundit të jetës vuante nga dhimbjet e plagëve të rënda. Nuk ka dyshim se ato momente ishin momente unike, me ç' rast shfaqet bindja e thellë e Omerit r.a. dhe sinqeriteti i tij i pashoq.

Ai shpiku një metodë të re e cila nuk qe e njohur më parë në zgjedhjen e halifit të ri. Sigurisht ky hap ishte një dëshmi e prekshe dhe një shenjë e qartë e të kuptuarit të tij të thellë ndaj politikës së udhëheqjes së shtetit. I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., kishte kaluar para tij në botën tjetër dhe ai nuk kishte caktuar askënd pas tij si udhëheqës të pushtetit, me një tekst të qartë. Ndërsa kur Ebu Bekri r.a. kaloi në botën tjetër propozoi që pas tij të vinte në pushtet Omeri r.a.. Këtë propozim e bëri pas konsultimit të tij me sahabët e njohur. Kur Omerit r.a., duke qenë në shtratin e vdekjes, ju kërkua që ta propozoj një pasardhës pas tij, ai u mendua me kujdes dhe vendosi që të përdorte një metodë tjetër e cila do të ishte e përshtatshme për rrethanat e krijuara. Ai e dinte se i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., kur u largua nga kjo botë, të gjithë njerëzit e dinin epërsinë dhe vlerën e Ebu Bekrit ndaj të tjerëve, prandaj edhe mundësia e kundërshtimit ishte minimale, veçmas kur dihej se Pejgamberi a.s. edhe teorikisht, por edhe praktikisht kishte aluduar se më meritori pas tij, në udhëheqje, do të jetë Ebu Bekri r.a.. Ndërsa kur Ebu Bekri r.a. emëroi Omerin pasardhës, e dinte se të gjithë sahabët kishin bindjen se Omeri ishte më i fuqishmi dhe më i miri, që do ta mbante këtë përgjegjësi pas tij, kështu që ai e emëroi atë si pasardhës

**Numri i sahabëve
në kuadër të
Këshillit
Konsultativ ishte
gjashtë. Ata ishin:
Ali ibën Ebi
Talibi, Osman
ibën Afani,
Abdurrahman
ibën Avfi, Sead
ibën Ebi Vekasi,
Zubejr ibën Avami
dhe Talha ibën
Ubejdilah r.a.**

pasi u konsultua me sahabët e vjetër, dhe asnjëri prej tyre nuk ishte kundër mendimit të tij, gjë që u arrit konsensusi për zotimin ndaj Omerit r.a. si udhëheqës.

Sa i përket metodës së zgjedhjes së halifit të ri, të cilën e kishte menduar Omeri r.a., kjo metodë bazohet në parimin e Shurës-konsultimit të një numri të kufizuar. Ai i përcaktoi 6 persona nga sahabët-shokët e të Dërguarit të Zotit a.s.. Që të gjithë ata ishin kompetent dhe të përshtatshëm për të marrë përsipër çështjen e udhëheqjes, edhe pse mes tyre kishte dallime. Ai e specifikoi mënyrën dhe kohëzgjatjen e zgjedhjes, numrin e votave të mjaftueshme për të zgjedhur halifin, numrin e votave në kuvend, si dhe referencën se si të veprohet nëse numri i votave është i barabartë. Ai



gjithashtu dha urdhrin që një grup ushtarakësh ta monitoronin procesin e zgjedhjeve në kuvend, në rast nevojë të ndërhyjnë ndaj atyre që shkelin rendin dhe konsensusin e grupit, si dhe të parandalojnë kaosin. Detyrë e tyre gjithashtu ishte edhe mos lejimi i askujt që të hyjë apo të dëgjojë se çfarë bëhet në këshillin për zgjedhjen e halifit.

Numri i sahabëve të cilët Omeri r.a. i përcaktoi që të jenë pjesë e Këshillit Konsultativ dhe emrat e tyre

Numri i sahabëve në kuadër të Këshillit Konsultativ ishte gjashtë. Ata ishin: Ali ibën Ebi Talibi, Osman ibën Afani, Abdurrahman ibën Avfi, Sead ibën Ebi Vekasi, Zubejr ibën Avami dhe Talha ibën Ubejdilah r.a. Ndërsa Seid ibën Zubejri, edhe pse ishte prej dhjetë sahabëve të përgëzuar me Xhenet, hazreti Omeri r.a. nuk e futi në kuadër të Këshilli. Ndoshta këtë Omeri r.a. e bëri për shkak se Seidi ishte nga fisi i tij, dhe siç ka qenë e ditur, Omeri r.a. ishte shumë i kujdesshëm në këtë pikë dhe asnjëherë të afërme nuk u jepte pozita udhëheqëse, edhe pse në mesin e tyre kishte njerëz mjaft kompetent dhe të zotët.

Mënyra e përzgjedhjes së kalifit

Ai i urdhëroi ata që të mblidhen në shtëpinë e njërit prej tyre dhe të konsultohen. Në mesin e tyre ishte edhe Abdullah ibën Omeri në cilësinë e këshilltarit, dhe nuk kishte asnjë lidhje me çështjen e votimit. Namazin ua falte Suhejb err-Rumi të cilit Omeri r.a. i tha: “Ti je prijësimami i namazit në këto tri ditë.” Këtë, Omeri r.a. e bëri me qëllim, që asnjëri prej atyre të gjashtëve të mos jetë prijës në namaz, dhe një gjë e tillë të konsiderohet si përparësi ndaj tjerëve. Ndërsa Mikdad ibën Esvedin dhe Ebu Talha el-Ensariun i urdhëroi që ta monitorojnë zhvillimin e procesit zgjedhor.

Omeri r.a. bashkoi ndërmjet metodës së caktimit të udhëheqësit, siç kishte vepruar Ebu Bekri r.a., dhe mes metodës së moscaktimit të udhëheqësit, siç kishte vepruar Pejgamberi a.s..

Afati i zgjedhjeve ose i konsultave

Këtë afat e përcaktoi vetë Omeri r.a., dhe ishte tre ditë, duke llogaritur se është kohë e mjaftueshme për të arritur deri te një konsensus. Ai i porositi ata duke ju thënë: mos të vijë dita e katër e ju ende nuk e keni përcaktuar njërin prej juve udhëheqës.

Numri i votave të mjaftueshme për zgjedhjen e kalifit

Ibën Seadi përcjell me transmetim të saktë i cili thotë se Omeri r.a. i kishte thënë Suhejbit: “Falu namazin tri ditë, ky grup le të qëndrojnë në shtëpi, nëse arrijnë marrëveshje për njërin prej tyre, atëherë ai që i kundërshton le t'i hiqet koka.”

Omeri r.a. urdhëroi që të ekzekutohet ai i cili kundërshton grupin, prish unitetin e myslimanëve dhe fut përçarje mes tyre, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s.: “Kush paraqitet pranë jush duke qenë ju të bashkuar ndaj një personi, dhe dëshiron të prish unitetin tuaj dhe të shkaktoj përçarje, atëherë mbyteni atë.”¹

Zgjidhja në rast të mospajtimit

Omeri r.a. i kishte porositur që në mesin e tyre të jetë edhe Abdullah ibën Omeri, i cili nuk do të ketë

ndonjë ndikim në proces. Mirëpo Omeri ju tha atyre: “Nëse vini në pozitë ku tre janë për njërin, ndërsa tre janë për tjetrin, atëherë merreni mendimin e Abdullahut dhe përzgjidheni nga grupi për të cilin përcaktohet Abdullahu. E nëse edhe me këtë nuk pajtoheni, atëherë përzgjidheni nga grupi në të cilin është Abdurrahman ibën Avfi, të cilin e kishte cilësuar si njeri të mençur duke thënë: Abdurrahmani është njeri i mençur, mendimet e tij janë të matura, ka mbrojtje nga Zoti prandaj dëgjojeni.”

Një grup ushtarakësh monitorojnë zgjedhjet dhe parandalojnë kaosin

Omeri r.a. kishte kërkuar nga Ebu Talha duke i thënë: “O Ebu Talha, nuk ka dyshim se Zoti xh.sh. e ka ndihmuar këtë fe përmes jush, andaj përzgjedh pesëdhjetë burra nga mesi i ensarëve dhe përkujdesuni ndaj këtij grupi derisa ta zgjedhin njërin prej tyre.”

Ndërsa Mikdad ibën Esvedit i kishte thënë: “Kur të më varrosni, atëherë tuboni këtë grup njerëzish në një shtëpi derisa ta zgjedhin njërin prej tyre.”

Omeri r.a. bashkoi ndërmjet metodës së caktimit dhe moscaktimit të pasardhësit

Me këtë metodë Omeri r.a. bashkoi ndërmjet metodës së caktimit të udhëheqësit, siç kishte vepruar Ebu Bekri r.a., dhe mes metodës së moscaktimit të udhëheqësit, siç kishte vepruar Pejgamberi a.s.. Ai përcaktoi gjashtë persona dhe kërkoj prej tyre që të konsultohen dhe në fund ta zgjidhnin njërin prej tyre.

Konsulta nuk ishte vetëm në mesin e të gjashtëve

Omeri r.a. ishte i vetëdijshëm se konsulta nuk do të realizohej vetëm në mesin e gjashtë personave të cilët i kishte përcaktuar, mirëpo ajo do të përfshijë edhe shumë mendime të njerëzve të tjerë në Medine rreth përcaktimit të halifit, për atë, ai iu

dha afat tre ditë. Gjatë kësaj periudhe ata kanë mundësi që të konsultohen, të marrin mendime të ndryshme dhe në fund të vijë deri te një mendim unik se kush është më meritori për ta udhëhequr shtetin. Kjo ngase në Medinë ishin shumica e sahabëve, dhe myslimanët që ishin jashtë Medinës ishin pasues të tyre kur ata ishin kompakt për një mendim, sepse deri në atë kohë, viti 23 hixhrij, Medina ishte vendi i sahabëve sepse shumica e sahabëve të vjetër ishin aty dhe Omeri r.a. i kishte urdhëruar ata që t'i qëndrojnë afër dhe mos të shpërngulen në provincat të cilat ishin çliruar.

Këshilli Konsultativ
si organi më i lartë politik

Omeri r.a. ia besoi Këshillit Konsultativ përzgjedhjen e kalifit nga mesi i tyre. Është me rëndësi të potencohet me këtë rast se asnjëri prej anëtarëve të Këshillit Konsultativ

Ajo që bëri Omeri, ishte të specifikonte metodën me të cilën do të zgjidhte halifin dhe të kufizonte një numër të caktuar në mesin e tyre, e këtë nuk e bëri i Dërguari a.s., e as Ebu Bekri r.a.

nuk e kishte refuzuar këtë vendim të cilin e kishte marrë Omeri r.a.. Gjithashtu as sahabët e tjerë nuk kishin shfaqur asnjë kundërshtim ndaj këtij vendimi. Këtë e themi duke u mbështetur

në tekstet të cilat i kemi në duart tona. Ne nuk dimë që në atë kohë është prezantuar ndonjë mendim apo alternativë tjetër e zgjedhjeve. Ose të ketë ndodhur ndonjë kundërshtim në momentet e fundit të jetës së Omerit r.a. ose pas vdekjes së tij. Mirëpo të gjithë njerëzit e kishin pranuar një propozim të tillë, duke llogaritur se një veprim i tillë është në të mirë të të gjithëve. Në rrethanat tona ne mund të themi se Omeri r.a. kishte përzgjedhur një organ të lartë politik, detyra e të cilit ishte zgjedhja e kryetarit të shtetit, ose halifit. Këtë sistem të ri kushtetues të cilin e kishte propozuar Omeri r.a. me mençurinë e tij nuk bie në kundërshtim me parimet esenciale të cilat i ka vendosur feja islame, veçmas asaj që ndërlidhet me Këshillin Konsultativ.

Në këtë mënyrë Omeri r.a. e përfundoi jetën e tij. Atë nuk e shpërqendroi fatkeqësia e cila e goditi, e as agonja e vdekjes që të kujdeset për rregullimin e punëve të myslimanëve. Ai vendosi një sistem të drejtë konsultimi që askush nuk i parapriu. Ne nuk kemi aspak dyshim se parimi i konsultimit është i bazuar në Kuran dhe në traditën teorike dhe praktike të Pejgamberit a.s.. Ajo që bëri Omeri, ishte të specifikonte metodën me të cilën do të zgjidhte halifin dhe të kufizonte një numër të caktuar në mesin e tyre, e këtë nuk e bëri i Dërguari a.s., e as Ebu Bekri r.a. I pari që e bëri këtë ishte Omeri dhe ishte ide e qëlluar, ishte metoda më e mirë dhe më e përshtatshme për gjendjen e sahabëve në atë kohë.

*Përktheu nga gjuha arabe:
Mr. Vedat Shabani*

Burimi: <https://www.aljazeera.net/blogs/16/12/2021>

1. Në disa libra të historisë potencohet se Omeri r.a. e ka urdhëruar këtë grup që të ulen dhe të konsultohen për çështjen e zgjedhjes së halifit. Ju ka thënë se nëse pesë prej tyre janë dakord për njërin dhe një kundërshton, atëherë atij që kundërshton t'i hiqet koka, gjithashtu nëse katër prej tyre janë të një mendimi dhe dy kundërshtojnë atyre dyve t'ju hiqet koka. Këto transmetime nuk janë të sakta. Janë transmetime të shpifura, të cilat i ka transmetuar Ebu Mihnefi i cili i përket sektit "Imamij" të shiave.



Dr. Jusuf el-Kardavi

A ndikon nataliteti në varfëri

“Nëse i frikësoheni skamjes, po deshi Allahu ju bën të pasur me dhuntitë e veta. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë” (Et-Tebve, 28).

Nuk ka lidhshmëri ndërmjet natalitetit dhe varfërisë

Perëndimorët bëjnë lidhshmëri ndërmjet natalitetit të vazhdueshëm në botë dhe varfërisë, si të ishte llogari matematikore: “Nëse shtohet numri i popullsisë, do të ekzistojë varfëria.” Atyre u mungon besimi në Allahun, besimi se kjo gjithësi e ka një Zot që është Krijues dhe Furnizues, i Cili, që nga krijimi i Tokës, çdo gjallesë ua siguron mjetet për jetesë. Ata nuk i mendojnë këto gjëra.

“Nëse shtohet numri i popullsisë, do të ekzistojë varfëria.” Këtë e kishte thënë një ekonomist i quajtur Maltos, i cili e paralajmëroi botën për një fatkeqësi të rrezikshme pas disa viteve ose dekadave. Mirëpo, kaluan disa dekada, madje edhe disa shekuj, e nuk ndodhi fatkeqësia, sepse Allahu ua përgatiti njerëzve shkaqet të cilat nuk i dinin më parë, e Allahu e mësoi njeriun me gjëra që nuk i dinte: “Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini” (En-Nahl, 8).

Njerëzit arrijnë të mbjellin toka të reja, e të dinë kulturën bujqësore të shkretëtirave, dhe të pakësojnë shfrytëzimin e ujit, pasi që tokat e tyre i ujitnin zhag për toke, filluan t’i ujitin me anë të spërkatjes ose pikëzimit, duke u munduar që të mos avullohet uji ose të humb kot. Madje, u përpoqën dhe e shtuan prodhimin në tokën e mbjellë, duke përmirësuar farën e mbjellë, dhe

toka e njëjtë, jepte frute më shumë se më parë.

Allahu xh.sh. me anë të ligjeve të trashëgimisë, shartimit të bimët dhe fekondimit të kafshët, u përgatiti njerëzve përmirësimin e cilësisë, dhe njeriut iu mundësua përdorimi i energjisë diellore. Allahu u përgatiti njerëzve shkaqe që nuk i menduan, ndërsa perëndimorët mendojnë se bota e sotme do të jetë edhe botë e së nesërme dhe e ardhmes. E ku ta dimë, se Allahu do t’u hap njerëzve dyer të cilat nuk i ka menduar askush?

“Bëgatitë, që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t’i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Fatir, 2).

Allahu është Furnizues

Prej emrave të Allahut është edhe emri “Er-Rezzak-Furnizues”. Allahu xh.sh. thotë: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre furnizim, e as s’dëshiroj të më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi” (Edh-Dharijat, 56-58).

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj. Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj. Të gjitha (këto) janë (të shënuara) në Librin e qartë (Levhi Mahfudhë)” (Hud, 6).

Mjetet për jetesë ekzistojnë, janë të shpërndara në këtë gjithësi, të deponuara në brendinë e Tokës, ose të shpërndara mbi sipërfaqen e saj. Ekzistojnë gjëra që njerëzit i dinë, por ekzistojnë edhe të tjera që ende nuk i dinë.

“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar. Pasha Zotin e qiellit dhe të Tokës, kjo (që ju premtohet) është një e vërtetë, ashtu siç është të folurit tuaj” (Edh-Dharijat, 22-23).

Mjetet për jetesë ekzistojnë, janë të shpërndara në këtë gjithësi, të deponuara në brendinë e Tokës, ose të shpërndara mbi sipërfaqen e saj. Ekzistojnë gjëra që njerëzit i dinë, por ekzistojnë edhe të tjera që ende nuk i dinë. Përafërsisht, ¾ e sipërfaqes tokësore janë ujëra, oqeanë dhe dete, të cilat Allahu i la në shërbim të njeriut, por ai nuk zbuloi çdo gjë që ekziston në det, e as nuk përfitoi prej shumë gjërave që ekzistojnë në të.

Mjetet për jetesë ekzistojnë, por njeriut i mbetet të mendojë e të kërkojë në viset e tokës, ta kërkojë furnizimin në vendet e fshehta të saj. Allahu xh.sh. thotë: “Ai ua bëri Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai.” (El-Mulk, 15).

Ai që ec nëpër viset e tokës, mendon, kërkon, përpiqet dhe mundohet, meriton të ushqehet prej furnizimit të Allahut nga kjo tokë, ndërsa, ai që dembeloset dhe i lë pas dore punët, meriton t'i ndalen furnizimet e Tij.

Qielli nuk lëshon ari e as argjend, siç ka thënë Omeri r.a., mirëpo njerëzit duhet të qarkullojnë nëpër tokë dhe t'i kërkojnë mirësitë dhe begatitë e Allahut, ta kërkojnë furnizimin e tyre për të arritur tek ai.

Mes injorancës së vjetër dhe asaj bashkëkohore

Injorantët e hershëm, i mbytnin fëmijët e tyre, për shkak se ishin të varfër ose frikësoheshin nga varfëria që mund t'u vinte: “Mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë,

sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata.” (El-En'am, 151).

“Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve (ushqimi i tyre është i garantuar për ta para se të krijohen). Vërtet, vrasja e tyre është mëkat i madh.” (El-Isra, 31).

Ndërsa, injorantët bashkëkohorë, dëshirojnë t'i mbysin fëmijët në barqet e nënave të veta, me anë të abortit. Fëmijët nuk duhet të mbyten, e ne nuk duhet t'i dorëzohemi kësaj injorance bashkëkohore.

Mjetet për jetesë ekzistojnë, janë të shpërndara në Tokë, prej kur që Allahu e krijoi Tokën: “E bekoi atë (Tokën) dhe përcakttoi në të furnizimin (për banorët) e saj me masë për katër ditë; ky është shpjegimi për të gjithë ata që pyesin. Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullie” (Fussilet, 10).

Është e vërtetë se rrësku (ushqimi) nuk jepet me shumicë dhe lehtë, ashtu që njerëzit të mos teprojnë e të mos mbrapshtën në Tokë: “Sikur Allahu t'i shtonte mjetet e jetesës për robërit e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron, sepse Ai i njuh dhe i sheh mirë robërit e Vet.” (Esh-Shura, 27). Allahu çdo gjë jep me masë: “Nuk ka asnjë send që të mos

Lejohet planifikimi i familjes për pasardhësit e tyre nëse ekzistojnë arsyet e justifikueshme me ligj, dhe nëse zgjedhja është bërë nga bashkëshortët, mirëpo refuzohet, që një gjë e tillë të bëhet filozofi e përgjithshme për mbarë njerëzinë.

gjenden te Ne, thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar.” (El-Hixhr, 21). Gjërat shfaqen në kohën e duhur sipas caktimit dhe urtësisë së Allahut.

Gjithashtu, Allahu xh.sh. thotë: “Ne ju kemi vendosur në tokë dhe aty ju kemi dhënë çfarë ju nevojitet për jetesë. Eh, sa pak mirënjohës që jeni! Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e mandej u thamë engjëjve: Përluni në sexhde Ademit!” (El-Araf, 10-11). Pra, para se Allahu ta krijojë Ademin dhe njerëzimin, Ai përgatiti nevojat e tyre për jetesë, e më pas Ai i krijoi. Mirëpo, ata sikur e kundërshtojnë Allahun, dhe mendojnë se janë dominues të çdo gjëje, ndërsa harrojnë se Allahu është Krijues e Furnizues, dhe Drejtues i të gjitha gjërave: “Thuaj: Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat? Ata do të thonë: Allahu. E ti (o Muhamed) thuaj: Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” (Junus, 31).





Mjetet për jetesë janë në duart e Allahut, prandaj, nuk duhet të bëjmë lidhshmëri ndërmjet natalitetit dhe varfërisë, një gjë e tillë është e pamundur, pasi që Allahu do t'i drejtojë njerëzit për mënyra dhe metoda që ua përgatisin njerëzve mjetet për jetesë dhe furnizimet që Ai ua garantoj atyre.

Mënyra të refuzuara për qëllime jo të mira

Lejohet planifikimi i familjes për pasardhësit e tyre nëse ekzistojnë arsytet e justifikueshme me ligj, dhe nëse zgjedhja është bërë nga bashkëshortët, mirëpo refuzohet, që një gjë e tillë të bëhet filozofi e përgjithshme për mbarë njerëzinë. Megjithatë, dikush dëshiron ta arrij qëllimin e vet nëpërmjet mënyrave të refuzuara, që refuzohen si në pikëpamjen islame, morale dhe të vlerave fetare qiellore. Prej këtyre mënyrave është aborti, ku nëpërmjet artikujve të ndryshme që i lexojmë:

“Aborti i sigurt”, “Lehtësimi i çështjes për shtatzënë”, “Shtatzënia e padëshiruar”, etj. Të gjitha këto nuk janë të pranueshme fetarisht, as sipas Islamit e as sipas feve të tjera qiellore.

Islami ia jep të drejtën e jetës embrionit që është në barkun e nënës, e nuk i lejohet askujt aborti, as prindërve, madje edhe nëse është zënë me rrugë të ndaluar (jashtë-martesorë). Pra, Islami e respekton njeriun që nga faza fillestare kur është embrion në barkun e nënës, madje cakton edhe dispozita për të, pasi që nuk i lejohet myslimanës shtatzënë të agjërojë muajin Ramazan, nëse agjërimi i saj e dëmton fëmijën që e ka në bark.

Perëndimi e dëshiron lirinë seksuale, kështu që ata e kanë zgjidhur litarin e epsheve, pastaj kur të mbetet femra shtatzënë, i japin të drejtën e shpëtimit prej tij nëpërmjet abortit, duke thënë: Ajo është e lirë në trupin e saj!

Ditë pas dite, bota islame po shtohet, ndërsa perëndimi po pakësohet. Kjo gjë është e natyrshme, nëse njerëzit frikësohen nga bartja e

përgjegjësi familjare. Perëndimorët dëshirojnë të jetojnë në kënaqësi e dëfrime, madje nuk dëshirojnë që fëmijët e tyre t'u bëhen konkurrentë në argëtimet e tyre, njëlloj si në kohën e xhahilijetit-injorancës.

Pejgamberi a.s. është pyetur: “Cili është mëkati më i madh? Është përgjigjur: T'i bësh shok Allahut, ndërsa ai të ka krijuar. I është thënë: Pastaj cili? Tha: Ta mbysësh fëmijën tënd, nga frika se do të hanë me ty” (transmeton Buhariu nga Ibën Mesudi r.a.), nga frika se do të bëhet konkurrent në kafshatën e bukës. Perëndimorët nuk dëshirojnë që fëmijët e tyre t'u konkurrojnë në jetën e tyre, por dëshirojnë të kënaqen me jetën e vet, prandaj nuk është çudi që pasardhësit dhe numri i tyre çdo ditë e më shumë po pakësohet.

Shpërndarja e pasurisë ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre të stagnuara

Perëndimorët dëshirojnë të bëjnë lidhshmëri ndërmjet natalitetit dhe varfërisë. Pse ata nuk e përmendin shpenzimin dhe shpërndarjen e keqe të pasurisë në botë? Kombet e Bashkuara thonë se 25 % e popullatës së botës jetojnë në mesin e vendeve të zhvilluara apo asaj perëndimore, ndërsa shumica e popullatës në botë jetojnë në mesin e vendeve të stagnuara. Megjithatë, 25 % e popullatës shpenzon 75 % të burimeve të botës, prej tyre: 80 % të drurëve, 70 % të mineraleve, 60 % të ushqimit, etj. Kaq shumë shpenzon perëndimi.

Në Amerikë, thuhet se vetëm për pijet alkoolike dhe narkotike, për çdo vit shpenzohen 25 bilionë dollarë, ndërsa me qindra miliarda të tjerë shpenzohen për armatim.

Përktheu: Dr. Faruk Ukallo, (Burimi: “Predikimet e Shejh El-Kardavit”, përgatitur nga Halid Essad, mektebetu vehbeh, Kajro, 1998, vëllimi 2, e shkurtuar nga faqet: 229-242).

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

Format më të njohura të ligjërimit në dave

O bjektivi i secilit thirrës për tek Allahu xh.sh., është komunikimi i mesazhit të Zotit dhe kuptimi i tij nga ana e masës dhe jo shpalosja e aftësisë së të folurit nga vetë ana e thirrësit nëpër ligjërimet e tij apo edhe shprehjet elokuede dhe rimimi i fjalëve, ofrimi i shembujve imagjativ qe nuk perceptohen e as nuk kuptohen, si dhe formulimi i shprehjeve dhe nocioneve qe nuk kapen nga të gjitha shtresat e masës (xhematit).

Andaj Allahu xh.sh., i ka dërguar peygamberët nga mesi i popullit qe të kuptojnë dhe t'u flasin në gjuhën e qartësuar dhe kjo mbetet arsyeja pse e bëri këtë. Ajeti në vazhdim na e argumenton këtë çështje: "Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu qe ai t'u shpjegojë atyre (në atë gjuhë). E Allahu e lë të humbur atë qe do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë qe do. Ai është i fuqishmi, i urti." (Ibrahim, 4).

Meqenëse njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri në të kuptuar e në përdorimin e shqisave dhe meqenëse ndodhin ngjarje nga më ta larmi-shmet dhe njeriu vihet në pozicione të ndryshme, është e domosdoshme qe thirrësi t'i japë larmi stilit të tij dhe ta ndryshojë ligjërimin, qe t'u përshtatet të gjitha situatave. Kështu ai nuk bëhet i mërziqshëm dhe informacioni shkon te të gjitha shtresat e njerëzve. Llojet e formave të komunikimit të mesazhit islamë janë të shumta dhe të larmishme si p.sh.: hytbeja, dersi, ligjëratë, debati, urdhri në të mirë e ndalimi nga e

keqja, thirrja individuale, këshilla, fetvaja, artikulli, mesazhi, libri etj.

Hytbeja (El-hutbe)

Hytbeja mbetet mjete i shkëlqyeshëm i daves në komunikimin e mesazhit apo sqarimin e një mendimi të caktuar. Ajo është një nga elementet e mëdha, të cilat e ngritin dhe forcojnë personalitetin e thirrësit në islam, e bëjnë pikë reference e respekti, pëlqimi e dashurie, e autoriteti e figura e tij rrezaton shpresë e besim te masa si ligjërues i sinqertë e këndshëm qe zotëron artin e të komunikuarit, elokuencë e "dridh" mimberrin me fjalimin e tij dhe qe zgjon masën dhe emocionet e tij duke përdorur argumente të forta si fetare, ashtu edhe shkencore dhe qe e bëjnë edhe më të besueshëm ligjërimin e tij në mimberr.¹

Hytbeja mbetet një mjet i mirë e praktik për transmetimin e mesazhit hyjnor, qe zakonisht mbahet kur njerëzit janë të tubuar e ndoshta edhe shumicën e tyre ligjëruesi nuk i njeh. Nga analizat qe dalin nga kjo fushë, qe një hytbe të jetë e suksesshme është qe te thirrësi të jenë konceptet e caktuara e të cilat dëshiron t'i prezantojë e sqarojë te të pranishmit. Ajo qe rekomandohet është qe gjatë këtij fjalimit (hytbes) të rrahret ndonjë tematikë qe ka të bëjë me gjendjen aktuale të njerëzve duke e bërë ndërlidhjen me konceptet e besimit islam.

Pra, nëse në një mes shihet se është i shtrirë ideja për fanatizëm fisnor, atëherë duhet ligjëruesi për dëmet dhe pasojat qe ka ky fenomen dhe se

Hytbeja mbetet një mjet i mirë e praktik për transmetimin e mesazhit hyjnor, qe zakonisht mbahet kur njerëzit janë të tubuar e ndoshta edhe shumicën e tyre ligjëruesi nuk i njeh.

çfarë është qëndrimi i fesë islame karshi këtij fenomeni. Në këtë rast, duhet shpjeguar faktin se besimtari nuk ofron ndihmë të afërmit të tij, pos kur ai ka të drejtë dhe se muslimani duhet të jetë i kënaqur me atë çfarë ka caktuar feja islame qe të kihet vëllazëri islame dhe qe të largohet elementi i fanatizmit fisnor. Po ashtu thirrësi, sipas mendimit të profesorit Abdulkerim Zejdanit,² gjatë mbajtjes së hytbes duhet të ketë parasysh edhe këto çështje:

1. Gjatë hytbes të sjellë argumente të bollshme nga ajetet uranore, hadithet e të Dërguarit a.s., (në origjinal), e më pas duke i shtjelluar ato, por të ofrojë edhe nga veprimet e historia e të dërguarve të tjerë, ashtu siç kanë vepruar sahabët e nderuar, gjë qe do të krijonte një ambient dhe do t'i jepte kuptim ajeteve dhe haditheve qe të lejë ndikim e dëshmi pas vetës.

2. Të sjellë tregime që janë cekur në Kuranin famëlartë (El-kisas) dhe sunet dhe kjo edhe më tej do ta shtonte vlerën e hytbes duke pasqyruar konceptet në formë narrativi dhe sjelljes së shembujve sikurse përmend edhe hadithi i Muhamedit a.s.: “Çfarë mendoni ju, sikur dikush prej jush të ketë para derës së shtëpisë një lumë dhe në të të lahet pesë herë në ditë, vallë a do të mbetet tek ai ndyrësi?” Të pranishmit i thanë: “Jo, o i dërguar i Allahut.” Ai më pas tha: “Kështu është namazi (i pastron mëkatet).”

3. Mos ta zgjasë fjalimin (hytben) shumë. Kjo vërtetohet me thënien e Muhamedit a.s.: “Vërtet zgjatja e namazit edhe shkurtimi i hytbes është një shenjë se ai është i kuptueshëm (që i kupton çështjet), prandaj zgjateni namazin dhe shkurtojeni hytben.”³ Prandaj duke komentuar këtë hadith, posaçërisht për hytben që mbahet gjatë ditës së xhumasë, por që në këtë bëhet analogji dhe hytbeja në raste të tjera, përveç kur e kërkon nevoja e jashtëzakonshme për t’u zgjatur ajo.

4. Të jetë atraktive dhe mos të kalon në mërzë. Kjo argumentohet më Ebu Vail Shefiki bin Selem, ka thënë: Ibën Mesudi na rikujtonte çështjet e fesë për çdo ditë të enjte. E atij njëri i kishte thënë: “O Ebu Abdurrahman, unë kam dëshirë që çdo ditë të na rikujtojë çështjet e fesë.” Ai është përgjigjur: “Ajo që më pengon ta bëjë këtë për çdo ditë është se urrej që t’ju mërzisë juve, unë zgjedh kohën e përshtatshme për t’u këshilluar, ashtu si ka vepruar i Dërguari a.s., i cili na këshillonte në kohë të përshtatshme nga frika se mos po mërzitemi.”⁴

5. Fjalimi të jetë sa më i qartë dhe më i thjeshtë, i përshtatshëm për masën e gjerë. Kjo buron nga fakti se ndjekësit e hytbes nuk janë të gjithë të një kategorie shkollimi, kulture apo formimi intelektual si dhe të kuptuarit e ligjërimit në hytbe. Andaj në këtë rast do të ndihmonte shumë që të përzgjidhen fjalitë sa më të shkurtra e përmbajtësore, në mënyrë që ligjëruesi të kuptohet drejt dhe mos të krijon assesi diktomi.

6. Thelbësore në hytbe mbetet që ligjëruesi t’ua rikujton të pranishmëve Krijuesin e tyre, t’ua tërheq vërejtjet për dukuritë negative e gjynahet që mund t’i bëjë ndonjëri. Këtë e argumentojmë me

Thirrësi në Islam duhet të zotërojë aftësi dhe të identifikojë problemet “sëmundjet” që e fillojnë të shtrihen në mesin e masës, qofshin ato shpirtërore apo materiale.

fjalën e Muhamedit a.s. ku në një rast u tha sahabëve, adhurojeni Allahun dhe braktiseni adhurimin ndaj kujtdo tjetër, pos Tij. Po ashtu, theks të veçantë i kushtonte gjithmonë faktit se muslimanët doemos duhet të jenë të devotshëm ndaj Allahut dhe të veprojnë për botën tjetër, Ahiretin. Këtu kemi shembullin e tregimit mbi Musaun a.s., se si ka përsëritur bazat e besimit dhe konceptet e tij.

7. Është mirë që ligjërimi (hytbeja) të filloj me diçka që u tërheq vëmendjen e njerëzve me ndonjë tregim që ka ngjarë apo ndodhi që e ka lexuar, ose ndonjë

ide që i ka lindur atij pasi që të arrijë të tërheq vëmendjen e dëgjuesve, atëherë ligjëruesi fillon dalëngadalë që të tërheq vërejtjen rreth ndonjë çështjeje që të motivojë për veprimin e ndonjë segmenti të caktuar të jetës sonë sociale, ekonomike, kulturore etj.

8. Thirrësi në Islam duhet të zotërojë aftësi dhe të identifikojë problemet “sëmundjet” që e fillojnë të shtrihen në mesin e masës, qofshin ato shpirtërore apo materiale. Të jetë shërues i zemrave dhe shpirtëve të tyre. Gjithmonë duke i drejtuar ata drejtë mësimëve të pastra islame, e duke i larguar nga çdo rrugë e dyshimtë që shpie apo ndiqet për ilaç ndaj gjendjes së tyre që për fat të keq sot në mjedisin tonë shqiptar janë shtuar me të madhe. Në këtë pikë, ai duhet t’ua rikujtojë atyre edhe metodologjinë e frikës dhe shpresës duke ua rikujtuar gjithmonë faktin se kjo botë është e shkurtër dhe mashtruese. Përgatitja më e mirë është përkushtimi i plotë ndaj Allahut xh.sh., dhe furnizimi më i mirë mbetet devotshmëria ndaj Krijuesit drejt rrugës së Tij. “Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, e ju të zotët e mendjes keni dronë Time.” (El-Bekare, 197). Kënaqësia e momentit që rrjedh nga mëkati është e shkurtër, por përfundimin e saj e ka të hidhur gjatë jetës në vijim. I mençur mbetet ai që duron dhe përmbahet nga kënaqësia e haramit, e cila nuk zgjatë shumë duke përzgjedhur kënaqësinë e hallallit, e cila zgjatë dhe e shpëton nga dënimi i xhehenemit. Ndërkaq kur ta vërej thirrësi (daiu) te të pranishmit se ata ndjehen pesimistë dhe kanë humbur shpresën tek Allahu, atëherë ai duhet t’ua përmend atyre madhësitinë e mëshirës së Krijuesit dhe se ai pranon pendimin e bërë me sinqeritet. Këtu kemi ajetin kuranor ku Allahu na ka rikujtuar neve: “Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez-Zumer, 53). Po ashtu këtu mund t’ua prezantojë atyre tregimin e vrasësit, i cili kishte vrarë njëqind persona dhe se një i ditur e kishte udhëzuar atë se si të pendohej te





Krijuesi dhe të kthehet te vendbanimi i njerëzve të mirë.

9. Thirrësi në islamë duhet të ofrojë sqarime të bollshme rreth ajeteve dhe haditheve në mënyrë që mos të krijojë keqkuptime në mesin e masës. Si p.sh. kemi fjalën e Muhamedit a.s.: “Kush thotë nuk ka Zot tjetër pos Allahut me zemër të sinqertë do të hyjë në xhenet.” Në këtë pikë thirrësi duhet ta shpjegojë hadithin derisa ta kuptojë dëgjuesi në mënyrë të saktë.

10. Të tregoj seriozitet dhe paraqitje të bukur para masës dhe mos të ndikohet nga emocionet që gjatë elaborimit të temës të ngrit zërin dhe të nxitoj në të shprehur, ashtu siç mund dhe po ngjanë me disa ligjërues që janë bërë viktime e të folurit të tyre. Këtu ligjëruesve mund t’u ndihmoj shumë literatura e librat që kanë të bëjnë me të folurin në publik që mund të ngrenë performancën e tyre dhe të jenë në nivelin e përgjegjësisë së plotë, e aq më shumë sot kur hytбет incizohen e ndoshta edhe transmetohet direkt nga masa në rrjete sociale. Andaj këtu duhet një seriozitet dhe paraqitje sa më e mirë e imamit (thirrësit) dhe të dijë saktë se media nuk të falë gabimin e bërë në publik.

11. Hytbeja duhet të ketë synim që të ofroj shembuj konkret dhe është e rëndësishme që të gjithë të kuptojnë domosdoshmërinë e unitetit dhe bashkimit të mendimit të aktivistëve në shërbim të Islamit dhe problemeve të tij edhe nëse ndryshojnë vizionet dhe mendimet e tyre për gjëra të pjesshme në disa çështje, sepse nëse ndryshojnë mendimet e tyre, nuk është e domosdoshme që të ndryshojnë edhe zemrat. Mu ashtu siç thotë dijetari i famshëm i

Islamit, prof. dr. shejh Jusuf Kardavi në librin e tij “Rizgjimi Islam, nga adoleshenca drejt pjekurisë”, ku sqaron se ne kemi synime të mëdha me të cilat synojmë që të zgjojmë ymetin mysliman dhe ta ngremë materialisht dhe shpirtërisht dhe ta vëmë në pozicionin e saktë mes popujve të tokës, si ymeti i të mesmes dhe me cilësinë e tij si (populli më i mirë që ka dalë për njerëzimin). Ne duam që ta ndryshojmë ymetin nga brenda tij për të rregulluar vetat tona, që Allahu i Madhërishtëm sipas ligjit të Tij ta ndryshojë gjendjen tonë. Ne kërkojmë që të rrisim një individ të devotshëm, një familje të devotshme, një shoqëri të devotshme, një komb të devotshëm, një shtet të devotshëm dhe të gjitha këto janë synime të mëdha për realizimin e të cilave duhet që të bashkojmë të gjitha përpjekjet, të mendojnë së bashku të gjitha mendjet dhe të bashkojmë të gjitha forcat. Një njeri i vetëm është pak, por bashkë me vëllain e tij bëhet shumë. Dora e Allahut të Madhërishtëm është me bashkësinë dhe myslimani për myslimanin është si një ndërtesë, tullat e së cilës shtrëngojnë njëra-tjetrën. Punët individuale me gjithë shpërblimin e madh që kanë, nuk munden që të vetme të mbajnë detyrat e mëdha. Prandaj, Islami na ka ftuar për të bashkëpunuar dhe na ka urdhëruar për të duke thënë: “..Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e assesi në mëkate e armiqësi...” (El-Maide, 2). Ne shikojmë se si armiq të Islamit punojnë të organizuar në grupe të mëdha, sepse kështu u mundësohet realizimi i qëllimeve të tyre rajonale dhe botërore me anë të bashkëpunimit, përkrahjes dhe sakrificës për njeri-tjetrin. Kështu ata

realizojnë atë që ne na e ka obliguar feja jonë. Edhe po të mos kishte qenë kjo e urdhëruar nga feja, ne duhej që ta përfitonim atë prej tyre dhe të mos mbetemi prapa. Nëse disave mund t’u lejohet që të ndryshojnë në mendime dhe të debatojnë në gjendje të zakonshme dhe në pozitat e fitimtarit, kjo kurrsesi nuk lejohet që të ndodhë në kohë të vështira të sprovave. Njerëzit e përcarë zakonisht në kohët e vështira bashkohen dhe të dëmtuarit bashkohen nga fatkeqësitë, siç ka thënë edhe një poet i vjetër: “Në kohë të vështira harrohen mëritë”. Në këtë kohë, ne po kalojmë sprovë të vështira dhe goditje të forta kudo në vendet tona dhe në gjithë ymetin në tërësi dhe sidomos pas ngjarjeve të shtatorit 2001, ku i gjithë ymeti nga Lindja e deri në Perëndim ka hyrë në një sprovë të vështirë dhe në një pozicion të rrezikshëm, që na e bën të detyrueshme për ymetin në mënyrë të përgjithshme dhe për dijetarët, ftuesit që t’i harrojnë debatet dhe betejat e tyre anësore dhe të qëndrojnë në një front të vetëm të bashkuar në betejën me të cilën përballlet Islami dhe ymeti.⁵ Sigurisht që bashkë me zgjedhjen e një teme, nevojitet të përcaktosh edhe qëllimin e përgjithshëm të fjalimit (hytbes). Zakonisht, ky i përket njërës prej dy kategorive, që përkojnë pjesërisht me njëra-tjetrën të informosh ose të bindësh.

Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm

Bashkë me zgjedhjen e një teme, nevojitet të përcaktosh edhe qëllimin e përgjithshëm të fjalimit. Zakonisht, ky i përket njërës prej dy kategorive, që përkojnë pjesërisht me njëra-tjetrën, të informosh ose të bindësh. Kur qëllimi yt i përgjithshëm është të informosh, atëherë sillesh si mësues ose si lektor. Qëllimi yt është përcjellja e informacionit, përcjellja e qartë, e saktë dhe interesante. Kur qëllimi i përgjithshëm është të bindësh, sillesh si mbrojtës (avocate) ose përkrahës (partisan). Ti kalon nga dhënia e informacionit në përkrahjen e një kauze. Dëshiron të ndryshosh ose të strukturosh qëndrimet apo veprimet e audienës. Dallimi midis informimit dhe bindjes është dallimi

midis shpjegimit dhe nxitjes. Nëse mundohesh t'i bindësh dëgjuesit se ata duhet të fillojnë një program të rregullt, natyrisht, nuk mund ta bësh këtë pa dhënë informacion, por qëllimi yt kryesor është të bësh që dëgjuesit të përqafojnë këndvështrimin tënd, pra të bësh që ata të besojnë diçka ose të bëjnë diçka si rrjedhojë e fjalimit tënd. Në fjalimet në klasë, qëllimi kryesor, zakonisht, specifikohet si pjesë e detyrës. Ndërsa për fjalime jashtë klasës, duhet ta gesh vetë qëllimin e përgjithshëm. Zakonisht, kjo është e lehtë për t'u bërë. Po shpjegon, po raporton apo po vërteton diçka? Atëherë qëllimi yt i përgjithshëm është të informosh. Po shet, po përkrah apo po mbron diçka? Atëherë qëllimi yt i përgjithshëm është të bindësh. Por pavarësisht situatës, duhet të jesh i sigurt për çfarë shpreson të arrish me anë të të folurit. Njohja e qëllimit të përgjithshëm është hapi i parë. Hapi i dytë është përcaktimi i qëllimit specifik.⁶ E cekëm më herët se ligjëruesi (hatibi) duhet të orientohet që një ide apo temë të caktuar, duhet ta elaborojë sa më mirë që mundet në mënyrë që hytbeja të kuptohet sa më drejtë nga të pranishmit. Por për të arritur këtë duhet t'u përmbahet disa elementeve:

Hyrja – Patjetër që hyrja duhet të jetë sa më tërheqëse dhe atraktive, ngase ajo përbën titullin që çdo gjë ndërtohet mbi të, duke përfshirë këtu shtrirjen e ideve të cilat arrijnë deri te zemra e dëgjuesit dhe ndjenjat e tyre si p.sh.: të hap me këtë tekst fetar kur Muhamedi a.s., e ka mbledhur popullin e tij në kodrën Safa dhe ka thënë: “Çfarë mendoni, po t’ju thosha se në luginë gjendet kalorësia e cila do t’ju sulmojë, a do të më kishit besuar?” Ata u përgjigjën: “Ne do të besonim, se ti kurrë nuk na ke gënjer.” “Atëherë”, - ai tha, - “dijeni se unë jam i dërguar te ju që t’ju tërheq vërejtjen për vuajtjet e rënda dhe ndëshkimin që ju pret.”, tha: “Unë jam qortues për ju...” (Buhariu dhe Muslimi). Apo hyrja mund të përmbajë edhe falënderim në adresë të xhematit për ndonjë

aksion të caktuar bamirës, e kjo do të tërhiqte dhe përvetësonte dashurinë dhe dëgjimin e hytbes. Gjithsesi se hyrja duhet të përmbajë këto gjëra: 1. Të jetë e shkurtër përmbajtjesore në mënyrë që dëgjuesi mos të shpërqendrohet me atë që nuk kërkohet; 2. Të përmbajë elemente atraktive; dhe 3. Të jetë ndihmëse e temës e jo të jetë larg saj.⁷

Po ashtu një element tepër me rëndësi për hatibin është fakti se ai duhet t'i shmanget meseleve dhe mendimeve divergjente të dijetarëve që ka nga ato që janë mendime jo kompakte dhe të çuditshme, sikurse duhet t'u shmanget disa tregimeve imagjinatave që janë të çuditshme apo edhe bien ndesh me konceptin e fesë. Po ashtu duhet ligjëruesi në nivel të tyre përndryshe do t'u bëjë njerëzve sprovë në fe. Një element tepër me rëndësi është edhe dukja e ligjëruesit (pamja e jashtme). Veshja e tij të ketë shije, të reflektoj seriozitetin e uniforma për këtë rast është veshja më e mirë dhe ndikimi e përvetësimi i masës do të jetë edhe më shumë. Po ashtu veshja nuk duhet të jetë në kundërshtim me shijen e ambientit social ku zhvillon thirrjen islame. P.sh. nuk i lejohet ligjëruesit të vishet me veshje të tinxherëve apo të vishet me rroba të cilat i urrejnë njerëzit. Prandaj, uniforma është reprezentative për ligjëruesin. Folësit e mirë janë të përqendruar tek audienca. Ata e dinë se qëllimi i bërjes së fjalimit është të fitohet reagimi i dëshiruar nga dëgjuesit. Kur punon me fjalimet e tua, ki parasysh tri pyetje: “Kujt po i flas? Çfarë dua që dëgjuesit të mësojnë, të besojnë apo të bëjnë si rezultat i fjalimit tim? Cila është mënyra më efektive e ndërtimit dhe e prezantimit të fjalimit tim, për të përmbushur atë qëllim?”

Fjalimet e tua në klasë do të jenë rast i shkëlqyer për t'u përballur me këto pyetje, në mënyrë që të mendosh për shokët e tu të klasës si një audiencë reale. Për të qenë folës efektiv, duhet të dish diçka rreth psikologjisë së audiencës. Perceptimi i auditorit është përzgjedhës. Edhe kur dëgjuesit kushtojnë vëmendje, ata nuk e marrin

mesazhin e folësit ashtu siç e synon folësi. Njerëzit dëgjojnë që të duan të dëgjojnë. Njerëzit janë edhe egocentrikë. Qasja e tyre ndaj një fjalimi është pyetja tipike: “Perse kjo është e rëndësishme për mua?” Ndaj duhet të studiosh audiencën dhe t'ua përshtatësh fjalimin tënd bindjeve dhe interesave të saj. Hapi i parë në njohjen e audiencës (xhematit) është ndërmarrja e një analize demografike. Kjo përfshin tipare të rëndësishme identifikuese të audiencës, si mosha, gjinia, feja, përkatësia grupore, racore, etnike apo kulturore. Hapi i dytë në njohjen e audiencës tënde është zhvillimi i një analize të situatës së audiencës. Këtu përfshihen tipare unike identifikuese në varësi të kontekstit, si madhësia e audiencës, mjedisi fizik dhe prirja e audiencës ndaj temës, ndaj folësit dhe ndaj qëllimit. Brenda mundësive, merrni mendimin e atij që ka mbajtur fjalime me të njëjtën audiencë më parë. Me të përfunduar analizën e audiencës, duhet t'ua përshtatësh fjalimin tënd asaj, në mënyrë të qartë e bindëse për dëgjuesit. Mbajti ata vazhdimisht në mendje, kur përgatit fjalimin (hytben). Vendose veten në vendin e tyre. Përpiku ta dëgjosh fjalimin siç do ta dëgjonin ata. Parashiko çështje dhe kundërshtime dhe përpiku t'u përgjigjesh përpara. Kur mban fjalim, kushtoji vëmendje reagimit të audiencës. Nëse vëren pakënaqësi apo mëdyshje në fytyrat e dëgjuesve tu, mund të të duhet një rishikim. Ashtu si aspekte të tjera të përshtatjes me audiencën, kjo mund të jetë e vështirë në fillim, por, nëse përpiqesh, shpejt do të shohësh rezultatet.⁸ Në fund të hytbes duhet të bëjë një përmbledhje të asaj që ka shtjelluar përgjatë hytbes në pika të shkurtra.

1. Abdullah Nasih Ulvan, *Medresetu-d-duati-fusulun hadife fi fikhi-d-aveti ve-d-aveti*, v.1, *Daru-s-elam*, bot.1, Kajro, 2001, f. 447. 2. Abdulkerim Zejdani, *Uslu-d-ave*, *Muesesetu errisale*, botimim i LX-të, Bejrut, 1999, f. 575. 3. *Rijadu-s-alihin*, f. 297. 4. *Rijadu-s-alihin*, f. 297. 5. Jusuf Kardavi, *Rizgimi Islam nga adoleshenca drejt pjekurisë*, Furkan, 2007, Shkup, f.341. 6. Stephen E. Lucas, *Arti i të folurit publik*, Uetpress, Tiranë, 2010, f.121. 7. Teyfik el Vaitë, *Eddavetu ilall-llah, Darul jekin*, botim i dytë, Mensure, 1995, f.278. 8. Stephen E. Lucas, *Arti i të folurit publik*, Uetpress, Tiranë, 2010, f.165.

Mr. Nashit Ferati

Islami, myslimanët dhe sfidat e kohës në mijëvjeçarin e fundit

Është interesante të krahasosh botën perëndimore, e cila vazhdimisht po trazohet nga gjallëria shkencore dhe teknologjike, me botën islame, e cila pa ndryshuar fare mbetet e ngrirë në kujtimet e kohëve të lulëzimit, duke u kapur pas traditave të vjetra të cilat e kombinuan kulturën lokale me referencat kuranore.

Islami është fe e cila nuk i lejon metodat detyruese në shpjegimin, përhapjen dhe kumtimin e fesë. Islami nuk lejon detyrimin në fe dhe mundësia duhet t'iu lihet në dispozicion jomyslimanëve që ta studiojnë Islamin dhe ta ndjekin drejtimin e tij.¹

Në Kuran thuhet: “Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota...”² Gjithashtu në Kuranin fisnik ekzistojnë edhe disa ajete të tjera në këtë drejtim. Besimtarët nuk duhet të përdorin kurrë dhunën dhe as ndonjë lloj presioni fizik apo psikologjik. Atyre po ashtu nuk u lejohet të përdorin epërsinë e mundshme materiale për ta detyruar dikë në çështje të fesë. Ashtu siç Islami thërret në butësi, ua tërheq vërejtjen njerëzve për t'u ruajtur prej dhunës në thirrje dhe sjellje, po ashtu, ai thërret edhe në mëshirë, duke e konsideruar atë thelb të moralit, ndalon nga vrazhdësia, e përbuzë atë dhe i përbuzë ata që janë të këtillë në formën më të ashpër.

Islami është alternativë për të gjithë njerëzit që dëshirojnë të studiojnë dhe të dinë për të vërtetën. Islami për shpjegimin e vetvetes zgjedh një rrugë paqësore, zgjedh metodat e bindjes e jo ato të detyrimit. Për më tepër, Allahu i drejtohet Profetit, duke i tërhequr vërejtjen që të ketë kujdes, duke i kujtuar se ai nuk është dërguar për të bërë presion mbi njerëzit: “E ti pra, këshillo, se je

Tani për tani nuk ka dyshim se cilët janë fituesit më të mëdhenj në lojën e globalizmit - të pasurit dhe të fuqishmit.

vetëm rikujtues. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues.”³

Një arsye tjetër e cila i mbajti larg myslimanët nga përdorimi i forcës kur ua komunikonin njerëzve fenë e tyre, ishte “konsiderata për njerëzimin” e prezantuar në Kuran.

Me fillimin e mijëvjeçarit të ri kumnguan simptomat e krizës të cilat

stimuloheshin nëpër media e që mund shkaktonin përhapjen e histerisë për shkak të fundit, për shkak të frikës para mijëvjeçarit të ri.

Një sistem i ri global duket në horizont, por është një sistem, karakteristikat e të cilit kanë akoma nevojë t'i zhvillojnë definicionet, ngase kuptueshmëria, pasiguria dhe paparashikueshmëria janë shqetësimet sunduese të sotme. Ne gjendemi në një botë me sfida të jashtëzakonshme dhe të gjithë jemi të prekur nga kërcënimet e reja të sigurisë dhe kërcënimet e vjetra, që po evoluojnë në një mënyrë komplekse dhe të paparashikueshme. Shtyllat e grupeve globale dallohen me kërcënimet ekonomike dhe sociale, përfshirë varfërinë dhe sëmundjet infektive vdekjeprurëse; konflikte



Qëllimi dhe kërkesa e disave është zhveshja jonë jo vetëm nga “arma e luftës”, por edhe nga autonomia ekonomike apo dëshirat politike.



ndërshtetërore dhe rivalitetet; dhunën e brendshme, përfshirë luftërat civile, rënien e shteteve dhe gjenocidin, armët nukleare radioaktive, kimike dhe biologjike, terrorizmin, krimin e organizuar ndërkombëtar.

Tani për tani nuk ka dyshim se cilët janë fituesit më të mëdhenj në lojën e globalizmit - të pasurit dhe të fuqishmit (pra, ata të cilët tanimë sot janë konkurrentë), gjithashtu, nuk ekziston kurrfarë dyshimi për atë se kush janë humbësit më të mëdhenj - ata që janë shumë të varfër dhe të dobët (ata të cilët nuk posedojnë

kurrfarë gjasash që në këto kohë të garojnë me më të mirët, me më të mençurit, me më të fuqishmit dhe me ata të cilët janë më të pasur.)⁴

Bota vazhdimisht është në lëvizje, njeriu duket se po fiton gjithnjë e më shumë autonomi, ngase edhe i ekspozohet një lirie më të madhe. Zhvillimi shkencor dhe zbulimet teknologjike, i kanë bërë racionalizimin dhe prodhimtarinë dy simbole të kohës sonë, saqë njeriu shpesh e ngatërron faktin e modernitetit me atë që duket të jetë, shtrembërisht, ideologji e modernizmit (ne do t'i kthehemi këtij ngatërrimi në të kuptuar i cili nuk është as i parrezikshëm e as i lirë). Mbetet që ideja e modernizmit sot ka një ndër domethëniet më pozitive. T'i dalësh zot asaj, do të thotë të pranosh parimet e modernitetit, racionalitetin, ndryshimin dhe lirinë.⁵

Është interesante të krahasosh botën perëndimore, e cila vazhdimisht po trazohet nga gjallëria shkencore dhe teknologjike, me botën islame, e cila pa ndryshuar fare mbetet e ngrirë në kujtimet e kohëve të lulëzimit, duke u kapur pas traditave të vjetra të cilat e kombinuan kulturën lokale me referencat kuranore.

Mbase njeriu mund të pyesë nëse refuzimi i zhvillimit ose modernitetit është pjesë e pandashme e Islamit. I këtillë është kontrasti, siç kanë pohuar disa, se është e detyrueshme ta “modernizosh Islamit” nëse do të ketë ndonjë mundësi të shikosh myslimanët se si jetojnë në harmoni me kohën e tyre dhe në mënyrë që më në fund ata të mund të adaptohen.

Në këtë hyrje, ne do të përqijemi të përkufizojmë se çfarë në të vërtetë mbulon koncepti modernitetit. Me anë të historisë perëndimore, ky nocion ka marrë shijen e origjinës së tij dhe pikërisht kjo veçanti është ajo që ne duhet ta mbajmë në mend. Në pjesën e parë, ne do t'i shkoqisim bazat e fesë islame. “Në brigjet e transcendencës” ne do të mundohemi të sqarojmë elementet bazë të universit islam të referencës (në kuptim të religio, të lidhjes midis Zotit dhe njeriut). Vetëm pastaj do të mund të trajtojmë çështjet sociale, politike dhe ekonomike. Pjesa e dytë, “Horizontet e Islamit”, tenton të ekspozojë prirjet e ofruara nga burimet islame lidhur me mena-

xhimin e faktit kolektiv. Këtu ne do të mësojmë se ekziston një hapësirë e rëndësishme manovrimi e cila na mundëson të bëjmë reformat që na takojnë dhe të cilat do të na mundësojnë të ndeshemi me sfidat bashkëkohore. Pjesa e fundit, “Vlerat dhe finalitetet” kap çështjen e takimit, nëse jo edhe të ballafaqimit ose të konfliktit midis qytetërimit perëndimor dhe islam. Megjithatë, fundi i këtij shekulli është i nderë, përplasja ose “luftëra të reja” po na shpallen vazhdimisht.

Qëllimi dhe kërkesa e disave është zhveshja jonë jo vetëm nga “arma e luftës”, por edhe nga autonomia ekonomike apo dëshirat politike. Porse pas të gjitha këtyre qëndron konflikti i civilizimit historik që synon zhveshjen tonë nga Islami si identitet i dalluar i ymetit tonë dhe gjembat të cilat ymeti i ka përdorur për t'u mbrojtur shekuj me radhë.

Kështu, mendimtarët dhe politikanët duan t'i thyjnë këto gjemba të Islamit përmes shekullarizmit që futi konflikte të shumta, të gjata dhe të dhimbshme, e siç thonë ata, të bëjnë me të atë që bënë me krishterimin e vet, të cilin e shndërruan prej një feje në trashëgiminë e thjeshtë.

1. Qemajl Morina, *Paqja globale, Edukata Islame, Prishtinë, 2010*, f. 6. 2. Kuran, 2: 256 3. Kuran, 88: 21-22 4. Mr. Nashit Ferati, *Paqja dhe Islami, me theks të veçantë Ballkani Perëndimor*, f.27, Tetovë, 2016 5. Dr. Tariq Ramadan, <http://www.el-hikmeh.net/>

Harun Shabanaj

Pagëzim a vdekje (1)

Konvertimi me dhunë i shqiptarëve në ortodoks dhe qëndresa e popullsisë shqiptare në Deçan dhe rrethinë

Fillimi i shek. XX, do të shënonte fazën përfundimtare të jetës së Perandorisë Osmane, perandori kjo e cila kishte sunduar për shekuj me radhë shumë territore në tri (3) kontinente.

Luftërat e shumta të jashtme dhe ato të brendshme që humbi sulltanati i Sulltan Abdyl Hamitit,¹ do të krijonin në fazë të re në Perandorinë Osmane, fazë kjo që karakterizohet me humbjen ngadalë të pushtetit të Portës së Lartë.

Më 27 prill të vitit 1909, Sulltan Abdyl Hamiti, largohet nga froni i drejtimit të Perandorisë Osmane, sipas marrëveshjes që ai kishte paraprakisht me xhonturqit, të cilët kishin triumfuar në Revolucionin e vitit 1908.

Vendet ballkanike të cilat ndiqnin një politikë antishqiptare dhe pretendonin që të zgjeronin territoret e tyre në dëm të tokave shqiptare, duke e parë se Perandoria Osmane po numëronte ditët e fundit të jetës së saj, filluan që të zgjonin synimet e tyre kundrejt tokave shqiptare. Shtetet ballkanike si Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, filluan të hartonin plane për pushtimin e tokave shqiptare. Në këto rrethana të një situatë të ndërlikuar ndërkom-bëtare, shtetet ballkanike të lartpërmendura shpallën aleancën e tyre kundrejt Perandorisë Osmane, e njohur në historiografi si Aleanca Ballkanike.

Aleanca Ballkanike, e cila përbëhej nga Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, duhet parë se ishte edhe një aleancë krishtere -



Sulltan Abdyl Hamiti (21 shtator 10-1842 shkurt 1918)

Në krye të luftëtarëve, shqiptarë do të vendoseshin trimat e patriotëtë shquar si Isa Boletini, Elez Isufi, Idriz Seferi, Hasan Prishtina, e shumë e shumë komandantë e luftëtarë të tjerë të shquar.

ortodokse, kundër Perandorisë Osmane, e cila mori edhe bekimin e Perandorisë Ruse.

Duke e kuptuar si të vështirë situatën e krijuar në Ballkan, nga njëra anë dobësimi i Perandorisë Osmane dhe në anën tjetër themelimi i Aleancës Ballkanike, krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, filluan që të bashkojnë popullin në luftë për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Në këto rrethana, në tetor të vitit 1912, do të shpërthente Lufta e Parë Ballkanike, e cila do të përfshinte në luftë shtetet e Aleancës Ballkanikeme forcat e Portës së Lartë. Në këto rrethana, shqiptarët, duke mos e ditur po përkrahnin Portën e Lartë, filluan luftën kundër forcave të Aleancës Ballkanike në njëren anë dhe forcave të ushtrisë osmane, në anën tjetër.²

Në krye të luftëtarëve, shqiptarë do të vendoseshin trimat e patriotëtë shquar si Isa Boletini, Elez Isufi, Idriz Seferi, Hasan Prishtina, e shumë e shumë komandantë e luftëtarë të tjerë të shquar.

Në një situatë të rëndë, kur i gjithë rajoni i Ballkanit ishte në luftë, delegatët nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, të mbledhur në qytetin e Vlorës nën drejtimin e patriotit të shquar Ismail Qemali, më 28 nëntor të vitit 1912, do të deklarënin mëvetësinë e tokave shqiptare.

Studiuesit e historisë, dr. Zekeria Cana, dr. Isa Bicaj dhe Mikel Ndreca, ndajnë pothuajse mendime të njëjta për sa i takon Luftërave Ballkanike dhe pjesëmarrjes së shqiptarëve në

këto lufta, duke vënë në pah bashkëpunimin e shqiptarëve me ushtritë serbo-malazeze, vetëm e vetëm që të dobësohej Perandoria Osmane.³

Mendojmë se bashkëpunimi i shqiptarëve me ushtritë serbo-malazeze kundër Perandorisë Osmane ishte tepër gabim i madh, pasi shqiptarëve i është dashur të mbajnë një qëndrim asnjës në Luftërat Ballkanike dhe vetëm të mbronin tokat e tyre. Pra, bashkëpunimi me ushtritë serbo-malazeze nuk solli asgjë më shumë se sa vrasje, masakra e dëbime të shqiptarëve nga trojet e tyre.

Me fillimin e depërtimeve të ushtrive të Aleancës Ballkanike në trojet shqiptare, ushtritë serbo-malazeze pushtuan pjesë të konsiderueshme të territorit të Kosovës, e madje depërtuan deri në Shqipërinë e Veriut dhe atë të Mesme.

Në pjesën më të madhe të territorit të Kosovës, forcat serbo-malazeze u vendosën në afërsi të monumenteve fetare ortodokse.

Në kuadër të studimit tonë, ne do të ndalemi te depërtimi i forcave serbo-malazeze dhe vendosja e tyre

në Deçan dhe rrethinë dhe më pas në gjenocidin që kryen në këto anë.

Dhuna dhe terrori serbo-malazez, që do të ndërmerrej ndaj shqiptarëve, natyrshëm që do ta gjente frymëzimin edhe te letërsia serbe, e cila ishte e mbushur me plot mllef kundër shqiptarëve. Kështu, në poemën e Njegoshit, bëhej thirrje për luftë, jo vetëm kundër individëve, por edhe kundër myslimanëve. Kështu, Petar Njegoshi, ndër të tjera, do të shkruante:

*...E kot e ke s'ke pse me u mashtruar
pse po t'kishin mujtë me t'shti në
dorë. Mejherë ty kokën ta kishin pre
O t'kishin lidhur duart për s'gjalli
Me tmundue aq sa me shfrye zemrat,
Sorra sorrës synin nuk ia nxjerrë,
Gjithkund Turku me Turkun asht
vlla; Prandaj mshoi gjithsa t'kesh fuqi
E mos anko ti kurgja n'ket botë
Gjithçka rrugën e dreqit ka marrë, Po
qelbet toka me Muhametin".⁴*

Nga vargjet e sipërcituara kuptojmë se njeriu nuk urren të tjerët përshkak të një instikti të lindur. Ai e mëson këtë. Është pikërisht kjo shkollë e urrejtjes, e cila na tërheq vëmendjen dhe po e shohim të nevojshme që të bëjmë të njohur tekstin e sipërcituar.

Poezia serbe, është njëra anë e shprehjes së atyre ndjenjave që ka

dominuar ndërgjegjen kombëtare të tyre. Mjerisht këto poezi dhe shumë të tjera, shërbejnë edhe sot për të ndezur urrejtjen e serbëve ortodoksë kundër shqiptarëve myslimanë.

Konvertimi me dhunë

Me të hyrë në Rrafshin e Dukagjinit, ushtritë malazeze filluan çarmatimin e shqiptarëve.

Fushata e mbledhjes së armëve në Deçan dhe rrethinë ishte tepër e egër. Kështu, filloi edhe braktisja e shtëpive nga ana e meshkujve, duke u larguar në vende të sigurta.

Brutaliteti që përdori ushtria malazeze me rastin e konvertimit me dhunë në ortodoksë të shqiptarëve, ishte tepër e rëndë. Fillimisht, xhandarët rrethonin fshatra të caktuar, duke përdorur edhe artilerinë e rëndë, deri edhe topat. Më pas fillonte bastisja e shtëpive, objekteve të tjera përcjellëse dhe e xhamive.

Pas bastisjeve, ushtritë malazeze arrestonin njerëzit, duke i rrahur në format më brutale. Pastaj hidheshin në ujë të ftohtë dhe më pas i dërgonin buzë zjarrit dhe prushit në tempe-ratura të larta. Torturë




**"Edhe nëse na
detyrojnë me e ba
kryqin, bane me
dorë, por me
zemër e me
gjuhë thoni
shehadetin."**

(Mulla Zeqë Hulaj)

tjetër ishte rrahja në organet e ndjeshme gjenitale dhe në pjesët e tjera të trupit. Po ashtu në disa raste njerëzit goditeshin me çekan në boshtin e kurrizit.

Një torturë tjetër ishte ajo e vendosjes së saçit të metaltë të nxehtë në kokat e atyre shqiptarëve që refuzonin vendosjen në kokë të kapelës malazeze me kryq. Burrat i thernin me thika e bajoneta, ndërsa grave iu hiqnin perçen dhe shamitë e mbulesës fetare islame. Në shumë raste gratë dhunoheshin e përdhunoheshin në format më barbare.

Konvertimi me dhunë që iu bë shqiptarëve nga ana e ushtrive malazeze ka shtuar interesimin e shumë studiuesve. Historiani i shquar, dr. Zekeria Cana, në librin e tij: "Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar, 1912-1913", dokumente, e ka shtjelluar shumë gjerësisht procesin e konvertimit me dhunë të shqiptarëve në ortodoks. Kështu, ai ndër të tjera përshkruan: "Pasi mblihdeshin lutjet e "vullnetshme" për ndërrimin e fesë, kryhej akti i pagëzimit në praninë e myftisë dhe të përfaqësuesve të pushtetit, pa lënë anash prezencën e domosdoshme të kumbarisë "së zgjedhur" që në fakt kishte rolin e garantuesit se besimtari i ri do të mbetej ortodoks i devotshëm. Pastaj vinte momenti i spërkatjes me ujën e bekuar, gjunjë-



Ismajl (Mehmet) Mazrekaj nga Drenoci i Deçanit, i cili ishte i mbijetuar ikohës së ndërrimit të fesë me dhunë në ortodoks, fushatë kjo e ndërmarrë nga pushteti serbo-malazez

zimi para popit, puthja e dorës dhe e kryqit, kryhej akti i kungimit. Alia bëhej Ilia, Rukija-Rushica. Tashti e kishte radhën solemniteti kolektiv."⁵

Ashtu siç e ka përshkruar dr. Cana, një akt të tillë të konvertimit e kishte parë me sytë e tij dhe e kishte përjetuar edhe Ismajl (Mehmet) Mazrekaj⁶ nga Drenoci i Deçanit.

Ismajl (Mehmet) Mazrekaj nga Drenoci i Deçanit, të cilin kam pasur fatin që ta takoj dhe të marr shënime nga ai, ndër të tjera për konvertimin me dhunë, deklaroi se: "Në fillim na kan urdhnu që krejt katuni me u tubu në oborr të xhamisë. Na kan rrathue ushtria, para neve kan dal dy komandanta, ata kanë urdhnu që na me shku në Kishë të Deçanit me ndrrue fenë. Populli ka nisë me kundërshtu, kan marr tre burra dhe i kan pushkatue, dy të tjerë i kan mbytë para neve tu i rreh në dajak. Neve na kan nisë për në Carrabreg, na kan ndal të kulla e Lush Metve në Carrabreg. Aty na ka pri popi me ushtri. U kan pru dy kazan i kan mush ujë në jazë e kan shti kryqi në ta dhe ja ka nisë me na kryqëzuar dhe na stërpikte me ujë. Imami i xhamisë, Mulla Zeqë Hulaj, na thoshte se edhe nëse na detyrojnë me e ba kryqin, bane me dorë, por

me zemër e me gjuhë thoni shehadetin."⁷

Gjatë intervistimit që i kemi bërë Ismajlit, vumë re se ai kishte një kujtesë shumë të mirë. Në vazhdim të dëshmisë së tij, tregonte se si qanin dhe klithnin fëmijët, më pas vajin e nënave dhe brengën e çdo njeriu, që duhej të mësynte kishën për konvertim.

Në fund të dëshmisë së tij, ai përshkroi gjendjen e mjerueshme të popullit të pambrojtur dhe më pas recitoi vargje, të cilat brez pas brezi ishin kënduar në odat e burrave të Rrafshit të Dukagjinit:

...Baba mret more bregtar,

A je dek e je gjallë,

Tana ylqet tu kanë marrë,

Kraj! Nikolla a dalë i parë,

Nuk po len avdes me marr,

I kanë thanë shkaut mos t'kofsha falë,

Shahadetin s'un ma nal.

1. Sulltan Abdul Hamiti lindi më 21 shtator të vitit 1842 dhe vdiq më 10 shkurt 1918. Ishte sulltani i tridhjetë e katër (34) i Perandorisë Osmane. Ai drejtoi Portën e Lartë nga 31 gushti i vitit 1876 e deri më 27 prill 1909, kur edhe u largua nga froni perandorak pas marrëveshjes që kishte me xhonturqit. Gjatë kohës së sundimit të Sulltan Abdyl Hamiti, Perandoria Osmane shënoingritje të madhe, ai arriti që të modernizojë Perandorinë Osmane, duke zgjeruar hekurudhën e Rumelisë, hekurudhën e Anadolit, si dhe ndërtimin e hekurudhës për në Bagdad dhe atë të Hixhazit, pra për në Mekë dhe Medinë, dy qytete këto të shenjta të myslimanëve. Sulltan Abdyl Hamiti, më 23 dhjetor të vitit 1876, dekretoi miratimin e Kushtetutës së parë të Perandorisë Osmane. Kjo kushtetutë hyri në fuqi në marrëveshje me xhonturqit. Gjatë kohës së sundimit të tij, arriti që të reformohej sistemi arsimor në vend, duke u dhënë përparësi shkollave profesionale. Kështu u jetësuan shkollat profesionale për drejtësi, arte, tregti, inxhinieri civile, veterinarë, doganorë, bujqësisë dhe gjuhësisë. Në vitin 1900, ai e rihapi Universitetin e Stambollit. 2. Me gjerësisht për Luftën e Parë Ballkanike dhe shqiptarët, shih: dr. Ibrahim Gashi, Pavarësia e Shqipërisë dhe pasojat e luftës së parë ballkanike 1912-1913, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2012. 3. Shih më gjerësisht: dr. Zekeria Cana, Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908- 1912, Prishtinë: Rilindja, f.209; dr. Isa Bicaj, Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze 1881-1914, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2003, f.87; Mikel Ndreca, 97 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë 1912-1999, f.9. 4. Petar Petrović Njegosh, Kurora e Maleve, Prishtinë: Rilindja, 1973, f.60. 5. Dr. Zekeria Cana, Gjenocidi..., f.33. 6. Ishte haxhi i Qabesë dhe është i njohur në popull si Haxhi Ismail (Mehmet) Mazrekaj. 7. Deklaratë e Ismajl (Mehmet) Mazrekajt (1900-2002) nga Drenoci dhënë autorit, më 9 nëntor 2001.

Bajram Zeqiri

Trëndafili qiellor - hoxhë Hasan Tahsini


“Ne jemi një komb i veçantë, kemi gjuhën tonë të veçantë, andaj duhet të jetojmë më vete, si edhe të tjerët.”

Biografi e shkurtër

Në historinë e kulturës shqiptare të Rilindjes Kombëtare, Hasan Tahsini, ka hyrë si një nga figurat më të shquara të shekullit XIX. Hoxhë Hasan Tahsin efendiu, ky trëndafili qiellor, siç e quante Naim Frashëri,¹ lindi në vitin 1812.

Babai i tij ishte Osman Efendiu, një dijetar i shquar, kadi, myderriz i shquar nga katundi Ninat i Sarandës. Dëshira e Osmanit ishte që Hasani të vazhdonte mësimet fetare dhe të bëhej hoxhë, kështu që menjëherë pas kthimit të tij nga Shkodra, ai e drejtoi Hasan Tahsinin në Filat, ku do të ndiqte mësimet. Më pas, Hasan Tahsini filloi studimet në qytetin e Janinës, të cilat i përfundoi dhe filloi punën si hoxhë. Ambiciei e tij për dijen e shtynë që të shkonte në Stamboll.² Personaliteti dhe atdhetarizmi i Hasan Tahsinin u çmua nga bashkëkohësit dhe pasardhësit. Ai merrej me përkthime, shkrime poetike, letrare, iluministe, pra nuk ishte vetëm hoxhë, por ishte një psikolog, një sociolog dhe një pedagog i dalluar.

Studimet e tij fillimisht i botonte në revistën shkencore “Mexhmual-i-Ulum”, themelues i së cilës ishte vetë ai. Ai botoi mbi 20 libra shkencorë, astronomik, psikologjik.³ Në shtator të vitit 1869, Hasan Tahsini u emërua rektor i parë i Universitetit të Stambollit. Ai që në fillim u përpoq dhe në sajë të një pune të shumanshme e vendosi Universitetin mbi



themele shkencore. Puna e tij e madhe organizative, ligjëratat shkencore që mbajti, veprat që shkroi, bashkëpunëtorët që afroi në Universitet, programet bazë që hartoi për këtë tempull të dijes si dhe plani i temave që do të mbaheshin gjatë pushimeve në konferenca diturie për të dhënë njohuritë e reja shkencore perëndimore janë dëshmia më e qartë e nivelit të tij. Ai gjithnjë shpërndau dhe ua mësoi shqiptarëve alfabetin e tij. Si një atdhetar i flaktë që ishte, ai kërkonte që të jepte kontributin e tij për çështjen shqiptare. Ishte pjesëmarrës edhe në Lidhjen Historike të Prizrenit, ku thotë se një nga mjetet dhe armët më me rëndësi për arritjen e çlirimit, arsimimit, edukimit, kulturimit të vendit ishte gjuha shqipe.⁴ Hoxhë Tahsini vdiq më 4 korrik 1881 dhe u varros në varrezat e lagjes Eren Qoj në Yskudar.

Pak fjalë për Kongresin e Manastirit

Çështja e shkrimit të një gjuhe konsiderohet si njëra ndër çështjet më të rëndësishme për atë gjuhë. Dihet mirëfilli se për krijimin e një alfabeti, të cilin ne sot e kemi, ka pasur tentativa dhe propozime të ndryshme, deri në mbajtjen e një kongresi në të cilin edhe u vendos për përpilimin e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Rilindësit tanë duke qenë të vetëdijshëm dhe largpamës për vlerën dhe rëndësinë e një alfabeti të përbashkët, filluan krijimin e alfabeve të ndryshme, të cilat më vonë do t'i paraqisnin në Kongresin e Manastirit. Kongresi i Manastirit ka zënë një vend të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar, si një nga ngjarjet që shprehin moment të rëndësishëm të zhvillimit të shqipes së sotme. Kjo ngase me të fillon edhe standardizimi i gjuhës shqipe. Ky Kongres ka një rol tejet të rëndësishëm për faktin se alfabeti i përbashkët për të gjithë shqiptarët ishte parakusht i domosdoshëm për t'u standardizuar gjuha shqipe. Vendimet e Kongresit ripohojnë edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për individualitetin e tyre kombëtar dhe ato shënohen si një fitore e lëvizjes kombëtare shqiptare. Edhe pse thuajse të gjithë rilindësit tanë kishin propozimet e tyre për një alfabet të përbashkët, prapë se prapë në këtë Kongres

morën pjesë tri shoqëri, ajo e Stambollit, “Bashkimi” dhe “Agimi”. Krahas këtyre shoqërive, alfabet për shqiptarët kishte krijuar edhe atdhetari i flaktë, mendimtari e dijetari i vërtetë, hoxhë Hasan Tahsini.

Për shkrimin e shqipes

Hoxhë Hasan Tahsini hyri në historinë e shkrimit të shqipes, në veçanti të zgjidhjes së problemit të alfabetit të përbashkët të shqipes në dy drejtime, së pari si pjesëmarrës në mbledhjet e ndryshme që u bënë gjatë viteve 1876-1879 në Stamboll për këtë çështje dhe së dyti, si hartues i një alfabeti të veçantë.⁵

Emri i Hasan Tahsinit për këtë problem, për herë të parë na paraqitet kur ai ishte në moshën 56-vjeçare, por me këtë çështje ai duket se është marrë edhe më parë. Hoxhë Tahsini motivonte përdorimin e alfabetit shqip, ngase donte që të kishte një alfabet të ndryshëm nga ai i gjuhëve të tjera, gjithnjë me arsyen e tregimit të individualiteti të popullit të tij. Ai thoshte “Ne jemi një komb i veçantë, kemi gjuhën tonë të veçantë, andaj duhet të jetojmë më vete, si edhe të tjerët.”⁶

Hoxhë Tahsini kundërshtonte dhe nuk pajtohej as me përdorimin e alfabetit grek dhe latin për t’ia përshtatur gjuhës sonë. Ai për këtë problem donte të vazhdonte traditën e nisur që në shekullin XVIII e më vonë nga Naum Veqilharxhi për ta shkruar gjuhën shqipe me alfabet të veçantë. Për të, alfabeti origjinal kishte më shumë përparësi për arsye se mund të krijoheshin shkronja më të mira dhe më të lehta, e kështu edhe shqipja do të mësohej më lehtë.

Në kujtimet e tij, me titull “Mendime për shkrimin e shqipes”, rilindësi dhe bashkohani i Hasan Tahsinit, Jani Vreto, shkruan se lidhur me ata që mendonin se për shkrimin e gjuhës shqipe ishte me interes të merrej si shembull alfabeti

**Hoxhë Tahsini
motivonte
përdorimin e
alfabetit shqip,
ngase donte që të
kishte një alfabet
të ndryshëm nga
ai i gjuhëve të
tjera, gjithnjë me
arsyen e tregimit
të personalitetit të
popullit të tij.**

arab, ky i fundit iu kundërvu atyre me argumentet e mëposhtme: “Çështja për të cilën diskutojmë ka të bëjë me interesin shpirtëror të të gjithë kombit tonë, domethënë me çështjen se si të shkruhet më lehtë gjuha jonë dhe të përparojë dituria e të çlirohet kombi ynë nga turpi i gjendjes barbare dhe nga të këqijat që rrjedhin prej saj. Gjuha jonë nuk mund të shkruhet me anë të alfabetit arab. Prova e madhe bindëse është fakti se ata, midis shqiptarëve që kanë mësuar gjuhën arabe, kur u shkruajnë fëmijëve të tyre, përdorin greqishten e re, të cilën nuk e dinë mirë, e që e kanë mësuar, vetëm duke u shoqëruar me grekë. Ngandonjëherë kur nuk e dinë greqishten, shkruajnë në gjuhën shqipe, por me shkronjat e alfabetit grek, të cilat i mësojnë me rast nga ata që e dinë greqishten, ndonëse shkronjat e greqishtes nuk mjaftojnë për të paraqitur të gjithë tingujt e gjuhës sonë.”⁷

Megjithatë, Hasan Tahsini nuk hoqi dorë nga mendimi i tij derisa u miratua alfabeti i Stambollit. Ai ishte i parimit se në shkrimin e gjuhës shqipe duhej të përputhej parimi fonetik me atë morfologjik, parim i cili gjeti zbatim edhe më vonë në shkrimin e gjuhës shqipe.

Hasan Tahsini kërkonte të argumentonte me fakte se gjuha shqipe nuk kishte nevojë për çfarëdo alfabeti, asaj i duhej një i tillë, që do të ishte i përshtatshëm për shqipen dhe jashtë ndikimeve politike. Atë e tërhiqte vetëm dëshira e përpilimit të një alfabeti, por krahas kësaj ishte i interesuar edhe për hartimin e një fjaltori të shqipes dhe të një gramatike, mendim të cilin e kishin edhe rilindësit e tjerë. Por puna e tij e parë ishte hartimi i një alfabeti, për të cilin duhej një përpjekje e madhe që t’i jepej popullit një sistem shkrimor i thjeshtë, i lehtë dhe që të shkruhej me shpejtësi. Nuk duhej parë madhësia e shkronjave të alfabetit, por vlera dhe funksioni i tyre politik dhe kulturor.⁸

Veprimtarinë intensive, kombëtare, së bashku me patriotët e tjerë të Rilindjes e gjejmë te “Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip”, e themeluar më 1879 dhe në hartimin e të famshmit alfabeti i Stambollit.

Alfabeti i Hasan Tahsinit

Për alfabetin autori duhet të ketë punuar një kohë të gjatë. Disa studiues janë të mendimit se ky alfabet mund të jetë hartuar nga fundi i viteve 60-ta të shekullit XIX,⁹ por nuk mungojnë studiues që theksojnë se ai e hartoi alfabetin e tij në vitin 1858.¹⁰ Sido që të jetë koha kur u shkrua ky alfabet, ai gjeti përhapje pothuajse në tërë Shqipërinë. Sa i përket kohës së kur u shpërnda ky alfabet, mendimet sillen rreth viteve 1870-1874. Konsulli austro-hungarez në Vlorë, në një raport të tij, të datës 12.12.1878 shkruante: “...ka gjash-të vjet që një profesor muhamedan me emrin Hoxha Tahsini ka përpiluar një abece shqip dhe disa copë i ka shpërndarë në Stamboll.”¹¹ A. Dozoni, në veprën “Manual i gjuhës shqipe (1879) shkruante: “Në maj të vitit 1874, autoritetet turke arrestuan në vilajetin e

Hasan Tahsini,
me alfabetin e tij
të veçantë, deshi
t'i tregonte jo
vetëm popullit
shqiptar, por edhe
opinionit të huaj,
se shqiptarët siç
kanë gjuhën e tyre
të lashtë, historinë
dhe kulturën,
duhet ta kenë
edhe alfabetin.

Janinës, anëtarin e komisionit të sipërpërmendur pse shpërndante alfabetin e posaçëm të krijuar prej tij. Jepen tri data të mundshme, 1870, 1872 dhe 1874. Ne na duket më i mundshëm që ky alfabet të jetë përhapur në vitin 1874.¹²

Alfabeti i Hasan Tahsinit ka 36 shkronja,¹³ por shenja ka më shumë. Kështu jepen 29 bashkëtingëllore + 1

që në shqipe nuk është e tillë. Dallon 7 zanore + 1 që është varianti i zanores e. Bashkëtingëlloret i vuri sipas kësaj radhe: b, p, d, t, g, k, v, f, z, s, j, h, l, ll, r, rr, m, n, nj, dh, th, c, x, ç, xh, zh, sh, gj, q+y (i grek). Zanoret i rreshtoi në këtë mënyrë: a, e, e (nazale), i, y, u, o, ë.¹⁴

Autori shpjegimin e shkronjave është përpjekur ta bënte me anë të theksave që u vë sipër atyre. Bashkëtingëlloret i ka radhitur jo sipas rendit alfabetik, por sipas mënyrës së formimit, kryesisht të të organit pasiv, në të zëshme dhe jo të zëshme. Ky kriter nuk është ndjekur gjithnjë, masi si grupe dyshe janë marrë edhe bashkëtingëlloret e lëngëta. Krahës kësaj, alfabeti kishte edhe një të metë. Disa shkronja ishin shumë afër njëra-tjetrës nga ana e formës, e nisur nga ky fakt, disa studiues mendojnë se alfabetit të Hasan Tahsinit i mundon germa j. Ai ka edhe vështirësi të tjera, sa që në shkrimin e zakonshëm do të ishte vështirë të përdorëshin pa gabime.¹⁵

Pasqyra e alfabetit të Hasan Tahsinit fliste për punën dhe përpjekjet e një njeriu reformatore dhe eruditi që me një fletë, falë kulturës së gjerë, kërkonte të hartonte

një sistem të shkrimit të shqipes jashtë çdo ndikimi dhe huazimi. Një alfabet të tillë mund ta hartonte vetëm një njeri i zgjuar, me horizont dhe me disa pikësnyime, siç ishte Hasan Tahsini.

Alfabeti i Hasan Tahsinit filloi të përhapej në Shqipëri, kryesisht në jug, si në Filat, Janinë, Konispol dhe thuhet se më vonë u përhap edhe në Berat, Tiranë dhe Shkodër.¹⁶

Merita e Hasan Tahsinit qëndron në këmbënguljen e tij për ta zgjidhur këtë çështje në të mirë të gjuhës shqipe, larg rrymave politike, me qëllim që alfabeti të mos sillte përçarje, veçanërisht gjatë viteve 1860-1880, por të shërbente si mjet bashkimi në luftën kundër pushtuesve. Duke ndjekur një traditë të nisur më parë, Hasan Tahsini hyri në radhën e autorëve shqiptarë që gjatë shekullit XVIII-XIX kanë krijuar alfabete origjinale. Ai deshi të krijonte një alfabet të thjeshtë, sa shkencor, aq edhe praktik, i frymëzuar nga dashuria e madhe për vendin dhe lulëzimin e kulturës shqiptare. Hasan Tahsini, me alfabetin e tij të veçantë, deshi t'i tregonte jo vetëm popullit shqiptar, por edhe opinionit të huaj, se shqiptarët siç kanë gjuhën e tyre të lashtë, historinë dhe kulturën, duhet ta kenë edhe alfabetin.¹⁷

1. Mehdi Frashëri, Hasan Tahsini, "Minerva", shtator-tetor, 1934. 2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Historia e popullit shqiptar II, Tiranë, 2002. 3. Po aty. 4. Gazmend Shpuza, Hasan Tahsini, rilindës i shquar dhe shkencëtar i madh, Buletini Shkencor, Shkodër, vepër e cituar. 5. Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008. 6. Jani Vreto, Vepër të zgjedhura, Tiranë, 1972, punë e cituar. 7. Po aty. 8. Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008. 9. T. Osmani, Udhë e shkronjave... Ibrahim Dine Hoxha, Njëpër udhën e penës shqiptare: nga historiku i ABC-së dhe i shkrimit shqip, Tiranë, 1986. 10. Necip Alpan Arnavut, vepër e cituar. 11. Leka, 1939, nr.7-8, punë e cituar. 12. Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008. 13. A. Naqellari - A. Pango, Hasan Tahsini, Tiranë, 1980. Autorët shënojnë se alfabeti i H. Tahsinit ka 38 shkronja. 14. Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008. 15. I.D. Hoxha, Njëpër udhën... 16. V. Bajro, art. i cituar. 17. Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Tiranë, 2008.



Mr. Arber Berisha

Sa libra i keni lexuar?

Në kohën e kalifit Me'mun, (215 h./ 830m.), që ka qenë edhe periudha e lulëzimit të diturisë dhe shkencës në botën myslimane, çdo libër i përkthyer në gjuhën arabe peshohej më parë dhe aq sa të vinte i rëndë, po aq edhe paguhej me ari.

Shpeshherë na pyesin: Sa libra i keni lexuar? Por rrallëherë na pyesin: Sa libra i keni studiuar? Libri ka një rëndësi të veçantë sepse ai është sikur vetë jeta e njeriut, prandaj fletët janë ditët, kurse kapakët fillimi dhe mbarimi i misionit të njeriut në këtë botë me emrin dynja. Në lidhje me librin, shumë studiues dhe filozofë u prononcuan si p.sh. Stefan Cvajg (Stefan Zweig), i cili thotë: “Libri është alfa dhe omega e çdo dije, është fillimi i fillimeve të çdo shkence.” Apo një thënie e urtë shqiptare: “Librat shpeshherë kanë më shumë shpirt se sa njerëzit.”¹

Pyetja ‘sa libra i keni lexuar’ duhet të na shtrohet shpesh, mirëpo ka rëndësi sa libra lexojmë në javë, në muaj apo në vit. Leximi e ushqen shpirtin, e frymëzon mendjen, e forcon trupin dhe e shton aftësinë dhe refleksionin për të arsyetuar dhe vepruar.

Allahu xh.sh. na tregon për vlerën e leximit dhe shkrimit në shumë ajete kuranore, po ashtu na këshillon të lexojmë dhe t’u lexohen popujve tregimet për të kaluarën që të marrin mësim për të tashmen dhe të ardhmen. P.sh. ngjarja e pejgamberit Nuh a.s. rrëfyer në librin e Allahut xh.sh. - Kuranin famëlartë:

“Lexoju atyre ngjarjen e Nuhut, kur i tha popullit të vet: “O populli im, nëse u vjen rëndë qëndrimi im në mesin tuaj, përkujtimet e mia me ajetet e Allahut, e unë iu kam mbështetur vetëm Allahut, ju vendosni për qëllimin tuaj, thirrni në ndihmë edhe zotat tuaj, e mos e

mbani fshehtë, dhe zbatoni atë kundër meje e mos pritni.”²

Shkrimtari amerikan, njëherësh edhe një lexues i pasionuar, James Chapman, ka bërë një hulumtim dhe ka përpiluar listën e 10 librave më të lexuar në 50 vitet e fundit. Hulumtimi i tij kishte për bazë numrin e librave të botuar dhe të shitur. Ata libra janë:

1. Bibla - botuar në 3.9 miliardë kopje;
2. “Citatet nga vepra e Mao Tse Tung”, autor: Mao Tse Tung - botuar në 820 milionë kopje;

Ndodhë që në rreshtin tonë kemi myslimanë që kanë arritur moshën 30 vjeçare dhe nuk e kanë lexuar asnjë libër, apo mjerisht një libërth, pra që është më i vogël se një libër.



3. "Harry Potter", autore: J. K. Rowling - botuar në 400 milionë kopje;

4. "Kryezoti i unazave", autor: J.R.R. Tolkien - botuar në 103 milionë kopje;

5. "Alkimisti", autor: Paulo Coelho - botuar në 65 milionë kopje;

6. "Kodi i Da Vinçit", autor: Dan Brown - botuar në 57 milionë kopje;

7. "Saga e Muzgut", autore: Stephanie Meyer - botuar në 43 milionë kopje;

8. "Iku bashkë me erën", autore: Margaret Mitchell - botuar në 33 milionë kopje;

9. "Mendo dhe pasurohu", autor: Napoleon Hill - botuar në 30 milionë kopje;

10. "Ditari i Anna Frankut", autore: Anna Frank - botuar në 27 milionë kopje.³

Po ashtu Kurani famëlartë është një prej librave më të lexuar në botë dhe i shpërndarë në miliona kopje dhe i përkthyer në shumë gjuhë të botës. Ish-kryeministri britanik Tony Blair, prononcohet më 13 qershor 2011, për gazetën "The Express Tribune" kështu: "E lexoj Kuranin e shenjtë çdo ditë."⁴ Befas thash me vete: ky është politikan i lartë e jo praktikues i Islamit, është një ndër njerëzit më të suksesshëm në botë, ai lexon Kuranin çdo ditë dhe me keqardhje kemi myslimanë praktikues të namazit që kalojnë muaj dhe nuk e lexojnë Kuranin.

Ndodhë që në rreshtin tonë kemi myslimanë që kanë arritur moshën 30 vjeçare dhe nuk e kanë lexuar asnjë libër, apo mjerisht një libërth, pra që është më i vogël se një libër. Ata mund të na vijnë me oratori, flasin për Islam dhe japin dekrete, e habitshme është kjo kur ka njerëz që kanë lexuar me mijëra libra dhe janë shumë të matur në fjalimet e tyre.

Në kohën e kalifit Me'mun, (215 h./ 830m.), që ka qenë edhe periudha e lulëzimit të diturisë dhe shkencës në botën myslimane, çdo libër i përkthyer në gjuhën arabe peshohej më parë dhe aq sa të vinte i rëndë, po aq edhe paguhej me ari.

Ne si lexues duhet ta dimë se një libër i ri është një derë më shumë në udhëtimet tona drejt suksesit dhe menaxhimit të jetës sonë në përditshmëri.

Gustav le Bon shkruan: "Në kohën kur librat dhe bibliotekat për evropianët nuk paraqisnin kurrfarë rëndësie, kalifati islam dispononte një numër të madh qendrash dhe bibliotekash madhështore. Për ilustrim do të përmendim 'Shtëpinë e Urtësisë' apo 'Bejtu'l-Hikme' në Bagdad, e cila numëronte katër milionë libra, biblioteka e Sulltanit (Kajro) kishte një milionë, biblioteka e Tripolit (Damask) kishte tre milionë libra, ndërsa në Spanjën myslimane për çdo vit hartoheshin rreth 80 mijë libra."⁵

Përveç librave, sa kemi lexuar gjatë jetës sonë, gjatë vitit, muajit, javës, ditës apo gjatë orëve? Sa i kemi kushtuar rëndësi se si duhet lexuar dhe memorizuar fjalët mes rreshtave.

Në një fjalim anglisht, në këndin e bibliotekës së tij, Mat Morris, një autor i famshëm librash, fliste për rëndësinë e procesit të grumbullimit të revistave, gazetave dhe gjërave informative dhe përshkruese duke i tubuar, hulumtuar dhe mbledhur ato në një vend me sukses e mjeshtri që më pas t'i interpretojë. Leximi i librave, thotë ai, ngrit lart proceset e brendshme dhe të jashtme dhe shton aftësitë për zbulime.⁶

Ne si lexues duhet ta dimë se një libër i ri është një derë më shumë në udhëtimet tona drejt suksesit dhe menaxhimit të jetës sonë në përditshmëri. Disa pyetje që duhet shtruar çdonjëri vetvetes:



1. Sa libra i kam lexuar dhe sa i kam praktikuar?

2. Cili libër më ka bërë të kuptoj jetën dhe arrijtjet drejt sukseseve të mia?

3. Sa lexohet në shtëpinë time?

4. Sa lexohet në lagjen, fshatin, qytetin dhe shtetin tim?

5. Sa kam lexuar gjatë gjithë shkollimit tim dhe sa kishte sukses në ngritjen time akademike ky lexim?

6. Cilat janë librat që më zgjojnë interes dhe kam dëshirë t'i lexoj?

7. Sa libra i kam diskutuar me miqtë pasi i kam lexuar?

8. Sa herë në javë e vizitoj bibliotekën e qytetit apo universitetit?

9. Sa libra të lexuar dhe tituj të ri ia shtoj fondit të bibliotekës sime personale gjatë muajit?

10. Sa po lexohet dhe praktikohet leximi në rrethin ku ne jetojmë?

1. "Mençuri nga personalitete", përzgjedhje: Alba Janaqi, botues: "Reklama", Tiranë 2012, fq. 57-58.

2. Junus, 71. 3. "10 librat më të lexuar", burim i shikuar më: 09.10.2014, <http://www.kultplus.com/?id=5&l=167> 4. Burim i marrë nga gazeta: "Express Tribune", 13 qershor 2011, <http://tribune.com.pk/story/188297/i-read-the-holy-quran-everyday-former-british-pm-tony-blair/> (shikuar së fundi më: 16.11.2014) 5. <http://www.myfinia-shkoder.org/682.html> (shikuar së fundi më: 19.12.2013) 6. https://www.youtube.com/watch?v=_WCfaGarc4U ose <http://www.mattmorris.com> (shikuar së fundi më: 18.11.2014).

Blerim Musliu

A të kujtohet ty...?!

Po ta kujtoj që ta kuptosh se sa të pasur jemi në këtë kohë të varfërisë së madhe shpirtërore, që edhe njëherë t'i ngjallim e t'i jetësojmë mësimet e mëdha të Zotit për falënderim e bamirësi.

Nuk po ju flas atyre që janë rritur në lukse dhe që problemi i vetëm i tyre ka qenë përzgjedhja e markave të rrobave të tyre, apo edhe përzgjedhja e llojeve të ushqimeve. Ani pse te ne si popull, të tillët nuk kanë qenë të shumtë për shkak të statusit që kemi pasur si popull dhe për shkak të historikut që kemi kaluar.

Po të flas ty, që po lexon këta rreshta dhe po dua që ta rikujtojë pak veten tënde, të cilën e ke harruar. Fillimisht po të kërkojë falje për këtë kthim në kohën tënde, kur ndoshta e ke harruar të tërën i zhytur në begatitë e në lukset e shumta.

Por, duhet ta kujtosh pak veten tënde, jo për t'u zhgënjyer e as për t'u mërzhitur, përkundrazi, për ta ngjallur zemrën tënde, e për t'u ngritur edhe

njëherë mbi vrazhdësinë e mos-mirënjohjen e thellë që na ka kapluar... Po ta kujtoj që ta kuptosh se sa të pasur jemi në këtë kohë të varfërisë së madhe shpirtërore, që edhe njëherë t'i ngjallim e t'i

Pejgamberi a.s. ka thënë se nuk është besimtar ai që e zë nata të ngopur, e fqinji i tij është i uritur.

jetësojmë mësimet e mëdha të Zotit për falënderim e bamirësi. E mbi të gjitha për ta zhveshur vetën tonë nga egoizmi i pa ngopjes, i cili po na bën të jemi të uritur në tryezën e shtruar, e po na bën të varfër me pasuritë e pa numëruara.

Sot, unë e di që ti mendon se s'ka njerëz që dertin e tyre më të madh e kanë të kenë veshmbathje, të kenë një kulm mbi kokën e tyre, të kenë për familjet e tyre gjërat e ngjashme që i posedojnë bashkë-moshatarët e tyre, sepse kjo ua djegë shpirtin, edhe pse ndoshta nuk kanë kujt t'ia rrëfejnë këtë, sepse pak kush ua beson.

Që ta njohësh gjendje e tyre, unë po ta rikujtojë veten tënde, atë vetë që t'i vështirë se e pranon, sepse gjendja jote ka ndryshuar dhe tashmë



me një heshtje të rrejshme mundohesh ta bindësh veten se ky që je sot ke qenë gjithmonë, që t'i ikësh falënderimit ndaj Zotit. Harron se ishte një kohë kur gëzimin më të madh e ke pasur kur babai yt me mundë t'i ka blerë të mbathurat e reja. A të kujtohet se ke ecur duke menduar se të shikojnë vetëm ty të gjithë?! Xhemperin për dimër..., a të kujtohet se me çfarë gëzimi e ke veshur, duke pëshpëritur se dimri dhe i ftohti më nuk kanë pse duken aty pari?! A ke harruar kur ndokush sillte ndonjë ëmbëlsirë për të sëmuret, e ti e vrojtoje me sytë e tu kërkues që ta merrje ndonjë pjesë?! A ke harruar sa ka vuajtur nëna jote, kur ti ke kërkuar diçka, e ajo është djegur nga brenda, nga pamundësia për t'ia thënë kërkesën babait tënd, sepse ajo e ka ditur se nuk ka mundësi ta realizonte kërkesën tënde?! A të kujtohet se me sa gëzim e ke pritur për t'i blerë disa fletore për shkollë, e që shpeshherë për dy lëndë mësimore është dashur ta ndash të njëjtën fletore, e që besa shpeshherë bartësi i këtyre fletoreve ka qenë ndonjë beze që nëna me duart e saj e ka improvizuar si çantë.

S'po flasim për ndonjë top apo për ndonjë biçikletë, sepse ky ka qenë standard i imagjinuar për pjesën më të madhe tuajën që po e lexoni këtë shkrim. Lista e përshkrimit është e gjatë, por unë vetëm po dua të kthehem se kush ishte ti...

Besoj që tashmë ke arritur të kthehesh pak në të kaluarën tënde, për ta bërë një krahasim, nëse sot je prind, për mundësitë që i ke për fëmijët e tu, por edhe për ty si i ri, që sot e ki dertin se a po arrin të jesh në hap me kohën në përcjelljen e fundit të telefonave që kanë dalë, në ndërrimin e rrobave sipas modeleve të fundit etj., e nëse nuk e arrin atë, dëshpërimi dhe depresioni janë shokët e tu të ngushtë.

Dije se, edhe pse jemi në këtë kohë, ti i ke harruar këto, e madje ke harruar edhe të bësh lutje për prindërit e tu që kanë kaluar këto vuajtje për ty, e mbi të gjitha ke

“Zoti është në ndihmën e robërve, derisa ata e ndihmojnë njëri-tjetrin.”

(Muhamedi a.s.)

harruar edhe ta falënderosh Zotin për këto begati që t'i ka dhënë.

Mos harro, se edhe sot kemi në mesin tonë njerëz që kanë dëshirë vetëm të jenë si pjesa tjetër, të jenë si ti, madje ka shumë dhe jam i bindur se ka edhe në mesin ku jeton. Mjafton të dalësh e të hulumtosh, e do të gesh mjaft...

A nuk duhet të jemi falënderues ndaj Zotit?! Çfarë të duhet pasuria, kur fqinji yt është i uritur, e Pejgamberi a.s. ka thënë se nuk është besimtar ai që e zë nata të ngopur, e fqinji i tij është i uritur.

Ka shumë nga ata të cilët nuk pranojnë të qajnë për asnjë çmim

për të siguruar diçka nga pasuria jote, sepse për ta, pasuria më e madhe është dinjiteti njerëzor. Kjo gjendje me këtë dallueshmëri të madhe sot nga e kaluara është sprovë për të na parë.

A po e harrojmë të kaluarën e po bëhemi mosmirënjohës ndaj Zotit për të mirat që na i ka dhuruar, për të na parë se si po veprojmë, a po jemi falënderues, e nga falënderimet është të mos e grumbullojmë pasurinë, e që tek e fundit do të mbetet vetëm shifër, por ta ndajmë me të tjerët, e në këtë rast me ata që Zoti nuk ju ka dhënë me urtësinë e Tij, por që mbetet sprovë e sjelljes sonë me ta.

Pra, le ta kujtojmë se ku ishim, e në asnjë mënyrë të mos bëhemi arrogant, e aq më keq, nëse pasuria dhe begatitë na largojnë nga Zoti, por të bëhemi të thjeshtë, falënderues, e ndihmëtarë ndaj njëri-tjetrit. Sepse Pejgamberi a.s. ka thënë: “Zoti është në ndihmën e robërve, derisa ata e ndihmojnë njëri-tjetrin.”

Zoti ynë! Bëna falënderues! E nëse jemi të varfër, bëna punëtorë e durimtarë, e nëse na ke dhuruar mundësi, të deponojmë te Ti, sepse mjafton ai që ka dhënë në rrugën e Zotit, ngase është deponim me shumëfishim të shpërblimit.



Mimoza Sinani

Libri i madh i natyrës është shkruar në gjuhën e matematikës

Interesi i mendimit filozofik për matematikën

Njëzet e pesë shekuj më parë, matematika, që deri atëherë ishte thjesht një grumbull recetash praktike, u shndërrua në shkencë deduktive. Që në kohën e kristalizimit të saj si shkencë e mirëfilltë, me fushën e vet të studimit dhe me metodat e saj origjinale, matematika ka tërhequr vëmendjen e veçantë të mendimit filozofik. Objektet abstrakte matematike, pohimet për to dhe lidhjet racionale të tyre në një sistem logjik të paqortueshëm; vërtetimet, fakti që megjithëse matematika nuk është shkencë empirike, pra nuk e ka eksperimentin në arsenalin e metodave të saj, por arrin në përfundime që gjejnë zbatim dhe verifikim të mrekullueshëm në praktikë për zgjidhjen e problemeve reale, të gjitha këto e kanë ngacmuar gjithmonë mendimin të shtrojë natyrshëm një varg pyetjesh e të përpiqet t'i sqarojë ato.

Ç'është matematika dhe çfarë raporte ka kjo shkencë me realitetin? Si është e mundur që abstraksioni matematik lejon të depërtosh më thellë në thelbin e dukurive e të përfytyrosh më me përpikëri, sesa nëpërmjet vrojtimit të drejtpërdrejtë dhe studimit eksperimental?

Të gjitha këto çështje kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë objekt i një studimi pasionant. Duke filluar nga antikiteti e deri më sot, përfaqësuesit

Kuptimi dhe qëllimi i matematikës, këtij oqeani mendimesh njerëzore, është që të fitohen dije të sigurta dhe themelore, të mësohet e vërteta e cila s'le vend për dyshim.

e drejtimeve të ndryshme filozofike, kanë mbajtur qëndrime të larmishme ndaj tyre..

A është matematika e shkëputur nga bota reale?

Çdo shkencë për të shqyrtuar objektet dhe dukuritë duhet të zbulojë vetitë e tyre jo vetëm në rrafshin cilësor, por edhe në atë sasior dhe në këto rrethana ajo ka nevojë për matematikën, që studion pikërisht marrëdhëniet sasiore, zbulimi i të cilave kërkon një aftësi shumë më të madhe abstraguese.

Fakti që materiali matematik merr një formë jashtëzakonisht abstrakte krijon mendimin se matematika është e shkëputur nga bota reale.

Konceptet matematike krijohen nga vetë matematikanët, por ata nuk

i zgjedhin këto koncepte ashtu si t'u pëlqejë, sepse atëherë do të ekzistonin po aq të vërteta matematike sa ka edhe matematikanët. Shpeshherë matematikanët që jetojnë larg njëritjetrit dhe madje as e njohin njëritjetrin zbulojnë të njëjtat të vërteta e studiojnë të njëjtat koncepte, gjë që është e pamundur të ndodhë në shkrimin e një poezie apo drame.

Konceptet e reja të futura prej matematikanëve u ngjajnë anijeve të reja, që e mbartin studiuesin dhe janë mbështetje për të në detin e mendimeve. Është pohim i gabuar të thuash se matematika merret me gjëra që nuk ekzistojnë. Këto gjëra ekzistojnë, jo në formën e atyre objekteve që mund t'i shohim dhe t'i prekim, por ato mund t'i rrokim vetëm në mendimet tona.

Bota e matematikës si shëmbëllim i botës reale

Njohja e botës së ideve, domethënë e sendeve që nuk ekzistojnë në kuptimin e zakonshtëm të fjalës, hyn në punë në jetën e përditshme për t'u përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me botën reale. Ngjashmëria midis botës reale dhe botës së imagjinuar të matematikës i ngjason shkëmbit dhe pasqyrit të tij në ujë. Ç' ndryshim ka shkëmbi nga shëmbëllimi i tij në ujë?

Shkëmbi është një copë e fortë lënde që ngrohet nga dielli dhe kur e prek ndien në dorë ashpërsinë e tij. Shëmbëllimin s'mund ta prekësh. Po

ta vësh dorën mbi të ndien vetëm ftohtësinë e ujit. Në të vërtetë shëmbëllimi nuk ekziston. Ai është një iluzion e kurrigjë më tepër.

Të gjitha konceptet abstrakte themelore matematike janë kristalizuar prej dijeve për botën reale. Pra bota e matematikës nuk është gjë tjetër veçse shëmbëllimi i botës reale në pasqyrën e mendimit tonë dhe është e kuptueshme që çdo zbulim në botën e matematikës jep informacion për botën reale.

A është matematikani shpikës apo zbulues?

Çka ka të përbashkët midis detarit që kërkon një ishull të pabanuar dhe piktorit që kërkon një ngjyrë të re të papërdorur më parë? Detarin mund ta quajmë zbulues, pasi ai zbulon një ishull që ekzistonte, kurse piktorin shpikës pasi ai shpik një ngjyrë të re.

Matematikani i krijon vetë konceptet që studion dhe në këtë punë ai vepron si shpikës. Kur formulon një teoremë në gjuhën e matematikës dhe e vërteton atë, atëherë ai vepron si zbulues. Pra, matematikani është zbulues; ai është shpikës në atë masë sa i duhet që të jetë zbulues.

Kuptimi dhe qëllimi i matematikës, këtij oqeani mendimesh njerëzore, është që të fitohen dije të sigurta dhe themelore, të mësohet e vërteta e cila s'le vend për dyshim.

Matematikantët përpilojnë hartën e botës reale. Po ku qëndron përparësia e të parit të hartës në krahasim me të parit e terrenit? Kur përdorim hartën studiojmë largësi më të mëdha në krahasim me një udhëtar që sheh vetëm atë që gjendet para tij. Kjo i ngjason soditjes së një pikturë. Po t'i afroresh tablosë shumë afër, do të shohësh vetëm njolla ngjyrash por nuk do ta shohësh tërë tablonë. Është vërtet e dobishme që problemi të shqyrtohet nga disa anë, ashtu siç është e dobishme ta soditësh një skulpturë nga pozicione të ndryshme.

Modeli matematik na ndihmon ta kuptojmë më mirë situatën praktike, sepse kur krijojmë modelin

matematik marrim parasysh të gjitha mundësitë logjike. Madje edhe kur modeli matematik çon në rezultate që ndryshojnë nga realiteti prapë mund të jetë i dobishëm, sepse të metat e një modeli mund të merren parasysh për t'i shmangur në një model tjetër më të mirë.

Trajta matematike e ligjeve themelore të natyrës

Librin e madh të natyrës mund ta lexojnë vetëm ata që e njohin gjuhën me të cilën është shkruar, dhe kjo gjuhë është matematika.

Shpeshherë njeriu zbrapset dhe i trembet vargut të gjatë e të ngatërruar të argumenteve, të cilin duhet ta ndjekë me shumë vëmendje hap pas hapi, për të kuptuar një vërtetim të ndërlikuar.

Ai i ngjason atij që kacavirret në shkëmbinj, duke iu ngjitur majës së malit midis humnerave të rrezikshme dhe i shoqëruar nga frika se mos rrëshqasë në hone. Por kur arrin në majë, pamja e madhërishtme e shpërblen për mundin e rrugës. Alpinisti në fillim e pranon provën sfiluese vetëm me shpresën që t'i gëzohet pamjes së mrekullueshme, por kur mësohet me ngjitjen, vetë kapërcimi i vështirësive bëhet për të burim kënaqësie.

Disa matematikanë i detyrojnë nxënësit e tyre të mësojnë përmendësh rregulla dhe shabllone të

Bukuria e matematikës nuk është thjesht ndonjë veti plotësuese, por veçoria themelore karakteristike e saj. E vërteta është gjithmonë e bukur dhe bukuria është gjithmonë e vërtetë.

ndryshme mekanike. Matematikani i vërtetë synon më shumë që nxënësit të kuptojnë dhe përpiqet t'i mësojë ata të mendojnë me kokën e tyre. Ai që mëson receta në vend që ta ndiejë thellë atë që mëson, kurrë s'ka për t'i përdorur si duhet recetat e mësuara. Llogaritë mirë vetëm ai që mendon.

Bukuria e matematikës si veçori themelore e saj

Matematika jo vetëm është e dobishme dhe e domosdoshme, por edhe një aventurë rrëmbyese dhe e mahnitshme e arsyes njerëzore. Bukuria e matematikës nuk



është thjesht ndonjë veti plotësuese, por veçoria themelore karakteristike e saj. E vërteta është gjithmonë e bukur dhe bukuria është gjithmonë e vërtetë. Ata që janë të verbër ndaj bukurisë së matematikës dhe mendojnë se bukuria është një stoli e tepërt, nuk mund t'i afrohen realitetit. Aleksandri i Madh, në zemërim e sipër e preu me shpatë nyjën gordiane pasi s'ishte në gjendje ta zgjidhte enigmën e saj. Cilitdo që e ka ndier bukurinë e matematikës, nuk i vjen keq për mundin e harxhuar. Qëllimi kryesor i të mësuarit të matematikës është t'i bëjë të njohur njeriut këtë kënaqësi dhe me ndihmën e saj të stërvitë mendimin e tij të disiplinuar e logjik. Ai që e ka përveçësuar artin e mendimit logjik në matematikë mund të përdorë atë në çdo fushë të jetës.

Zbatimi praktik i rezultateve matematike

Kënaqësia e njohjes që jep studimi i matematikës nuk është i vetmi shpërblim për shkencëtarin. Matematikani interesohet edhe për zbatimin praktik të rezultateve të tij matematike.

Matematika ia zbulon të fshehtat e saj atij që i qaset me dashuri të pastër dhe për hir të bukurisë që ka. Ata që veprojnë kështu shpërblehen me rezultate me rëndësi praktike. Arti i matematikës së zbatuar është diçka e ndryshme prej zbulimit dhe vërtetimit të teoremave. Matematika e zbatuar i ngjet luftës: ndonjëherë një humbje vlen më shumë se fitorja e një beteje, sepse të ndihmon të zbulosh të metat e armatimit apo të strategjisë.

Që ta zbatosh me sukses matematikën në objektet e reja duhet ta kuptosh thellë atë dhe duhet të jesh matematikan krijues. Dhe anasjelltas, interesi për zbatimet të ndihmon edhe për studimet e kulluara matematike.

Pyetjes se: a nuk i ngjan ai që dëshiron të zbatojë matematikën atij njeriu që përpigjet të ecë kaluar mbi

“Më jepni një pikëmbështetje dhe unë do ta lëviz lëmshin tokësor,”

(*Arkimedi*)

dy kuaj njëkohësisht, mund t'i përgjigjemi: ai që synon të zbatojë matematikën i ngjan njeriut që do të mbrehë dy kuaj në një karrocë.

Matematikani zbatues është krijues me fantazi dhe intuitë të mprehtë. Veç matematikës atij i duhet të njohë edhe fushën e studimeve ku do ta zbatojë atë. Pa fantazi nuk do të ishin shpikur kurrë ekuacionet lineare dhe kuadratoke, funksionet trigonometrike, njehsimi diferencial e integral.

Struktura arsyetuese logjike-deduktive e matematikës

Nëse citojmë thënien e Arkimedit për llozet: “Më jepni një pikëmbështetje dhe unë do ta lëviz lëmshin tokësor,” [Alfred Renyi, *Dialogues on Mathematics*, janar, 1967.] do të thoshim se në tokë natyrisht s'e gjen një pikë të tillë, megjithatë në matematikë ka një pikë ku mund të mbështetesh – këtë e përbëjnë aksiomat dhe logjika.

Matematika ka një natyrë të pastër intelektuale dhe bazohet në një seri aksiomash të deklaruara të vërteta. Një pohim matematikor konsiderohet i vërtetë nëse gjatë vërtetimit të tij ndiqet një strukturë arsyetuese logjike-deduktive.

Çelësi i sukseseve të matematikanëve, qëndron në metodat e tyre, në standardet e larta të kërkesave të tyre logjike, zakoni për të nisur gjithmonë nga parimet fillestare, nga përkufizimet e çdo koncepti, nga

përdorimi i saktë dhe pa kundërthënie të brendshme të tyre.

Barriera artificiale midis matematikës dhe shkencave natyrore

Filozofët grekë diskutojnë shpesh për lëvizjen. Janë të njohura paradokset e Zenonit për Akilin dhe breshkën. Zenoni u orvat të provonte se lëvizja ishte e pamundshme. Paradokset e Zenonit u hodhën poshtë vetëm nëpërmjet përshkrimit matematik të lëvizjes. Sipas tij lëvizja ishte koncept kundërthënës prandaj nuk mund të përshkruhej me mjete matematike. Edhe Aristoteli, ashtu si Zenoni, pohonte se studimi i lëvizjes s'mund të jetë detyrë e matematikës, sepse sipas tij shkencat natyrore kanë të bëjnë me objekte që ndryshojnë, ndërsa matematika me objekte të pandryshueshme. Doktrina e tij e gabuar ngrihej mbi një barrierë artificiale midis matematikës dhe shkencave natyrore të cilën vetëm disa njerëz guxuan ta kapërcenin.

A është matematika një tog rregullash të ngurta?

Arkimedi ishte ndër matematikanët e mëdhenj të antikitetit që iu përkushtua zbatimit të matematikës, duke e shpërfillur mendësinë e asaj kohe sipas së cilës vetëm matematika teorike meriton të quhet shkencë, ndërsa përdorimi praktik i saj konsiderohej si zeje me të cilën mund të merreshin zejtarët. Ai arriti rezultate të mrekullueshme dhe i zbatoi në praktikë përfundimet e gjetura, duke e konsideruar shkencën si diçka të gjallë e jo si një tog rregullash të ngurtë.

Ai kishte një kuptim të ri për marrëdhëniet e shkencës me teknikën, që e kapërcente shumë kohën e vet. Përvoja dhe problemet praktike e nxitën atë të krijonte koncepte të reja, të cilat ai i saktësonte dhe i përpunonte sistematikisht nëpërmjet hetimit shkencor. Nga rrjedhojat e nxjerra teorikisht, buronin idetë e reja për të ndërtuar modele të tjera makinash mjaft të efektshme. Ai



Shkencëtarët arabë kontribuan me punimet e tyre shkencore në zhvillimin e mendimit shkencor, dhe në ndërtimin e kulturës dhe të civilizimit njerëzor, gjatë periudhës islame.

përdorte metodat matematike për t'u vënë një themel të sigurt logjike gjetjeve të veta, por në fazën e zbulimit ai parapëlqente të përdorte metoda intuitive, sidomos të mbështetura në përfytyrime mekanike. Kjo metodë sot është në themel të progresit teknik bashkëkohor.

Ndikimi i arabëve në fushën e shkencave natyrore

Shkencëtarët arabë bënë një revolucion të vërtetë në matematikë duke përdorur numrat në bazë të sistemit decimal.

Në matematikë, posaçërisht në fushën e gjeometrisë dhe të progresionit aritmetik, matematikanët

arabë arritën rezultate shumë të mëdha, ndërsa përmes hulumtimeve të progresioneve ata ndikuan në formimin e llogaritjes diferenciale dhe integrale, si dhe të tabelave logaritmike.

Shkencëtarët arabë kontribuan me punimet e tyre shkencore në zhvillimin e mendimit shkencor, dhe në ndërtimin e kulturës dhe të civilizimit njerëzor, gjatë periudhës islame. Ata përkthyn në gjuhën arabe të arriturat shkencore të grekëve dhe trashëgiminë kulturore të popujve, duke luajtur një rol ndërmjetësues ndërmjet epokës greke dhe epokës së re shkencore.

Ata vendosën themelet e metodologjisë së re në punën kërkimore shkencore dhe ndikuan fuqimisht në renesancën evropiane në fushën e shkencave natyrore, duke qenë kështu paraardhës të Bekonit, të Dekardit dhe të shkencëtarëve të tjerë të renesancës evropiane, të cilët u njohën me të arriturat shkencore të arabëve përmes përkthimeve të veprave arabe në gjuhën latine dhe në gjuhë të tjera evropiane.

Kodimi matematikor i Kuranit

Kërkesa për stil matematik të të menduarit sot thuhet se është universale. Të rinjtë duhet të mësohen t'i shohin konceptet, metodat dhe rezultatet matematike jo vetëm si një sistem logjikisht të përsosur, por edhe si një mjet të pazëvendësueshëm për

të zbuluar të fshehtat e natyrës, për të ndërtuar në mënyrë racionale çdo lloj veprimtarie, për të vjelë informacion më të plotë e më të saktë nga çdo studim të dhënash.

Matematizimi është shtrirë jo vetëm në shkencat e tjera të natyrës, por edhe në degë të dijes pa kurrfarë afrie me matematikën, si në gjuhësi e psikologji, ndërsa në kohën tonë është kthyer në prirjen thelbësore të progresit tekniko-shkencor.

Një ndër fushat që duhet të studiojnë të rinjtë myslimanë është edhe kodimi matematikor i Kuranit. Kurani përmban një sërë mrekullish matematikore. Kodimi matematikor i Kuranit është i mahnitshëm. Zbulimi i këtij kodimi e shton dhe e forcon akoma më shumë besimin tonë të palëkundur në Krijuesin e Madhërishtë të kësaj gjithësie.

Nëse në një sistem koordinativ (xOy), renditjen e sureve e vendosim në boshtin e abshisave (Ox), ndërsa numrin e ajeteve të sures përkatëse e vendosim në boshtin e ordinatave (Oy), dhe për çdo sure vendosim një pikë tek numri ajeteve që ka kjo sure, atëherë në grafik do të na shfaqet vizualisht emri i autorit të Kuranit: ALLAH.

I lartësuar qoftë Allahu në madhërinë e Tij të pakufishme.

1. Alfred Renyi, *Dialogues on Mathematics*, janar, 1967.

Samire Bilalli

Ti, natë që nuk agon

“Me të vërtetë pas vështirësisë vjen lehtësimi; dhe me të vërtetë pas vështirësisë vjen lehtësimi.” (El-Inshirah, 6-7)

Ti moj natë sonte qenke më e gjatë. Në hallet e njeriut qenke rënduar, e më rëndë vijnë tiktaket e orës, të cilat dhimbshëm bëjnë zhurmë e nuk ndalojnë. Jo..., sonte nuk përfundojnë. Sonte edhe hëna qenka zemëruar, e edhe dielli qenka fshehur, s'ka për të aguar.

Sonte zemra e hallexhiut garon me orën dhe rrahë më fortë. Realiteti është veçse një ëndërr.

Zymtësia e natës qenka e frikshme, e frika shtohet edhe më shumë në terrin e natës që nuk agon.

“Nesër kam për ta paguar një borxh. Është afati i fundit...” – thotë borxhliu. Ai s'ka nga t'ia mbajë.

Nata sonte qenka e ashpër... acar.

“Nesër kam provimin e fundit, finalin. E nëse rrëzohem, dështoj...” – thotë studenti që veç ai e di se si arriti deri në fund. Si ia doli me këto net të gjata që nuk mbaronin. As kafa nuk ia largonte hallin.

Nata ishte e gjatë edhe për një grua që nga një burrë u dhunua. Në kokën e saj ishte krijuar një turbullirë, a të qëndronte a të largohej, apo për fëmijët e saj të vetëflijohet?

Po, po, sonte kishte për ta marrë vendimin. Prandaj kjo natë ishte e gjatë dhe agimin se kishte mik të mirë.

Kjo natë ishte mjaft tinëzare. Fshihej brenda dyerve të shtëpisë. Mbyllej me çelës. Nga errësira njerëzit nuk e shihnin mëkatën, mirëpo Lartmadhëria e Tij po e shihte. Nata inspironte errësirën edhe në zemrën e mëkatarit. Ai mëkatonte e vazhonte, sikur kjo natë kurrë nuk do të agonte.

Me të vërtetë nuk agoi për mëkatarin. Ai me vete mori nën dhe edhe mëkatën bashkë me errësirën.

Përveç tiktakeve të orës, në arkën e një shtëpie, sonte dëgjohej edhe zhurma e centëve të fundit. Si arka, ashtu edhe kuzhina e asaj shtëpie ishin bosh. Edhe shpresa në zemrën e kryefamiljarit ishte venitur. “Po nesër, a do ta shtrijë dorën në rrugët e frohta e të bëhem lypës?” – pyeti ai veten.

Nën heshtjen e frikshme të natës, dëgjohej një e qarë. Një foshnje ishte braktisur. Një foshnje ishte e uritur. Po ç'faj kishte kjo foshnje që njerëzit nuk kishin një fije përgjegjësie, e ta linin në vetmi. Prandaj kjo natë ishte e gjatë dhe s'kishte për të aguar.

E sa e sa ngjarje nata po i fshihte në gjirin e saj korb të zi. Mirëpo, sa e sa zemra kishin shpresë

ende. Sa e sa duar kishin kërkuar falje në lutjet e tyre në këtë natë. Kishin pritur agimin në sexhaden e thurur nga lotët e ngashërimit, dënësia e pikëllimi.

Në këtë natë jo gjithçka ishte e zezë. Mirëpo nga e zeza nuk dallohej edhe bardhësia e shpirtrave që besonin bindshëm në premtimin e Lartmadhërisë. E premtimi i madh ishte ky:

“Me të vërtetë pas vështirësisë vjen lehtësimi, dhe me të vërtetë pas vështirësisë vjen lehtësimi.” (El-Inshirah, 6-7)

Ai, Madhëria e Tij na premtoi dy herë, që zemrat tona të bindeshin. Nëse nuk besojmë në herën e parë, ja ku ishte edhe premtimi i dytë.

E lind pyetja: “A agoi nata?” E unë them: “A nuk po i besoni fjalës së Librit të Madh?”

“A nuk është mëngjesi afër?” (Hud, 81)

Nata agoi... përfundoi, se nata është vështirësia e lehtësimi është drita. Pas çdo nate ka dritë, ka shpresë. Pas çdo halli ka një zgjidhje. Pas çdo lutje ka një pranim. Pas çdo pranimi ka një realizim. E pas çdo gjëje është Ai, i Lartmadhërisë, Allahu xh.sh..



Bilall Maliqi

Monografi e veçantë me fotografi dhe fjalë

“Kush ndërton një xhami, duke e kërkuar kënaqësinë e Allahut, Allahu ia ndërton atij një të ngjashme në Xhenet.” (Hadith: Buhariu dhe Muslimi)

Fjala monografi rrjedh nga fjala e vjetër greke, e cila do të thotë: debat shkencor që merret hollësisht me një lëndë; shkencë apo të personave, gjegjësisht ngjarjeve historike, studim shkencor, i gjerë e i hollësishëm, që trajton një çështje a një temë të veçantë: monografi gjuhësore, etj., por monografi shkruhen edhe për objekte të vjetra fetare dhe për ato që janë ndërtuar më vonë, e të cilat në këtë rast luajnë rol kyç në tubimin e shqiptarëve të konfesionit islam për t'i kryer ritualet e përditshme fetare, që janë të lidhura shpirtërisht me Zotin e Madhëruar.

Duhet ditur mirë, se në kohët më të vështira për popullin shqiptar, xhamitë kanë qenë objekte për tubime të ndryshme kulturore, për

mësim fetar dhe shkollor, si dhe kanë luajtur rolin kyç në mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe fetar në përgjithësi. Prandaj, ndërtimi i një xhamie në ndonjë lokalitet (që vërtet ka nevojë) është i mirëseardhur për atë qytet, meqenëse aty tubohen besimtarët tanë dhe me dëgjimin e ligjëratave fetare të hoxhallarëve tanë, sheshojnë parimin e drejtësisë, të mirës, respektit, humanizmit dhe forcimit të vëllazërisë ndër shqiptare. Andaj edhe botimet e librave monografik të karakterit moralizues fetar japin efektin pozitiv në shoqërinë tonë.

Ndërtimi i xhamisë, domosdoshmëri

Ishte viti 2006, kur veçse filloi të thirret për herë të parë ezani në këtë xhami, në një objekt fetar të pa përfunduar, por që falja e namazit dhe lutjet u kryenin në të. Pra, në këtë pjesë të qytetit të zgjeruar me

popullatë, e cila kishte një nevojë për ndërtimin e një objekti të tillë fetar, në mënyrë që besimtarët e kësaj pjesë të qytetit t'i kryenin ritualet fetare në mënyrë komode. Kjo ndodhi falë donatorëve, vullnetmirëve, falë besimtarëve të devotshëm, të cilët për një afat të shkurtër arritën që ta përfundonin objektin e xhamisë, e cila e zbkuroi qytetin tonë.

Shkrimin tim do ta vazhdojë me këtë thënie interesante, mbase edhe të qëlluar enkas për këtë libër: “Kush ndërton një xhami, duke e kërkuar kënaqësinë e Allahut, Allahu ia ndërton atij një të ngjashme në Xhenet.” (Hadith: Buhariu dhe Muslimi)

Pra, të gjithë këta njerëz, e që nuk janë të paktë, me kontributin e tyre, që nga gurthemeli i nisjes së ndërtimit e deri në fazën finale, asnjëherë nuk u ndalën së kontribuuari për xhaminë e tyre. Kjo xhami jep një pasqyrë bukurie për qytetin tonë të populluar me mbi 97% me shqiptarë të besimit

Në kohët më të vështira për popullin shqiptar, xhamitë kanë qenë objekte për tubime të ndryshme kulturore, për mësim fetar dhe shkollor, si dhe kanë luajtur rolin kyç në mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe fetar në përgjithësi.





islam. Të gjithë këta, pa dyshim se Zoti i Madhëruar do t'i shpërblejë me të mirat e Tij.

15 vjet funksionim

Xhamia “Ebu Bekër es-Sidik” në Preshevë tanimë ka 15 vjet që funksionon shkëlqyeshëm në suaza të mirësjelljes së imanit të parë dhe të vetëm të kësaj xhamie, hoxhës Sevdail Jakupi, i cili ka dhënë një kontribut të pasqorë si në ligjërata, ashtu edhe me kulturën dhe afërsinë e tij me të gjithë besimtarët. Sigurisht se nuk duhen anashkaluar edhe të zgjedhurit e këshillit të xhamisë, andaj këto vite që i ka kjo xhami, që nga ditëlindja e parë e deri më tani, brenda saj ka një rregull që e bënë këtë objekt fetar të veçantë dhe të dëshiruar për kryerjen e ritualeve fetare, por edhe për vizita të thjeshta.

Çfarë fshihet brenda kësaj monografie?

Brendia e monografisë shoqërohet me tema dhe kapituj të ndryshëm, duke filluar që nga nisja (gurthemeli) e ndërtimit të xhamisë, duke ecur kështu në etapa kohore të mbarëvajtjes së punëve, të cilat ishin me dinamikë të shtuar, ngase vullneti i

Autorët e librit, lëndën e kanë shkrirë në titujt përkatës me të dhëna të sakta, duke përshkruar xhaminë, brendinë e saj, pamjen e jashtme, si dhe objektet përcjellëse jashtë xhamisë, për të përfunduar me mendimet dhe mbresat e njerëzve që i kanë shkruar, e që autori i ka futur brenda kapakëve të librit.

kontribuuesve ishte i madh, andaj edhe punët shkonin mirë. Më pas, para nesh del një tablo shumë reale e përshkrimit të punëve në dritën e shifrave dhe fakteve, gjë që e bën interesant atë, ashtu siç e bëjnë edhe më interesante dhe tërheqëse edhe fotografitë kolor që e kompletojnë këtë vepër me peshë dhe me vlerë.

Autorët e librit, lëndën e kanë shkrirë në titujt përkatës me të dhëna të sakta, duke përshkruar xhaminë, brendinë e saj, pamjen e jashtme, si dhe objektet përcjellëse jashtë

xhamisë, për të përfunduar me mendimet dhe mbresat e njerëzve që i kanë shkruar, e që autori i ka futur brenda kapakëve të librit.

Monografia “Xhamia Ebu Bekër es-Sidik” e autorëve Sevdail Jakupi dhe Besame Jakupi, nuk mëton të jetë monografi shkencore, por ngërthen në vete materiale të thukëta të një periudhe pesëmbëdhjetë vjeçare, të cilat kanë ditur t'i sistemojnë dhe t'u japin rëndësi dhe vlerë.

Ky libër është një letërnjoftim kujtese dhe rikujtuese si për lexuesit, ashtu edhe për vizitorët e mundshëm, të cilët posa ta lexojnë monografinë, do t'u ngjallet kureshtja që ta vizitojnë dhe të mishërohen me të. Në të ardhmen presim që të vazhdohet edhe më tutje me shkrime të ndryshme për xhaminë e pse jo edhe ma vazhdimin e kësaj monografie (pjesa e dytë), në të cilën do të ketë edhe shkrime të tjera të këtij karakteri, por pse jo edhe të studiuesve të tjerë.

Autorëve të këtij libri ju dëshirojmë shëndet dhe suksese të mëtutjeshme në lëmin e krijimtarisë në fushën përkatëse!

(Sevdail Jakupi & Besame Jakupi – “Xhamia Ebu Bekër es-Sidik”, Preshevë (monografi), shb “Lena”, Prishtinë, 2021, fq. 135 ISBN 978-9951-27-706-8).

Haxhi Raif Sopaj

Rrëfim nga vitet e luftës së fundit

Jeta në kampin e refugjatëve ku u vendosëm ishte shumë e rëndë, kur kësaj ia shtojmë edhe mosnjohjen e gjuhës, ajo u vështirësua edhe më shumë, sepse ishte një vend që ndryshonte tërësisht nga forma dhe stili i jetës sonë.

Kosova po digjej flakë. Ushtria dhe paramilitarët serbë s'po linin asgjë në këmbë. Vrisnin, digjinin, depërtonin dhe shkatërronin çfarë u dilte përpara. Në këto rrethana, ne na detyruan që ta lëshonim vendlindjen ku kishim jetuar ne dhe të parët tanë, duke na drejtuar si të gjithë shqiptarët e tjerë, drejt në kampin e Stankovecit. Në këtë kamp qëndruam plot 21 ditë, ku pas kësaj kohe na dërguan në aeroport dhe nga aty fluturuam drejt Republikës së Çekisë, një shtet që kishte strehuar një numër të madh të shqiptarëve të ikur nga vatrat e luftës së fundit.

Jeta në kampin e refugjatëve ku u vendosëm ishte shumë e rëndë, kur kësaj ia shtojmë edhe mosnjohjen e gjuhës, ajo u vështirësua edhe më shumë, sepse ishte një vend që ndryshonte tërësisht nga forma dhe stili i jetës sonë. Pas një kohe, aty u takuam edhe me përfaqësuesit e komunitetit mysliman vendor, të cilët na ofruan mbështetje dhe ndihmë, si në veshmbathje, literaturë për mësim-besim e për nevojat të tjera.

Duhet theksuar se edhe autoritetet çeke u treguan shumë mikpritëse dhe na ndihmuan shumë. Kampi ynë quhej Vishnyllo. Aty kemi qëndruar dy ditë. Në atë kamp kemi pasur edhe kujdesin për aspektin shëndetësor. Unë aty ishte me bashkëshorten, me dy djemtë, me vajzën dhe me rreth 500 refugjatë të tjerë, gra, fëmijë e pleq. Nga aty, pas një kohe kemi lëvizur drejt një qyteze tjetër, Zbyshov, ku kemi qëndruar

afro katër muaj e gjysmë në një ndërtesë dy katëshe. Aty kishim një siguri të plotë. Pas një kohe, ramë në kontakt me një përfaqësues të komunitetit mysliman, e më pas në vizitë erdhën dy boshnjak dhe dy arabë, të cilët sollën ushqim, veshmbathje dhe shama për gra. Por, përveç këtyre, ata na sollën edhe mus'hafa dhe nga ne kërkuan që ta bënim një klasë për mësim-besim.

Mua si lexues i mirë i Kuranit më angazhuan që t'i mësojë të gjithë ata që shprehin interesim për mësim-besim dhe lexim të Kuranit në gjuhën arabe. Nga ai moment, mua më autorizuan ta bëj mësimin e atyre që dëshironin të fillonin me librin "Elif" dhe me gjërat elementare të fesë, e sidomos të fëmijëve. Me ne aty ishte edhe Smajl Gashi i Petreshticës, Shaban Matiqani, Nuh Gashi dhe mixha Bajrush nga Kaçaniku. Aty i kemi tubuar fëmijët për t'i mësuar, e ata për ne ofruan një sallë me të gjitha kushtet e një klase, me lejen e autoriteteve çeke. Këtë kurs e vijuan 26 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 8 vajza nga klasa e katërt deri në të tetën. Në ndërkohë, ata na ofruan edhe disa "Ilmihala" shqip dhe ia filluam punës, kurse arabët na pajisën me mësim e parë me temën kushtet e imanit (amentu bil-lahi), për të vazhduar më pas me kushtet e islamit, abdesit e kështu me radhë. Xhumanë e radhës kemi shkuar për ta falur në qytetin Berno, 25 km nga vendqëndrimi ynë, e pas faljes e festuam katër vjetorin e hapjes së xhamisë, të cilën e kishin ndërtuar

turqit dhe arabët. Kohë pas kohe, për delegacionet që nga vizitonin herë pas here përgatitshim edhe programe me ilahi dhe kaside.

E kështu kaluan ditët e muajt, e deshi Zoti dhe erdhi dita që të ktheheshim në shtëpitë. Në përcjelljen tonë kishin dalë përfaqësues të komunitetit mysliman dhe duke na përcjellë na e kujtuan ajetin 111 të sures Ali Imran, që duhet t'i kushtojmë rëndësi jetike thirrjes islame, ngase jemi populli më i zgjedhur në mesin e njerëzimit, që udhëzojmë për të mirë dhe ndalojmë nga e keqja.

E ne i falënderuam, duke lutur Zotin për mirëqenie dhe që t'ua shtojë të mirat për tërë këtë ndihmesë dhe solidaritet që treguan për ne.



Dr.Sci Agron M. Rexhepi

Nevojat energjetike të organizmit (1)

“Ushqimi i përgatitur për dy, është i mjaftueshëm edhe për tre, kurse ushqimi i përgatitur për tre, mjafton për katër”

Nga shumë faktorë ekzogjen që veprojnë fuqishëm në organizmin e njeriut, që nga lindja e deri në vdekje, pa dyshim është ushqimi. Nutricioni apo të ushqyerit është furnizimi i qelizave të organizmit me materie (në formë të ushqimit), të domosdoshme për vazhdimin e jetës. Ndërkaq, nutricionistika është shkencë relativisht e re dhe mjaftë dinamike, e cila studion mënyrën e të ushqyerit të shëndoshë, si dhe hulumton reagimet metabolike dhe fiziologjike të organizmit në dieta të ndryshme.

Në përbërjen kimike të organizmit të njeriut hyn një numër shumë i madh i elementeve kimike të kombinuara në proporcione të ndryshme. Afërsisht 65% të organizmit (apo $\frac{3}{4}$ e peshës trupore) e përbëjnë dy elemente kimike: oksigjeni dhe hidrogjeni që, të kombinuara, japin ujin. Ndërkaq, pjesa tjetër e organizmit (afërsisht 35%) është materia e thatë e organizmit që përbëhet 30% nga materiet organike (proteinat, karbohidratet dhe yndyrat) dhe 5% nga materiet minerale (kripërat inorganike).


Në “fabrikat energjetike” të organizmit të njeriut, përmes proceseve oksiduese, afro 40% e energjisë që ndodhet në ushqim transferohet në bashkëdyzimin kimik energjetik – ATP (adenozinë trefosfat). Kjo molekulë, më pastaj, i nënshtrohet reaksionit hidrolitik, me ç’rast lirohet sasia e energjisë së lirë (e cila përdoret për punë mekanike, si p.sh. rrëshqitja e fijeve muskulore aktinë në fije

miozinë) dhe energjia në formë të nxehtësisë. (1,3,4)

Sot zgjedhjes së problemeve nutritive, të cilat dita më ditë po rriten, nutricionistika ju kushton rëndësi e posaçme. Përderisa në disa vende të botës ka mungesë të ushqimit, në vendet tjera ka tepriçë. Në të dy rastet si pasojë e disbalancës së dietës lajmërohet gjendja e malnutricionit, gjendje kjo mjaftë kërcënuese për shëndetin e popullatës së përfshirë (7). Si formë mjaftë të shpeshtë të malnutricionit vlen të përmendim gjendjen e trashësisë trupore apo të mbipeshës (obeziteti), e cila gjendje karakterizohet me akumulim të tepërt të indit dhjamor, dhe veçse është duke i marrë përmasat epidemiologjike. Që t’i shmangemi kësaj gjendjeje të padëshiruar duhet ruajtur ekuilibrin ndërmjet energjisë hyrëse – oksiduese dhe energjisë dalëse – hidrolitike ($E_h = E_d$). Deri te

trashësia trupore vije kur ekuilibri ndërmjet këtyre dy energjive prishet në favor të energjisë hyrëse ($E_h > E_d$). Ky lloj i prishjes së ekuilibrit ndërmjet energjive mund të vije si pasojë e disa faktorëve, si p.sh. marrja e tepërt e ushqimit, mungesa e aktiviteteve fizike, apo të ndonjë faktori patologjik. Sigurisht se nuk duhet harruar edhe faktorin gjenetik i cili vepron deri në 50%. Në rastet kur veçse kemi të bëjmë me trashësi trupore, atëherë sa më shpejtë që është e mundur duhet të rivendoset ekuilibri i prishur ndërmjet energjive. Rivendosja e këtij ekuilibri kërkon përpilimin e programeve gjegjëse nutritive, si dhe programeve stërvitore. Krejt kjo duhet bërë me qëllim të zvogëlimit të kalorive të marra dhe rritjes së kalorive të shpenzuara. (2,4)

E një rëndësie primare është që, ende pa filluar përpilimi i planit





nutritiv për një person, të caktohet nevoja ditore energjetike për atë person, respektivisht sasia e energjisë hidrolitike - e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve ditore. Në organizmin e njeriut energjia e liruar, pas reaksioneve hidrolitike, shfrytëzohet për:

I. Metabolizmin bazal, që nënkupton sasinë e energjisë së nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit. Kjo vlerë është më reale në orët e mëngjesit (pas zgjimit nga gjumi), respektivisht pas një agjërimi 12 orësh (abstenim nga çdo lloj ushqimi);

II. Zhvillimin e aktiviteteve fizike, të përditshme;

III. Tretjen e ushqimit (efekti termik)..

I. Metabolizmi bazal

Metabolizmi bazal nënkupton sasinë minimale të energjisë së nevojshme për mbajtjen e funksioneve vitale të organizmit, kur organizmi është në gjendje të pushimit të plotë. Kjo vlerë më së miri do të matej kur organizmi është në një gjendje të pushimit të plotë (pas zgjimit, apo pas një agjërimi 12 orësh), në ambient të rehatshëm, të

qetë dhe të ngrohtë. Metabolizmi bazal mund të jetë “përgjegjës” për shpenzimin e më shumë se 70% të energjisë së përgjithshme që e shpenzon organizmi i njeriut.

E tërë kjo energji shpenzohet për mbajtjen në jetë të funksioneve vitale të organizmit, siç janë: proceset respiratore, kardiovaskulare, termoregullacioni, tretja e ushqimit, eritropoeza, etj.

Metabolizmi bazal ndryshon nga individ në individ, dhe është pikënisje për kalkulimin e sasisë së përgjithshme të energjisë që organizmi ka nevojë (qoftë për mbajtjen e peshës trupore që ka, për shtimin apo për humbjen e saj). Metabolizmi bazal është i determinuar nga faktorë gjenetikë dhe nga faktorë të jashtëm:

- Faktorët gjenetikë – disa njerëz janë të lindur ta kenë metabolizmin bazal të shpejtë, e disa më të ngadalshëm;
- Gjinia – Pasi që meshkujt kanë masë muskulore më të madhe krahasuar me femrat, edhe metabolizmin bazal e kanë më të madh;
- Mosha – pas moshës 20 vjeçare vlera e metabolizmit bazal zvogëlohet, afërsisht 2% për çdo dhjetë vjet;

- Peshë trupore – Sa më e madhe të jetë peshë trupore aq më të mëdha do të jenë kërkesat energjetike për metabolizmin bazal;
- Lartësia trupore – Personat me trup të gjatë dhe të dobët e kanë metabolizmin bazal më të rritur krahasuar me personat me peshë trupore të njëjtë, por me trup më të shkurtër;
- Përqindja e indit dhjamor – Sa më e vogël të jetë masa dhjamore e trupit aq më i madh do të jetë metabolizmi bazal dhe anasjelltas;
- Dieta – Uria e madhe e zvogëlon shumë metabolizmin bazal;
- Temperatura trupore – Çdo rritje e temperaturës së brendshme trupore për 0.50C e rrit metabolizmin bazal afërsisht për 7%;
- Temperaturat e ambientit të jashtëm – Si temperatura e ulët ashtu edhe temperatura e lartë e ambientit të jashtëm e rrisin metabolizmin bazal;
- Gjëndrat – Gjëndra e tiroidesë, përmes hormonit tiroksin, kontrollon nivelin e metabolizmit bazal. Sekretimi i shtuar i këtij hormoni (thyrotoxicosis) rrit metabolizmin bazal mbi vlera normale, ndërsa zvogëlimi i sekretimit të tiroksinës

(myxoedema) ul metabolizmin bazal ndër vlera normale;

- Stërvitjet (aktivitetet fizike) – ndikojnë në rritjen e metabolizmit bazal gjatë dhe pas aktivitetit fizik;
- Sëmundjet e ndryshme (p.sh. ethet, shtimi i stres-hormoneve) rrisin metabolizmin bazal, ndërkaq uria, agjërimi apo malnutricioni ulin metabolizmin bazal.

Siç e kemi cekur më lart, konform faktorëve të lartpërmendur, në rastet kur dëshirohet humbja e peshës trupore duhet që dieta në ushqim të shoqërohet me shtimin e aktiviteteve fizike (për shkak se rritet shpenzimi i kalorive të tepërta).

Për llogaritjen e metabolizmit bazal të një personi, deri më tani, janë propozuar shumë formula, të cilat marrin parasysh faktorë të ndryshëm, si: gjinia, mosha, lartësia trupore, pesha trupore, masa muskulore pa dhjamë, si dhe niveli i aktivitetit fizik që bëhet. Meqenëse masa muskulore është faktor që, në një masë të madhe, e determinon nivelin e metabolizmit bazal, pjesëmarrja e saj në formulat llogaritëse të metabolizmit bazal do të ishte mjaft e rëndësishme. Por, për shkak të lehtësisë së punës, edhe formulat tjera që përcaktohen nga faktorë të tjerë, të përmendur më lartë (p.sh. pesha trupore), në praktikë, janë mjaft të përdorshme.

Nutricionistët australianë kalkulojnë e metabolizmit bazal e bazojnë në peshën e përgjithshme trupore. Sipas tyre, kalkulimi i metabolizmit bazal mund të bëhet si vijon:

Për meshkuj të rritur: $MB = (Pt \times 10) + (2 \times Pt)$

Për femra të rritura: $MB = (Pt \times 10) + Pt$

$MB = \text{metabolizmi bazal (kcal/ditë)}$; $Pt = \text{pesha trupore në Paund (LB)}$;

$1 \text{ LB (Paund)} = 0.454 \text{ kg}$, respektivisht $1 \text{ kg} = 2.2 \text{ LB}$.

Shembulli 1:

Të llogaritet metabolizmi bazal për mashkullin me peshë trupore 80 kg dhe për femrën me peshë 55 kg:

$MB \text{ për mashkullin:}$

$Pt = 80 \text{ kg} \times 2.2 = 176 \text{ LB}$; $MB = (176 \times 10) + (2 \times 176) = 1760 + 352 = 2112 \text{ kcal}$

$MB \text{ për femrën:}$

$Pt = 55 \text{ kg} \times 2.2 = 121 \text{ LB}$; $MB = (121 \times 10) + 121 = 1210 + 121 = 1331 \text{ kcal}$

Autorët Katch dhe McArdle metabolizmin bazal e kalkulojnë duke u bazuar në masën trupore pa dhjamë. Kjo formulë është shumë më e besueshme se sa formula e bazuar në peshën e përgjithshme trupore. Këta autorë, si për femra ashtu edhe për meshkuj, propozojnë të njëjtën formulë:

$MB = 370 + (21.6 \times \text{masa trupore pa dhjamë në kg})$

Shembulli 2:

Të kalkulohet MB për një person me peshë trupore 70 kg dhe me përqindje të indit dhjamor 20%. Përqindja e indit dhjamor kalkulohet nga matjet e mëparshme të indit dhjamor në pjesë të caktuara të trupit, dhe më pastaj në bazë të vlerave tabelore, apo përmes formulave të caktuara për llogaritjen e kompozicionit trupor.

Së pari, duhet të kalkulohet masa dhjamore e trupit, e më pastaj masa trupore pa dhjamë:

$70 \text{ kg} \times 20\% = 14 \text{ kg}$ masë dhjamore;

$70 \text{ kg} - 14 \text{ kg} = 56 \text{ kg}$ masë trupore pa dhjamë;

Pasi që kemi kalkuluar masën trupore pa dhjamë, përmes formulës së propozuar të autorëve Katch dhe McArdle, kalkulojmë metabolizmin bazal:

$MB = 370 + (21.6 \times 56) = 370 + 1209.6 = 1579.6 \text{ kcal}$

Siç u tha më lartë, në metabolizmin bazal ndikojnë faktorë të shumtë (mosha, gjinia, lartësia trupore, pesha trupore, masa trupore pa dhjamë), andaj nutricionistët britanikë propozojnë formula tjera për kalkulimin

e metabolizmit bazal, ku marrin parasysh gjininë, moshën, lartësinë trupore dhe peshën trupore:

Për meshkuj: $MB = 66 + (13.7 \times Pt) + (5 \times Lt) - (6.8 \times \text{Mosha})$;

Për femra: $MB = 655 + (9.6 \times Pt) + (1.8 \times Lt) - (4.7 \times \text{Mosha})$;

- $MB = \text{metabolizmi bazal (kcal/ditë)}$;
- $Pt = \text{pesha trupore në kg}$;
- $Lt = \text{lartësia trupore në cm}$;
- Mosha në vite .

E metë e kësaj formule është mosmarrja parasysh e faktorit që përcakton masën trupore pa dhjamë.

Shembulli 3:

Të kalkulohet metabolizmi bazal për një person mashkull të moshës 46 vjeçare, me peshë trupore $Pt = 85 \text{ kg}$, dhe me lartësi trupore $Lt = 183 \text{ cm}$:

$MB = 66 + (13.7 \times 85) + (5 \times 183) - (6.8 \times 46) = 2145.5 - 312.8 = 1832.7 \text{ kcal}$

Shembulli 4:

Të kalkulohet metabolizmi bazal për personin femër të moshës 30 vjeçare, me peshë trupore $Pt = 60 \text{ kg}$, dhe lartësi trupore $Lt = 163 \text{ cm}$:

$MB = 655 + (9.6 \times 60) + (1.8 \times 163) - (4.7 \times 30) = 1524.4 - 141 = 1383.4 \text{ kcal}$

Vlerat e fituara të MB-së, të kalkuluara me formula të ndryshme kalkuloese për personin e njëjtë, edhe pse të përafërta, janë të ndryshme. Një dallim i tillë mund të arsyetohet me mospërfshirjen e faktorëve të njëjtë në kalkulim (mosha, pesha trupore, lartësia trupore, gjinia dhe masa trupore pa dhjamë, respektivisht kompozicioni i trupit). Andaj, për të minimizuar gabimin në vlerësimin e MB-së preferohet që në kalkulim të merren parasysh sa më shumë faktorë që është e mundur. REFERENCA

1. Burke L, Deakin V. *Clinical sports nutrition*, 2000. 2. Clark N. *Sportska Prehrana*. Zagreb, 2000. 3. Rexhepi A. *Mjekësia Sportive*. Prishtinë, 2009. 4. Rexhepi A. *Nutricioni dhe Sportistët*, Prishtinë, 20105. http://sportsmedicine.about.com/od/fitnesssevalandassessment/a/Body_Fat_Comp.htm 6. <http://www.onlinestudy.oxfordcollege.ac/coursehome.aspx?cid=67> 7. <http://en.wikipedia.org/wiki/Malnutrition> 8. <http://www.who.int/topics/obesity/en/>

*Fjala e drejtorit të Medresesë "Alauddin", Fadil ef. Hasanit,
me rastin e 70-vjetorit të themelimit të Medresesë "Alauddin" në Prishtinë*

Medreseja është pjesë e historisë sonë



*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!*

"Dhe thuaj: O Zot ma shto diturinë!"

*I nderuari kryeministër i Republikës
së Kosovës, z. Albin Kurti;*

*I nderuar Myfti i Republikës së
Kosovës, Naim ef. Tërnavë me
bashkëpunëtorë;*

*I nderuar kryetar i Kuvendit të BIK-
ut, prof. Ajni Sinani;*

*I nderuari përfaqësues i Ambasadës
Amerikane, z. Dominik Makintajër;*

*I nderuari ambasador i Republikës së
Turqisë, z. Çağrı Sakar me
bashkëpunëtorë;*

*I nderuari kryetar i Komunës së
Prishtinës, z. Përparim Rama;*

*Të nderuar përfaqësues të DKA-ve,
Prishtinë, Prizren dhe Gjilan;*

*Të nderuar lider dhe përfaqësues të
partive politike;*

*Të nderuar deputet të Kuvendit të
Kosovës;*

*Të nderuar përfaqësues të Shoqatës së
ish të burgosurve politik, z. Hidajet
Hyseni dhe Selatin Novosella;*

*I nderuari drejtor i Institutit
Albanologjik, z. Hysen Matoshi;*

*I nderuari drejtor i Arkivit të
Kosovës, Z.....*

*I nderuari dekan i FSI-së, z. Fahrush
Rexhepi me bashkëpunëtorë;*

*I nderuari, prof. Isa Memishi,
prodekan i Fakultetit të Filologjisë;*

*Të nderuar drejtorë të shkollave të
mesme të Prishtinës dhe të medreseve
simotra;*

*Ju të nderuar dhe shumë të respektuar
ish-nxënës të gjeneratave të para të
Medresesë, si dhe ju përfaqësues të
prindërve, aktivist, bashkëpunëtorë dhe
miq të Medresesë, ju nxënës të dashur
dhe mësimdhënës dhe gjithë ju të
pranishëm, zonja dhe zotërinj.*

U zgjata shumë, mirëpo miqtë e Medresesë janë të shumtë. Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të të gjithë nxënësve, mësimdhënësve e punonjësve të Medresesë dhe në emrin tim personal t'ju përshëndes e t'ju uroj mirëseardhje dhe qëndrim të këndshëm në shkollën e mesme të lartë, Medresenë Alauddin, me rastin e manifestimit të 70-vjetorit të themelimit të saj, duke ju falënderuar për zemërsisht secilin prej jush për pjesëmarrjen tuaj në këtë ngjarje.

Më lejoni që me këtë rast, para jush të paraqes fjalën time, të fokusuar në tri pika: 1) Themelimi i Medresesë; 2) Aktualiteti i saj, (puna dhe aktivitetet) dhe; 3) Objektivat dhe vizioni i shkollës.

Të nderuar të pranishëm, viti 1951, shënoi një ngjarje të rëndësishme për kombin shqiptar në

Kosovë, Maqedoni, Malit të Zi, Luginë dhe të qytetarëve të tjerë të komunitetit islam; shënoi hapjen e këtij institucioni me rëndësi për zhvillimin e arsimit fetar-islam në Kosovë, hapjen e Medresesë së parë shqipe pas Luftës së Dytë Botërore, e cila sot po e kremton 70-vjetorin e themelimit të saj, shkollë kjo që gjithmonë ishte në shërbim të fesë e atdheut.

T’ju flasë për historikun e Medresesë ndoshta fjalët janë tepër të mangëta, ngase Medreseja tashmë është vetë pjesë e historisë sonë. Ajo u hap si një dritare drite me kontributin e hoxhallarëve mendjendritur, në atë kohë kur komunizmi, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore i mbylli mejtepet dhe medresetë e asaj kohe. Vendimi për hapjen e medresesë u mor në vitin 1949, për të filluar punën dy vjet më vonë, më 1 nëntor 1951, si shkollë-medrese e mesme e ulët, dhe si e tillë vazhdoi punën deri në vitin shkollor 1962/63, kur ishte avancuar në shkollë të mesme të lartë, dhe ashtu vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Kontributin më të madh, nën ombrellën e BIK-ut gjatë këtyre shtatë dekadave e dhanë Bajram Agani, Hasan Nahi, Sadri Prestreshi, Rashit Osmani, hafëz Muharrem Adili, Selim Maloku, Sherfi Ahmeti, Ruzhdi Shabani, Imer Musolli, Ahmet Berisha, Bajrush Ahmeti, Tefik Gashi, Qazim Qazimi, Naim Tërnavë, Ekrem Simnica, Bahri Simnica, Jakup Çunaku dhe gjithë stafi udhëheqës dhe mësimdhënësit përgjatë këtyre dekadave.

Të nderuar të pranishëm

Medreseja “Alauddin” ka dhënë kontribut të madh në edukimin dhe arsimimin e shumë gjeneratave në frymën e mirëfilltë fetare-islame dhe atë kombëtare. Nga këtu dolën shumë të diplomuar, dhe shumë prej tyre ishin dhe vazhdojnë t’i shërbejnë fesë, atdheut dhe popullit. Duhet theksuar se nga kjo shkollë dolën dhe më pastaj u bënë akademikë, profesorë universitarë, pedagogë, historianë, mjekë, politikanë, diplomatë, kryetarë komunash, deputetë,

asamblistë, njerëz të dijes, kulturës e artit, si dhe ushtarë e oficerë të FSK-së, e mbi të gjitha dolën imamë të dalluar në Kosovë dhe gjithandej trojeve etnike, por edhe në shumë vende të botës. Të gjithë këta e përfaqësuan Islamin e mirëfilltë, barazinë ndërmjet njerëzve dhe tolerancën, kështu që nuk mund të mendohet ndonjë bashkësi fetare islame në trojet shqiptare e Sanxhak, po edhe gjithandej në Evropë, Amerikë, Azi dhe Australi ku ka shqiptarë, por jo vetëm, pa e pasur kreator ndonjë ish-medresist të Alauddinit. Në këtë amfiteatër u mbajtën më se 1230 tubime me karakter fetar, kombëtar, kulturor, politik, sindikal etj. Madje në luftën e fundit, për ta çliruar e mbrojtur atdheun, një numër i madh i nxënësve dhe ish-nxënësve u radhitën si ushtarë në UÇK, e një numër i tyre ranë dëshmorë që të mos vdesin kurrë. Aktualiteti, kurrikula e shkollës pësoi ndryshime të herë-pashershme, sipas nevojave të kohës, për t’u avancuar në një kurrikulë moderne. Në këtë shkollë, deri në vitin shkollor 2020/21, diplomuan 5018 nxënës dhe nxënëse. Medresistët janë aktivë edhe sot në jetën politike, akademike, kulturore, sociale etj., dhe janë duke dhënë shumë për të mirën e popullit dhe vendit tonë.

ShML “Medreseja Alauddin” në Prishtinë, në kuadër të saj ka edhe dy paralele të ndara fizike, në Prizren dhe në Gjilan, me gjithsej 26 paralele, 13 në Prishtinë, 7 në Prizren dhe 6 në Gjilan, me plot 725 nxënës, ndërsa numri i vajzave sot tejkalon atë të djemve. Shkolla jonë tani është e barabartë me gimnazet shoqërore – gjuhësore në vend, dhe është nën mbikëqyrje të BIK-ut dhe MASHT-it, me të gjitha të drejtat që gëzon një shkollë e AP në Republikën e Kosovës. Dhe, për këtë shpreh mirënjohje dhe falënderim BIK-ut dhe MASHT-t, DKA-së në Prishtinë, si dhe ndaj gjithë stafit dhe mësimdhënësve për punën që po bëjnë. Nuk mund t’i anashkaloj pa i falënderuar edhe prindërit dhe miqtë

e medresesë, të cilët janë aset i rëndësishëm i shkollës.

Të nderuar të pranishëm

Medreseja “Alauddin” për 70 vjet qëndroi në këmbë si shkollë, e kur atdheu e pati nevojën u bë teatër, spital, strehimore për studentët e UP-së, e kuzhinë popullore. Sepse kjo shkollë është themeluar nga populli, dhe vizion i saj ishte dhe mbetet që t’i shërbejë popullit. Sot Medreseja këtë shërbim synon ta bëjë duke ngritur nivelin e arsimit në një shkallë sa më të lartë. Sot arsimimi i gjeneratave në klasat e kësaj shkolle po bëhet në hap me vendet më të zhvilluara në botë. Klasat, të gjitha, kanë tabela të mençura dhe çdo mjet tjetër teknik të nevojshëm. Sot, stafi i kësaj shkolle është më i avancuar në shkallë akademike. Aktivitetin e saj arsimor-edukativ shkolla jonë e zhvillon me 7 doktorë shkencash, 4 PhD kandidatë, 13 magjistra, dhe të tjerët me kualifikime përkatëse universitare. Medreseja “Alauddin”, krahas punës për arsimimin dhe edukimin e gjeneratave, është organizatore e shumë konferencave, garave të dijes, dhe mikpritëse e shumë ngjarjeve edukative në nivel vendi. Është pjesëmarrëse edhe në projekte të rëndësishme shkollore, kulturore dhe shkencore. Shkolla jonë është e binjakëzuar me disa shkolla jashtë vendit, si dhe ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me shkolla dhe me institucione e organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Vizioni dhe misioni ynë në vazhdimësi i shërbejnë ngritjes së nivelit të arsimimit dhe edukimit të gjeneratave që vijnë, dhe për këtë falënderojmë BIK-un dhe MASHT-in për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakursyer.

Lus të Madhin Zot që së bashku dhe me suksese të shumta të tjera të shënojmë edhe shumë përvjetorë të Medresesë sonë!

Ju faleminderit!

Fadil ef. Hasani

Më 22.12.2021

Prishtinë

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, z. Khaled al-Shami

Më 13 janar, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, qëndroi për vizitë zyrtare në Tiranë, ku u prit nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, z. Khaled al-Shami. Në këtë vizitë, Myftiu Tërnavë e shoqëroi shefi i kabinetit të tij, mr. Besim Mehmeti.

I ngarkuari me punë i Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, z. Khaled al-Shami e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe i vlerësoi marrëdhëniet e mira ndërmjet dy palëve, si dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim që këto marrëdhënie të forcohen akoma më shumë ndërmjet dy shteteve, në veçanti me institucionin e BIK-ut.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi ambasadorin për pritjen, punën dhe për kontributin e tij për intensifikimin e bashkëpunimit dhe për thellimin e miqësisë ndërmjet Kuvajtit dhe Kosovës. Myftiu e falënderoi Al-Shamin veçanërisht për angazhimin e tij të pambarim në përkrahje të projekteve të BIK-u. Ai



po ashtu e falënderoi atë për bashkëpunimin dhe për përkrahjen e sigurtë për realizimin e shumë projekteve të përbashkëta në të mirë të qytetarëve tanë.

Myftiu Tërnavë dhe i ngarkuari me punë i Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, Al-Shami diskutuan për format si të bashkërendohen sa më mirë punët për realizimin e projekteve kuvajtiane në Kosovë, si dhe ranë

dakord që në të ardhmen të intensifikohet bashkëpunimi.

Kurse i ngarkuari me punë i Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, Al-Shami, ripohoi mbështetjen e madhe që ka Kosova nga shteti dhe populli i Kuvajtit dhe shprehu gatishmërinë për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe për rritjen e përkrahjes për BIK- un, sidomos për projekte infrastrukture. (R.S.)

Myftiu Tërnavë u prit në takim nga ambasadori i Katarit, Ali bin Hamad al-Marri

Më 13 janar, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga shefi i kabinetit, mr. Besim Mehmeti, kanë vizituar ambasadën e Katarit në Tiranë, ku u pritën nga ambasadori Ali bin Hamad al-Marri.

Myftiu Tërnavë fillimisht e falënderoi ambasadorin për punën dhe për kontributin e tij për rritjen e bashkëpunimit dhe për thellimin e miqësisë ndërmjet Katarit dhe Kosovës. Myftiu po ashtu e falënderoi ambasadorin për përkrahjen e shtetit të Katarit gjatë pandemisë. Gjithashtu Myftiu Tërnavë e njohu ambasadorin me aktivitetin dhe me veprimtarinë e BIK-ut, duke theksuar bashkëpunimin shumë të ngushtë që ka me Ministrinë e Çështjeve



Fetare të Katarit. Myftiu Tërnavë dhe ambasadori i Katarit Al-Marri biseduan për koordinim sa më të mirë për realizimin e projekteve të ndryshme të BIK-ut në Kosovë, si dhe u ranë dakord që në të ardhmen të shtohet bashkëpunimi.

Po ashtu Myftiu Tërnavë edhe njëherë falënderoi qeverinë dhe popullin e Katarit për përkrahjen dhe ndihmën që i kanë dhënë Kosovës dhe popullit të saj gjatë dekadave të fundit. (R.S.)

Myftiu Tërnavë takoi ambasadorin e Arabisë Saudite, Faisal Ghazi Ismail

Më 13 janar, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, është pritur në takim në Tiranë nga ambasadori i Arabisë Saudite, Faisal Ghazi Ismail Hifzi.

Në këtë takim, ambasadori saudit falënderoi Myftiun Tërnavë për bashkëpunimin shumë të mirë të deritanishëm dhe çmoi kontributin e Myftiut Tërnavë për organizimin e BIK-ut dhe jetës fetare në përgjithësi. Ai vlerësoi se institucionet e BIK-ut kanë treguar praktikisht se si respektohen të drejtat e komuniteteve fetare duke promovuar dialog, bashkëjetesë ndërfetare si dhe harmoni mbarëkombëtare. Ambasadori saudit premtoi se do të përkrah vazhdimisht BIK-un në projekte të cilat janë në interes të vetë qytetarëve të Kosovës.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi ambasadorin e Arabisë



Saudite, Faisal Ghazi Ismail Hifzi për mirëpritjen dhe vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë mes dy institucioneve dhe po ashtu çmoi kontributin dhe ndihmën që ka dhënë mbretëria e Arabisë Saudite si

popull dhe qeveri për Kosovën si para, gjatë dhe pas luftës.

Të dy palët ranë dakord se do të intensifikohen veprimet dhe bashkëpunimi në fushat e përhapjes së Islamit mesatar dhe të tolerancës që na nxit në to feja islame. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim lamtumirës atasheun për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Nevzat Akin



Më 14 janar, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim lamtumirës këshilltarin për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë z. Sabri Nevzat Akin.

Myftiu Tërnavë shprehu falënderime për bashkëpunimin e sinqertë që kanë pasur deri më tani, duke vlerësuar se bashkëpunimi ndërmjet


BIK-ut dhe Dijanetit turk do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke shprehur dëshirën që edhe më tej të vazhdojë ky koordinim me qëllim që t'i kontribuojmë zhvillimit të jetës fetare e kulturore në Kosovë përmes projekteve të përbashkëta.

Nga ana e tij, këshilltari Sabri Nevzat Akin, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe bashkëpu-

nimin gjatë këtyre viteve, duke shprehur bindjen dhe gatishmërinë që ky bashkëpunim do të intensifikohet, në mënyrë që Kosova të jetë një oazë paqeje.

Me këtë rast, në emër të BIK-ut dhe shenjë respekti për bashkëpunimin dhe kontributin e tij, Myftiu Tërnavë i ndau mirënjohje këshilltarit z. Sabri Nevzat Akin.

Myftiu Tërnavë vizitoi kryetarin e BFI-së së Maqedonisë Veriore, Reisul Ulema, hfz. Shaqir ef. Fetai



Më 19 janar, një delegacion i lartë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, i kryesuar nga kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kanë vizituar Bashkësinë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku në pritje të tyre ishte Reisul Ulema, hfz. Shaqir ef. Fetai me bashkëpunëtorë.

Kryetari Shaqiri falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe bashkëpunimin shumë të mirë që kanë dy bashkësitë fetare islame. Edhe Myftiu Tërnavë falënderoi Reisul Uleman hfz. Shaqir ef. Fetai për mikpritjen, duke thënë se takimet e tilla do t'u shërbejnë dy bashkësive fetare dhe do të jenë të bereqetshme dhe konkrete në të mirë të besimtarëve tanë.

Dy delegacionet në përbërje të zgjeruar biseduam gjerë e gjatë për një bashkëpunim të mirëfilltë për një të ardhme më të mirë.

Në këtë takim të dyja palët vendosën me sa vijon:

- Forcimi i bashkëpunimit të dy bashkësive në sfera të ndryshme të jetës fetare-islame;

- Vazhdimi i realizimit të projekteve në sferën e botimit të veprave të ndryshme, si dhe revista e përbashkët nga tri bashkësitë fetare: Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe e Shqipërisë;

- Organizimi i paneleve, simpoziumeve, konferencave të ndryshme si dhe garave të Kuranit famëlartë dhe organizime të ndryshme;

- Projekte të bashkëpunimit ndërmjet shkollave të mesme islame - medreseve dhe fakulteteve të shkencave - studimeve islame;

- Vizita të ndërsjella të imamëve në territoret e bashkësive islame;

- Përgatitja e emisioneve dhe projekteve për mjetet e informimit;

- Këmbimi i përvojave të ndërsjella rreth organizimit të Haxhit dhe projektit të kurbaneve;

- Kultivimi edhe më i shëndoshë i doktrinës burimore islame me qëllim të evitimit të synimeve eventuale të radikalizmave të llojeve të ndryshme;

- Përpjekje maksimale të shpjegimit islam konform rrjedhave të kohës me qëllim të një prezantimit të shëndoshë dhe të pastër të Islamit në trevat tona;

- Vizita të ndërsjella të objekteve fetare të njohura dhe atraktive në të dyja vendet;

- Të formohen ekipe profesionale për realizimin gradual të synimeve të parapara nga dy bashkësitë islame;

- Në të ardhmen të organizohen takime trepalëshe, ndërmjet bashkësive islame të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut;

- Si dhe shumë ide të tjera që i nxjerr koha, situata dhe rrjedhat e zhvillimeve fetare dhe kombëtare.

Në fund, të dyja palët përshëndetën takimin dhe vizitën, duke konstatuar se bashkëpunimi është vlera më e lartë e besimtarëve të trojeve tona dhe në këtë mënyrë do jemi në krye të detyrës për të bartë amanetin e shpjegimit të Islamit, për të qenë në shërbim të Zotit, kombit, vatanit dhe gjinisë njerëzore në përgjithësi. (R.S.)



Myftiu Tërnavë takoi kryetarët e këshillave vendor të BIK-ut



Më 26 janar, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka zhvilluar një takim me kryetarët e këshillave të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës. Mbledhja është mbajtur në sallën e Kryesisë së BIK-ut, ku në rënd dritë të takimit ishte bashkëbisedimi për gjendjen aktuale në vend. Fillimisht hapja u bë me lexim të një pjese kuranore të kënduar nga Skender ef. Baftiu dhe më pas Myftiu Tërnavë ka shprehur mirënjohje për kontributin që kanë dhënë kryetarët e KBI-ve dhe të gjithë imamët për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Ai tha se BIK-u vazhdimisht ka punuar dhe është interesuar për përmirësimin dhe ruajtjen ehëndetit publik të qytetarët. Në këtë mbledhje u tregua edhe njëherë përkushtimi i

BIK-ut që të bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha institucionet shëndetësore, duke pasur parasysh se BIK-u ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie.

Më pas ai u rikujtoi atyre përgjegjësinë që kanë për organizimin dhe udhëheqjen e jetës fetare në këshillat e Bashkësisë Islame. Në fokus të takimit ishin edhe sfidat dhe problemet që po ballafaqohen këshillat e BI-së së Kosovës, si dhe koordinimin që duhet të jetë ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale të BIK-ut, në mënyrë që bashkërisht të tejkalohen problemet dhe sfidat që po ballafaqohemi për çdo ditë. Myftiu Tërnavë po ashtu porositi kryetarët e këshillave të BI-së që të jenë më afër me xhematin.

Myftiu Tërnavë tha se falë Zotit dhe angazhimi tonë në përgjithësi, në këto vitet e fundit kemi shënuar rezultate të mira, sidomos në ndërtimin e infrastrukturës, si të xhamive ashtu edhe të objekteve të tjera, siç janë ndërtimi i selive nëpër këshillat e Bashkësisë Islame dhe ndërtimi i objekteve për vakëfe, të cilat janë një bazë e mirë për funksionimin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë u kërkoi që të bashkëpunojnë edhe më shumë ndërmjet vete, të shkëmbejnë përvoja me njëri-tjetrin në mënyrë që aktivitetet të jenë në të mirë të xhematëve, si dhe porositi që të jemi unik në mendime e qëndrime përballë sfidave të kohës dhe jetës që kemi para nesh. (R.S.)

Dhurohen gjashtë ari truall për Këshillin e BI-së së Kamenicës



Më 5 janar, Vehbi Matoshi nga Kamenica, ka dhuruar vakëf 6 ari tokë, në vlerën e 25.000 eurove. Këtë vakëf e pranoi kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kamenicë, Ferid ef. Dërmaku, i cili falënderoi donatorin, duke lutur

Allahun xh.sh., që kjo vepër e tij të pranohet si sadaka rrjedhëse për këtë familje.

Shembujt e personave që po lënë tokën vakëf dita-ditës janë duke u shtuar, për çka Bashkësia Islame

është tejet mirënjohëse dhe falënderuese.

Lusim Allahun e Madhëruar që Vehbi Matoshin dhe gjithë bamirësit t'i shpërblejë me mirësitë e Tij të pafundme! (R.S.)

Dua hatmeje në xhaminë e fshatit Lluçan të Bujanocit



Më 5 janar, pas përfundimit të leximit të Kuranit nga pesëmbëdhjetë nxënës që kanë vijuar mësimin e leximit të Kuranit tek imami i xhamisë, Xhelal ef. Jakupi, u mbajt dua e hatmes në xhaminë e fshatit Lluçan të Bujanocit.

Programin e hapi imami Xhelal ef. Jakupi, i cili para të pranishmëve ndër të tjera tha: "Rezultat i gjithë kësaj janë nxënësit dhe familjarët e

nxënësve që gjithherë na përkrahën dhe na ndihmuan të arrijmë aty ku jemi sot."

Në këtë tubim që i pranishëm edhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Bujanoc, Ragmi ef. Destani me bashkëpunëtorë, kryeimami Sulejman ef. Fejzullahu dhe sekretari i KBI-së në Bujanoc, Sevder ef. Bajrami, mulla Azizi nga Tërrnoci, si dhe një numër i madh i xhematit

dhe familjarëve të nxënësve që kanë bërë hatme.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i KBI-së, Ragmi ef. Destani, tha se puna më e madhe që sot mund ta bëjë ndonjë imam është t'i mësojë xhematit të tij leximin e Kuranit. Po ashtu ai vlerësoi lart arritjen e nxënësve për leximin e bukur të Kuranit dhe përgëzoi imamin e xhamisë për punën që bënë.

Edhe kryeimami Sulejman ef. Fejzullahu me një fjalë përshëndetëse, përcolli edhe urimet të prindërit, nxënësit dhe tek imami i xhamisë, si dhe përgëzoi atë dhe nxënësit për sukseset e arritura me mësimin e shkronjave të Kuranit fisnik.

Programi ishte i pasur me këndin nga Kurani, ilahi, recitime të karakterit fetar nga nxënësit, që zgjoi mjaft kureshtje dhe emocione të xhemati. Në fund u këndua edhe një ashëre, kurse duanë e hatmes e bëri sekretari i KBI-së, Sevder ef. Bajrami. Në fund, nxënësit u pajisen me certifikata për suksesin e arritur. (Sh.K.)

Tubim fetar me rastin e fillimit të leximit të Kuranit

Më 12 janar, me rastin e fillimit të leximit të Kuranit nga nxënësja Ajnisha Abazi, në xhaminë "Sudi Efendi" u organizua një tubim fetar.

Në këtë tubim mori pjesë edhe përfaqësuesja e Departamentit të Gruas në Kryesinë e BIK-ut, znj. Vaxhide Bunjaku.

Mysafirëve mirëseardhje iu dëshiroi mualimja Agime Sadriu, e cila çmoi dhe vlerësoi angazhimin dhe përpjekjet e nxënëses Abazi, duke e inkurajuar atë dhe nxënëset e tjera në mësim-lexim të Kuranit.

Ndërsa znj. Vaxhide Bunjaku ligjëroi mbi vlerën e mësimin dhe leximit të Kuranit, duke iu dëshiruar suksese të mëtejme së pari nxënësve si dhe vetë mualimes Sadriu në këtë rrugë të dijes. (R.S.)



IHSI pranoi një pjesë të koleksionit të librave nga biblioteka e myderrizit, haxhi Iljas ef. Hashani - Glloboderi

Më 20 janar, Jahir ef. Beqiri, imami i xhamisë “Hatunije” në Prishtinë, dhuroi për Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame një pjesë të koleksionit të librave nga biblioteka e myderrizit të mirë-njohur, haxhi Iljas ef. Hashani – Glloboderi. Këto libra kryesisht janë literaturë e dorëshkrime mbi 100 vjeçare të vjetra. Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, pranoi këto libra duke i vlerësuar dhe çmuar si tejet të rëndësishme për fenë islame dhe i cilësoi si jashtëzakonisht të një rëndësie të veçantë për arkivin e dorëshkrimeve.

Drejtori Bajgora tha se këto libra janë të fushës fetare e shkencore si: akaid, fikh, hadith, tefsir, gjuhë, filozofi e letërsi arabe, madje disa revista janë nga vitet 20-30 të shekullit të kaluar të botuara në Egjipt dhe gjetiu. Ai edhe njëherë ka apeluar të gjithë ata që kanë dorëshkrime të tilla që mos të



hezitojnë, por t’ia dorëzojnë Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, në mënyrë që ne të themelojmë bibliotekat e fushave të ndryshe shkencore, por edhe e hoxhallarëve dhe dijetarëve tanë të mëhershëm, që të ndriçojmë sadopak një pjesë të jetës dhe veprës së tyre që mos t’i mbuloj harresa

sepe me kalimin e viteve fitojnë në vlerë dhe peshë shkencore.

Njëherësh drejtori Bajgora ka falënderuar të gjithë ata që deri më tani kanë dhuruar libra të vjetër për pasurimin e arkivit të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame (IHSI). (R.S.)

Nënshkruhet memorandum i bashkëpunimit ndërmjet IHSI-së dhe FSI-së

Më 25 janar, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame në Prishtinë dhe Fakulteti i Studimeve Islame, sot kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit, i cili do t’u shërbejë dy institucioneve në fushëveprimin e bashkëpunimit të ndërsjellë për realizimin e interesave të dyanshme në fushën e hulumtimeve dhe kërkimore shkencore.

Drejtori i IHSI-së prof. Sabri Bajgora, tha: “Nënshkrimi i këtij memorandum ka për ne një rëndësi të veçantë dhe mendoj se kemi shumë fusha të përbashkëta ku mund të arrijmë në një bashkëpunim të frytshëm, e sidomos në trashëgiminë tonë shpirtërore. Fokusi ynë do të jetë eksplorimi i dorëshkrimeve të vjetra dhe mundësia që nga ato të nxjerrim dëshmi për historinë tonë të shkruar me shkrim osman, sidomos për ndriçimin e figurave të



dijetarëve dhe ylemave tanë, ngase këtë e kemi obligim ndaj tyre.”

Nga ana e tij, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, theksoi se arritja e kësaj marrëveshjeje do të nxisë dhe do të ndihmojë në zhvillimin dhe realizimin e shumë projekteve aka-

demike, shkencore e hulumtuese. “Biblioteka e FSI-së posedon një numër të konsiderueshëm të literaturës, ku kemi mbi 10 mijë tituj të evidentuar në gjuhë të ndryshme, por ruhen edhe afro 2000 dorëshkrime të vjetra të gjuhës osmane” – tha ai. (R.S.)

Hfz. Mehas Alia, rizgjidhet kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër

Më 23 janar 2022, pasditen e së dielës, është shënuar një aktivitet i rëndësishëm në sferën fetare në Zvicër. Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër, në xhaminë shqiptare në Regensburg, realizoi Kuvendin e rregullt zgjedhor, në të cilin u zgjodh kryesia e re, e cila do ta përfaqësojë këtë institucion islam në katër vitet e ardhshme. Kryetar i këtij institucioni u rizgjidh Mehas ef. Alija, imam në xhaminë El-Hidaje në St. Gallen, bashkë me ekipin e tij prej dhjetë anëtarësh. Vlen të përmendet që kësaj radhe, në mesin e anëtarëve të kryesisë janë zgjedhur edhe dy vajza.

Para se të fillonte mbledhja, fjala iu dha kryetarit të deritanishëm të KMSHZ-së, Mehas ef. Alija, i cili në këtë rast falënderoi të gjithë të pranishmit për bashkëpunimin e mirë dhe të sigurtë, duke vazhduar më pas me informimin rreth aktiviteteve të realizuara në të kaluarën. Ndër tjerash ai veçoi aktivitetin e KMSHZ-së në fushën e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe religjioze në Zvicër dhe bashkësitë islame të vendlindjes, ngritjen e imazhit të institucionit fetar, seminarët e ndryshme të zhvilluara në të kaluarën, botimet për nevojat e xhamive, ndërse të sfera humanitare, u ndal te projekti i cili vazhdon, e që ka të bëjë me ndërtimin e disa shtëpive dhe të një xhamie në Shqipëri, pas tërmetit, i cili dëmtoi shumë shtëpi dhe banesa.

“Deri më tani, kanë përfunduar shtatë shtëpi dhe në pritje është ndërtimi dhe përfundimi i katër shtëpive të tjera, si dhe xhamia. Këto janë projektet të cilat i kemi marrë përsipër që t’i financojmë dhe një pjesë të mjeteve i kemi lëshuar, ndërsa pjesa tjetër do lëshohet në varësi të punimeve që do zhvillohen,” - u sqarua Mehas ef. Alija, në pyetjen për të mësuar diç më tepër në këtë çështje.

Pas përfundimit të fjalimit, mbledhjen e shpalli të hapur kryetari i komisionit zgjedhor, Abdullah Mustafa, i cili pasi iu shprehu mirë-



seardhje të pranishmëve dhe konfirmoi prezencën e mjaftueshme të kuvendarëve për të mbajtur mbledhjen, shpалosi një nga një, pikat e rendit të ditës.

Pos tjerash, në këtë takim u miratuan edhe tri draft-dokumente të përgatitura nga komisioni juridik i KMSHZ-së, i udhëhequr nga imami Rejhan ef. Neziri. Këtu kemi të bëjmë me një statut standard për xhamitë, rregulloren e punës së imamit, si dhe rregulloren për rendin shtëpiak në xhami, për të cilat pati dhe debate konstruktive lidhur me disa pika të veçanta, sa i përket ideologjisë së akides, por në fund me shumicë votash u miratuan propozimet e komisionit juridik të KMSHZ-së.

Rejhan ef. Neziri, kryetari i komisionit juridik, tha se “këto draft-dokumente, janë ndërtuar në përputhje të plotë me ligjet zvicerane, kemi konsultuar edhe kushtetutat e Bashkësisë Islame në vendlindje dhe përfundimet që sjellin këto dokumente ua kemi përshtatur nevojave të xhamive në Zvicër.”

Në këtë takim, u prezantuan edhe kërkesat e tri xhamive shqiptare, të cilat kishin aplikuar për t’u bërë pjesë e KMSHZ-së, dhe unanimisht u votua për pranimin e tyre nën ombrellën e KMSHZ-së. Me këtë, numri i xhamive anëtare të KMSHZ arrin në 60. Kjo e bën KMSHZ-në, organizatën më të madhe islame në Zvicër, e cila përfaqëson myslimanët.

Pas rizgjedhjes, kryetari Mehas Alija, falënderoi edhe njëherë të pranishmit për mbështetjen, dhe u zotua se do të punojë dhe do të angazhohet edhe më shumë në fushën e veprimtarisë për themelimin e institucioneve të tjera themeltare edukativo-arsimore në kuadër të KMSHZ-së. Ai gjithashtu potencoi se në të kaluarën, pos të tjerave, ka qenë i angazhuar maksimalisht për të ngritur imazhin e KMSHZ -së, në nivelin e duhur me çka “ia kemi arritur, ndërsa, tani është koha që të fokusohemi në fusha të tjera dhe të ndërtojmë një Bashkësi Islame ashtu siç i ka hije,” - u shpreh Mehas ef. Alija në fund të takimit.

Punimet e kuvendit i shpalli të mbyllura kryetari i deritashëm i kuvendit të KMSHZ-së, Abdullah Mustafa, i cili i falënderoi kuvendarët për pjesëmarrje në një numër kaq të madh në këtë kuvend, si dhe nikoqirin, imamin dhe kryesinë e xhamisë së Regensburgit.


Nikoqir i këtij takimi ishte xhamia shqiptare në Regensburg. Staf i dha imami i saj, Ferit ef. Zeqiri, ishin përkujdesur për çdo detaj, duke filluar nga parkingjet, mbarëvajtja e mbledhjes, e deri te darka e shtruar për të gjithë të pranishmit. Pjesëmarrës në këtë Kuvend ishin imamë, kryetarë xhamish dhe kuvendarë nga më shumë se 50 xhami nga e mbarë Zvicra.

Përgatiti: Irfan Agushi

وَبَشِّرِ الصَّابِرِينَ
الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمُ مُصِيبَةٌ قَالُوا
إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ
أُولَئِكَ عَلَيْهِمْ صَلَوَاتٌ مِنْ رَبِّهِمْ وَرَحْمَةٌ
وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْتَخُونَ

"...ti jepju myzhde durimtarëve! Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme, thonë: "Ne jemi të Allahut, dhe ne vetëm tek Ai kthehemi. Të tillët janë ata që të Zotit i tyre kanë bekime e mëshirë, dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë." (El Bekare, 155-157)

Kaloi në Ahiret Fehmi ef. Sylejmani (1933-2021)



Më 12 dhjetor 2021, në moshën 88 vjeçare ka ndërruar jetë hoxhë Fehmi Sylejmani nga fshati Tërpezë, komuna e Vitisë.

Fehmi ef. Sylejmani lindi më 13 mars 1933 në fshatin Tërpezë, komuna e Vitisë. Ai vinte nga një familje fetare e kombëtare, nga një familje hoxhallarësh. Fehmi ef. Sylejmani i mori mësimet e pare në shtëpinë e tij nga babai i tij, mulla Ademi. Mulla Fehmiu ishte djali i mulla Ademit, e mulla Ademi ishte

djali i mulla Sylë Tërpezës. Mulla Sylë Tërpeza, mësuesi i shkollës së parë shqipe në Pozheran, së bashku me të birin dhe nipin, hoxhë Fehmiun ishte në shërbim të fesë dhe atdheut.

Mulla Fehmi ef. Sylejmani shërbeu për afërsisht 30 vjet si imam në fshatin Ballancë, ku gëzonte respekt të madh nga banorët e fshatit. Ai ishte një hoxhë i urtë, i dashur dhe i respektuar nga të gjithë.

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!

Kaloi në Ahiret Abdurrahman ef. Rexhepi (1989-2022)



Abdurrahman ef. Rexhepi lindi më 29 shtator 1989, në një familje me traditë fetare e kombëtare.

Abdurrahman ef. Rexhepi e kreu shkollën fillore në Ferizaj me sukses të shkëlqyer, për të vazhduar më pas mësimet në medresenë e mesme "Alauddin", dega në Gjilan, të cilën e përfundoi me sukses të shkëlqyer në vitin 2009.

Pas përfundimit të Medresesë, ai u regjistrua në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Fillimisht filloi punën si myezinë në xhaminë "El-Faruk" në Ferizaj, për të vazhduar më pas si imam gjatë muajit Ramazan në xhaminë e fshatit Sojevë të Ferizajt.

Si imam i rregullt filloi punën në fshatin Ballancë të Vitisë, ku punoi për më shumë se një dekadë, deri në sëmundjen e rëndë që e kaploi.

Modestia, urtësia, puna dhe virtytet e mulla Abdurrahmanit do të mbesin gjatë në kujtesën tonë. Ai ishte një hoxhë i urtë, bujar dhe shumë i respektuar të xhemati dhe kolegët e punës.

Ai la pas vetës dy prindërit e shtyrë në moshë, bashkëshorten dhe tre fëmijë.

Lusim Allahun e Madhëruar që mulla Abdurrahmanin ta shpërblejë me të mirat e Tij dhe ta bashkojë me shpirtrat e peygamberëve, ulemave dhe të dëshmorëve! (Xhevdet Ismaili)

Më 2 janar 2022, në moshën 32 vjeçare ka ndërruar jetë hoxhë Abdurrahman ef. Rexhepi, imam në fshatin Ballancë, komuna e Vitisë.

Kaloi në Ahiret Abdyl ef. Hasani (1949-2022)



Më 26 janar 2022, ka ndërruar jetë mulla Abdyl ef. Hasani nga Gaçka e Ferizajt. Mulla Abdyl lindi më 04 qershor 1949 në Gaçkë të Ferizajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë, e kreu në vitin 1981-82. Ai rrjedh nga një familje me tradita atdhetare, kombëtare e fetare e arsimdashëse.

Detyrën e imamit, hatibit dhe mualimit e filloi në fshatin Biti të Epërme të komunës së Shtërpçës më 15.07.1972, kurse më 24 prill të vitit 1981, me vendim të Kryesisë së BI-së së Kosovës emërohet sekretar-arkëtar në Këshillin e BI-së së Kaçanikut, funksion të cilin e kreu deri në vitin 2000. Mulla Abdyl ishte edhe njëri ndër themeluesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut më 1981. I etur për dije, ai vazhdoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa pas përfundimit të tyre vazhdoi edhe studimet e magjistraturës në po të njëjtin drejtim. Si personalitet i edukuar dhe i shkolluar, me tipare intelektuale e kombëtare, për dekada punoi dhe shërbeu si imam e ligjërues në xhaminë e fshatit Biti. Gjatë kësaj kohe, ai dha një kontribut të çmuar në aspektin kombëtar, fetar, edukativ etj.

Mulla Abdyl u varros në varrezat e fshatit Gaçkë të Ferizajt. Në varrimin e tij morën pjesë familjarë, përfaqësues nga Kryesia e BIK-ut, hoxhallarë, bashkëpunëtorë, kolegë dhe shumë

xhematë të tjerë. Në emër të Kryesisë së BIK-ut dhe në emër të Myftiut Tërnavë, një fjalë rasti mbajti sekretari i Kryesisë, prof. Ahmet ef. Sadriu, i cili çmoi lart figurën dhe kontributin shumëvjeçar të mulla Abdylit. "BIK sot ka humbur një punëtor të zellshëm, të vyeshtë e të palodhshëm, i cili tërë jetën ia kushtoi Islamit dhe xhemitit. Ai dëshmoi në praktikë shembullin e një imami e misionari të devotshëm, shembullin e një atdhetari e një udhëheqësi të shquar, i vendosur e me integritet të lartë moral e profesional, një model që gjithsesi duhet ndjekur nga gjeneratat e reja. Lusim Allahun xh.sh. që ta shpërblejë për mundin dhe kontributin e tij në lartësimin e fjalës së Zotit" – tha ndër të tjera sekretari Sadriu.

Namazit të xhenazes i priu Avdush ef. Krosa, kurse duanë e xhenazes e bëri dekani i FSI-së, prof. dr. Fahrush ef. Rexhepi.

Lusim Allahun e Madhëruar që ta ketë marrë në mëshirën e Tij, si dhe ta ketë graduar me xhenet!

Kaloi në Ahiret Bujar ef. Hasani (1978-2022)



Më 30 janar 2022, pas një sëmundje të rëndë, ka ndërruar jetë ish-kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt, imami i fshatit Gaçkë, Bujar ef. Hasani.

Bujar ef. Hasani lindi më 19 dhjetor 1978 në Gaçkë të Ferizajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, për të

vazhduar më pas shkollimin në medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë, në vitet 1993-1997.

Më 1999 regjistrohet në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, të cilin e përfundoi në vitin 2006.

Fillimisht punoi si imam në Xhaminë e Vjetër në lagjen e Berishajve, për të vazhduar më pas në Cernillë, në Mirash, Doganaj dhe së fundi, nga viti 2007 ushtroi detyrën e imamit, hatibit dhe mualimit në xhaminë e fshatit Gaçkë të Ferizajt.

Në periudhën 2016-2020, ushtroi detyrën e kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt. Ai dha një kontribut tejet të çmuar në udhëheqjen, ngritjen, zhvillimin dhe avancimin e administratës së organeve të Këshillit të Bashkësisë Islame të Ferizajt.

I etur pas dijes dhe nga dëshira e madhe që të ngritet edhe më shumë në

aspektin profesional, ai në vitin 2017, regjistroi studimet master në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Si personalitet i edukuar dhe i shkolluar, me tipare intelektuale e kombëtare, për dekada punoi dhe shërbeu si imam e ligjërues në xhaminë e fshatit Gaçkë. Gjatë kësaj kohe dha kontribut të çmuar në aspektin kombëtar, fetar, edukativ etj. Ishte hoxhë i dashur, i afërt, i respektueshëm, ligjërues e prind model për shoqërinë.

Mulla Bujar ef. Hasani u varros më 31 janar 2022, në varrezat e fshatit Gaçkë. Namazit të xhenazes i priu Myftiu i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ndërsa duanë e xhenazes e bëri Adem ef. Hoxha.

Lusim Allahun e Madhëruar që ta ketë marrë në mëshirën e Tij, si dhe ta ketë graduar me xhenet!



Fotografitë fituese të konkursit

**VENDI
1**

XHAMIA "SULTAN FATIH" PRISHTINË
autor: **Metush Mëziu**
vlerësimi: 27/30



**VENDI
2**

XHAMIA "BAJRAKLI" PRIZREN
autor: **Studio Prizreni**
vlerësimi: 24/30



**VENDI
3**

XHAMIA E BRESANËS, OPOJË
autor: **Besmir Sylejmani**
vlerësimi: 22/30

